

Tetor 2016
Numri: 103
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

إِن شَاءَ اللَّهُ

Vetëdija për të thënë

TË ALLAHUT JEMI

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

“Ti je Ai që merr, Ti je Ai që jep. Ti je Ai që i di të gjitha të vërtetat. Ti je Ai që na ke dhënë duart e këmbët. Sytë që shikojnë dhe veshët që dëgjojnë Ti na i ke dhënë. Gjuhën dhe buzët Ti na i ke dhënë. Ne kemi vetëm atë që na ke dhënë Ti. Çfarë mund të kemi tjetër përveç kësaj?”

Me të vërtetë, çfarë mund të kemi ndonjë gjë tjetër përveç asaj që na e ka dhuruar Krijuesi Teala? Le të mendojmë pak: A do të arrinim dot që të mos ishim gurë sikur Allahu i Lartësuar të na kishte krijuar të tillë? A do të arrinim dot që të mos ishim bar sikur Allahu Teala të na kishte krijuar të tillë? A do të arrinim dot që të mos ishim insekt sikur Allahu i Madhëruar të na kishte krijuar të tillë?

Allahu Teala ata ashtu i ka krijuar dhe ata ashtu e vazhdojnë adhurimin e nënshtrimin e tyre ndaj Tij. Gurët, yjet, pemët dhe çdo gjë tjetër kanë dhikrin e tyre. Ndoshta ne nuk i kuptojmë dot, por ata gjithmonë bëjnë dhikër me një gjuhë që Krijuesi absolut ua ka mësuar atyre.

Po të dëshironte Krijuesi Teala edhe njeriun mund ta krijonte për të bërë dhikër të vazhdueshëm me të gjitha qelizat e saj dhe të mos i jepte vullnet. Asnjë nuk mund të dyshojë se Ai ka fuqi për ta bërë këtë. Ai që e ka krijuar gurin, mund ta krijonte edhe njeriun në natyrën e gurit. Por ja që njeriut i është dhënë një privilegj. Atij i është dhënë vullneti. I është dhënë liria për të zgjedhur. Pra, i është dhënë një fushë më e gjerë se e gurit, pemës, insektit etj., vetëm se kur i është dhënë kjo fushë, atij i është kërkuar që të arrijë vetëdijen e adhurimit dhe nënshtrimin ndaj Allahut të Madhëruar. Për këtë arsye, njeriu mund të shëtisë majtas e djathtas, mund të bëjë kërkime, madje, mund të rrëshqasë nga boshti kryesor, por le ta dijë se do të jetë përgjegjës për çdo punë që bën. O njeri! Çdo punë që bën të shkruhet në llogarinë tënde dhe një ditë do të të dalë përballë si faturë. Krijuesi i Lartësuar ta ka dhënë lirinë, por dëshiron që t'i drejtohesh Atij me vetëdije dhe ta kuptosh vlerën e nënshtrimin ndaj tij. Allahu Teala dëshiron që ta kuptosh se çdo gjë që të është dhënë, të është dhënë si nderim dhe mirësi për ty. Prandaj ti duhet të thuash: “Ne kemi vetëm atë që na ke dhënë Ti. Çfarë mund të kemi tjetër përveç kësaj?” Pastaj ta falënderosh duke thënë: “O Zot, unë jam vetëm robi Yt! O Zot, unë jam vetëm robi Yt! O Zot, unë jam vetëm robi Yt!”

Vetëdija që ne i përkasim Allahut Teala dhe të jetuarit me këtë vetëdije kërkon nga njeriu që të ketë një zemër dhe pjekuri të vërtetë. Për këtë arsye njeriu duhet të thotë me vete: “Në të vërtetë, a nuk është vetëm te Ai kthimi ynë? A nuk është ky ligji i jetës? A nuk i përkasim ne Atij? Çfarë kuptimi ka nëse supozojmë se çdo gjë e fitojmë me punën dhe fuqinë tonë sikur të ishim krijesa të përgjeshme? Për këtë arsye, riformatoje veten, rikthehu në faqen e parë të krijimit dhe kujtohu se “je bërë diçka ndërkohë që ke qenë asgjë, se brenda një pike uji janë formuar truri, zemra, duart, këmbët, damarët, nervat, sytë, veshët, gjuha, qiellëza, sistemi i tretjes dhe sistemi i frymëmarrjes, kyçet dhe kockat. Kujtohu se të gjitha këto janë të lidhura me urdhrin hyjnor “Kun / Bëhu!” Kujtohu se shpirti që jeton brenda teje është një frymë hyjnore dhe se kur të merret ai, nuk ngelet asgjë përveç se një kufomë.”

“Inna lil-lahi – Ne i përkasim vetëm Allahut.” Ky parim duhet të jetë një disiplinë jetësore për besimtarin. Këtë patjetër duhet ta bëjmë disiplinë të jetës sonë.

Tetor 2016

VITI: X

NUMRI: 103

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



16

Apel për të menduar
Idris Arpat



Trashëgimtarët e amanetit të shenjtë
Osman Nuri Topbash

34



8

24



Dërsë fëmijët e parë janë më të ndjeshëm?
M. Emin Karabaxhak

5 Vetëdija për të thënë "Inna lil-lahi"
në këtë jetë

Ahmet Tashgetiren

8 Flijimi, shenja e besnikërisë në besim

Dr. Adem Ergyl

10 Ku je, o umeti i Muhamedit?

Ismail Lutfi Çakan

12 Qabja e zemrës
do të ngelet e shkatërruar

Ahmed Saxhid Ekerim

14 Një fillad nga surja Kehf

Xhafer Durmush

19 T'i lehtësojmë zemrat tona

Mehmet Dinç

23 Nëse do

Edison Çeraj

26 Rruga e Allahut është shumë delikate

M. Sami Ramazanollu



40

Pasuria që nuk mund të blihet me asgjë 27

Hatixhe Jegenler

Mrekullitë e Kuranit 30

Një Ajet - Një Hadith 32

Emrat e bukur: Rrahman 40

Ilir Hoxha

Gabimet në mendim 42

Psikologji

Dhikri i pulsorëve 44

Muaz Erdem

6 sekonda më parë 48

Mikro

Pendimi 50

Rrugëtim shpirtëror

Malik ibn Nebij 52

Personalitete botërore islame


Në gjirin e natyrës
Nuredin Nazarko



28

Xhubejr ibn Mut'imi
Mustafa Erish

47



إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاغِبُونَ

Vetëdija për të thënë “Inna lil-lahi” NË KËTË JETË

Ahmet Tashgetiren

“Inna lil-lah. Ne i përkasim (jemi të) Allahut.”

Hazreti Aziz Mahmud Hydaji thotë: “Ne kemi vetëm atë që na ke dhënë Ti. Çfarë mund të kemi tjetër përveç kësaj?”

“Ti je Ai që merr, Ti je Ai që jep. Ti je Ai që i di të gjitha të vërtetat. Ti je Ai që na ke dhënë duart e këmbët. Sytë që shikojnë dhe veshët që dëgjojnë Ti na i ke dhënë. Gjuhën dhe buzët Ti na i ke dhënë. Ne kemi vetëm atë që na ke dhënë Ti. Çfarë mund të kemi tjetër përveç kësaj?”

Me të vërtetë, çfarë mund të kemi ndonjë gjë tjetër përveç asaj që na e ka dhuruar Krijuesi Teala? Le të mendojmë pak: A do të arrinim dot që të mos ishim gurë sikur Allahu i Lartësuar të na kishte krijuar të tillë? A do të arrinim dot që të mos ishim bar sikur Allahu Teala të na kishte krijuar të tillë? A do të arrinim dot që të mos ishim insekt sikur Allahu i Madhëruar të na kishte krijuar të tillë?

Allahu Teala ata ashtu i ka krijuar dhe ata ashtu e vazhdojnë adhurimin e nënshtrimin e tyre ndaj Tij. Gurët, yjet, pemët dhe çdo gjë tjetër kanë dhikrin e tyre. Ndoshta ne nuk i kuptojmë dot, por ata gjithmonë bëjnë dhikër me një gjuhë që Krijuesi absolut ua ka mësuar atyre.

Po të dëshironte Krijuesi Teala edhe njeriun mund ta krijonte për të bërë dhikër të vazhdueshëm me të gjitha qelizat e saj dhe të mos i jepte vullnet. Asnjë nuk mund të dyshojë se Ai ka fuqi për ta bërë këtë. Ai që e ka krijuar gurin, mund ta krijonte edhe njeriun në natyrën e gurit. Por ja që njeriut i është dhënë një privilegj. Atij i është dhënë vullneti. I është dhënë liria për të zgjedhur. Pra, i është dhënë një fushë më e gjerë se e gurit, pemës, insektit etj., vetëm se kur i është dhënë kjo fushë, atij i është kërkuar që të arrijë vetëdijen e adhurimit dhe nënshtrimin ndaj Allahut të Madhëruar. Për këtë arsye, njeriu mund të shëtisë majtas e djathtas, mund të bëjë kërkime, madje, mund të rrëshqasë nga boshti kryesor, por le ta dijë se do të jetë përgjegjës për çdo punë që bën. O njeri! Çdo punë që bën të shkruhet në llogarinë tënde dhe një ditë do të të dalë përballë si faturë. Krijuesi i Lartësuar ta ka dhënë lirinë, por dëshiron që t'i drejtohesh Atij me vetëdije dhe ta kuptosh vlerën e nënshtrimin ndaj tij. Allahu Teala dëshiron që ta kuptosh se çdo gjë që të është dhënë, të është dhënë si nderim dhe mirësi për ty. Prandaj ti duhet të thuash: “Ne kemi vetëm atë që na ke dhënë Ti. Çfarë mund të kemi tjetër përveç kësaj?” Pastaj ta falënderosh duke thënë: “O Zot, unë jam vetëm robi Yt! O Zot, unë jam vetëm robi Yt! O Zot, unë jam vetëm robi Yt!”



Vetëdija “inna lil-lahi – ne i përkasim vetëm Allahut”

Ne kemi qenë asgjë dhe u bëmë diçka në sajë të mirësisë hyjnore. Neve do të na mjaftonte po të shikonim vetëm mrekullinë brenda nesh. Vlerën e organeve që nuk i ndejmë kur funksionojnë, e kuptojmë shumë mirë se sa jetike është kur të mos funksionojnë...

Po të mos kishim duart? Po sikur sytë tanë të ishin të palëvizshëm? Po të mos kishim këmbët dhe gishtat e duarve? Po të mos kishim vetullat dhe qerpikët? Po sikur zemra jonë të funksiononte me intervale? Po sikur të ishim të privuar nga ajo mrekulli që e quajmë memorie dhe të mos mbanim mend asnjë informacion? Po sikur të lindnim nga nëna jonë dhe të mos e mbanim mend atë? Apo sikur të mos e mbanim mend fëmijën tonë që kemi lindur?.. Po sikur t'i ngatërronim emrat dhe fytyrat e njerëzve? Po sikur të na jepej fuqia e të projektuarit, planifikimit etj. dhe të mos na jepej asnjë rregull? Domethënë, po sikur të na thuhej: “Njeriu e kam krijuar si ujë të njeriut. Andaj hajeni njëri-tjetrin!?” Ose, po sikur t’u ishte dhënë bimëve, gurëve, insekteve apo të gjithë kafshëve një fuqi e tillë siç ndodh nëpër filmat fantastiko-shkencorë dhe t’u ishte dhënë mundësia për të organizuar luftëra kundër njerëzve? Çfarë do të ndodhte sikur malet, gurët, insektet, zogjtë dhe përbindëshat të bashkoheshin dhe t’i shpallnin luftë njeriut?

A nuk është reflektim i mëshirës së pafundme të Krijuesit e vërteta se Ai i ka dhënë njeriut ndjenjën e sistemit dhe i ka dërguar një tërësi rregullash që ne e quajmë “Fe”? Brenda njeriut është krijuar një mrekulli dhe i është dhënë një sistem për marrëdhëniet me njerëzit e tjerë dhe me botën e jashtme. Të gjitha këto kanë lidhje me qëllimin e krijimit të

njeriut dhe të gjitha janë dhënë në mënyrë që njeriu ta perceptojë me vetëdije të plotë adhurimin dhe nënshtrimin ndaj Allahut Teala.

Koshienca “inna lil-lahi – ne i përkasim vetëm Allahut”

Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!”** (Bekare, 155-156)

Pa shikojeni edhe këtë ajet tjetër: “Thuaj: **“Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farfisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”** (Teube, 24)

Në këtë ajet fisnik pothuajse është përmendur korniza e gjithë jetës së njeriut dhe i është kërkuar atij që asnjëra prej këtyre të mos jetë më e dashur te ai se Allahu, i Dërguari i Allahut dhe xhihadi në rrugë të Allahut. Domethënë, nëse njeriu bën një radhitje të gjërave primare, Krijuesi dëshiron që ta bëjë në këtë formë. Në krye duhet të vendosë kënaqësinë e Allahut Teala. Ndërsa pranë kësaj duhet të vendosë të Dërguarin e Tij (a.s.). Ndërsa pranë të Dërguarit (a.s.), duhet të vendosë xhihadin, që do të thotë t’ia japë Allahut pasurinë dhe jetën e tij në shpërblim të Xhenetit. Domethënë, që të thotë: “Inna lil-lahi – Ne i përkasim vetëm Allahut. Pra, jemi vetëm të Atij.”

Ku? Në këtë jetë. Në ajetin fisnik thuhet: **“...kur i godet ndonjë fatkeqësi...”** Thuhet: **“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pa-**



surisë, të njerëzve dhe të të lashtave!..” Këto janë fazat e aventurës së jetës së kësaj bote. Këto nuk janë gjëra që shkojnë pas atij që vdes, por janë gjëra me të cilat njeriu përballet pikërisht në këtë jetë. Kur njeriu të përballet me këto, refleksi i parë që kërkohet nga ai është që të thotë: “Inna lil-lah – Ne me të vërtetë i përkasim vetëm Allahut.”

Vetëdija që ne i përkasim Allahut Teala dhe të jetuarit me këtë vetëdije kërkon nga njeriu që të ketë një zemër dhe pjekuri të vërtetë. Për këtë arsye njeriu duhet të thotë me vete: “Në të vërtetë, a nuk është vetëm te Ai kthimi ynë? A nuk është ky ligji i jetës? A nuk i përkasim ne Atij? Çfarë kuptimi ka nëse supozojmë se çdo gjë e fitojmë me punën dhe fuqinë tonë sikur të ishim krijesa të përrjetshme? Për këtë arsye, riformatoje veten, rikthehu në faqen e parë të krijimit dhe kujtohu se “je bërë diçka ndërkohë që ke qenë asgjë, se brenda një pike uji janë formuar truri, zemra, duart, këmbët, damarët, nervat, sytë, veshët, gjuha, qiellëza, sistemi i tretjes dhe sistemi i frymëmarrjes, kyçet dhe kockat. Kujtohu se të gjitha këto janë të lidhura me urdhrin hyjnor “Kun / Bëhu!” Kujtohu se shpirti që jeton brenda teje është një frymë hyjnore dhe se kur të merret ai, nuk ngelet asgjë përveç se një kufomë.”

“Inna lil-lahi – Ne i përkasim vetëm Allahut.” Ky parim duhet të jetë një disiplinë jetësore për besimtarin. Këtë patjetër duhet ta bëjmë disiplinë të jetës sonë.

Allahu Teala na urdhëron që të japim 2.5 për qind nga risku që Ai na jep ne. Ah sikur ta shikonim këtë me perspektivën: “Ne i përkasim vetëm Allahut.”

Allahu Teala e ka dhënë shpirtin, por edhe e merr. Prandaj qëndro i gatshëm në audiencën e Zotit (xh. xh.). Sa? Pesë vakte në ditë, apo një orë në njëzet e katër orë. Dikush mund të pyes: “A bën që ta ndalosh

jetën pesë herë në ditë?” Këtë pyetje e bëjnë sikur i kanë fituar me djersën e ballit orët, ditët dhe vitet që u janë dhënë. Por ka edhe prej atyre që përgjatë gjithë kohës jetojnë sikur të jenë në audiencën e Allahut Teala, sikur vazhdimisht të jenë në namaz apo sikur vazhdimisht të jenë të gatshëm për ta zbatuar urdhrin hyjnor me vetëdijen: “Ne në të vërtetë i përkasim vetëm Allahut.”

Të jetosh çdo çast me ihram, të jetosh çdo çast me agjërim.

Gjithmonë të jesh i vetëdijshëm për nënshtrimin dhe adhurimin kundrejt Zotit (xh.sh.).

Asnjëherë të mos e harrosh “hakun e Allahut” te fëmijët, te pasuria, te pozita dhe në të gjitha statutet e tjera.

Po, kjo është një gjendje tjetër shpirtërore. Ky është një këndvështrim tjetër ndaj jetës. Kjo është një disiplinë tjetër shpirtërore. Ja, pikërisht kjo është ajo që pritet nga besimtari. Edhe sprova është në pikën që mund ta bëjmë ose nuk mund ta bëjmë këtë. Apo sa mund ta bëjmë këtë?

Sado dhimbje që të lënë në jetën tonë ata që shkojnë në botën tjetër, është e lehtë të thuash: “Inna lil-lah – Ne i përkasim Allahut.” Ndërsa të veprosh me vetëdijen se ne “i përkasim Allahut” në jetën e përditshme, kjo po që është e vështirë. Kjo arrihet me një shpirt që i është dedikuar Allahut Teala. Kjo do të thotë që të japësh pa reshtur për hir të Allahut të Lartësuar. Kjo do të thotë që të ngjyrosësh veten me bojën e besimit. Kjo do të thotë që të kesh një moral që kërkohet nga Zoti, xhel-le xhelaluh. Kjo do të thotë që të shpëtosh nga iluzionet e nefsit dhe ta konceptosh në kuptim të vërtetë se jeta ekziston vetëm me mirësinë dhe bujarinë e Allahut të Madhëruar.

Lum për ata njerëz që e arrijnë shkallën e këtij perceptimi!



FLIJIMI

Shenja e besnikërisë në besim

Dr. Adem Ergyl

Çdo fjalë/premtim ka një çmim. Të japësh fjalën do të thotë të qëndrosh pas saj me të gjithë qenien tënde kundrejt çdo çmimi. Ja, një qëndrimi të tillë i themi besnikëri. Harrimi i fjalës së dhënë apo nënvlerësimi dhe neglizhimi i saj, mosveprimi i atyre gjërave që i bën të detyrueshme dhënia e fjalës, mosmbajtja e premtimit duke nxjerrë në pah pretekste të ndryshme dhe shumë sjellje e veprime të tjera si këto, janë çështje që e prishin besnikërinë dhe e lëshojnë të zotin e tyre në pozitën e mashtruesit, hipokritit dhe të njeriut pa personalitet. Nisur nga kjo që thamë deri këtu, asnjë fjalë nuk duhet të jepet rastësisht dhe pa u menduar mirë.

Të thuash: “Zoti im është Allahu.” – është një fjalë e madhe dhe një kauzë jetike. Besimi është që ta thuash këtë fjalë dhe të qëndrosh pas saj. Besnikëria ndaj kësaj fjale është që ta pranosh Allahun Teala si i adhuruari i vetëm që mund t’i bëhesh rob, të pranosh se vetëm Ai është ligjvënës për ne, të bësh një jetë të lidhur ndaj Tij me të gjithë qenien tënde dhe ta shfaqësh jo vetëm në fjalë, por edhe në vepra se i përket Atij me çdo gjë që posedon. Ky ajet fisnik është një e vërtetë hyjnore që tregon qartë se besnikëria në besim do të testohet në mënyrë absolute:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë:

‘Ne besojmë’, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, (atëherë do të sprovohen edhe ata që jetojnë sot) në mënyrë që Allahu t’i nxjerrë në pah ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë.” (Ankebut, 2-3)

Sprova e besnikërisë ka dy fusha themelore. Jëtë të tonë dhe ato që posedojmë. Domethënë, çdo gjë që mund të kemi. Përndryshe, si mund të kuptohet tjetër shprehja: “Inna lil-lah / Ne i përkasim Allahut më të gjithë qenien tonë?” Ata që veprojnë me një shpirt flijues në këto dy fusha janë fatlumë që e kanë vërtetuar besnikërinë e tyre në nënshttrim kundrejt Allahut Teala. Zoti (xh.xh.), e shpreh kështu këtë të vërtetë:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të sigurtë.” (Huxhurat, 15)

“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur

rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.” (Bekare, 177)

Mbartja e një shpirti bujar dhe ndjenja e flijimit kanë lidhje të ngushtë me fjalët Islam dhe mysliman. Këto vërtetime të Izutsu, i cili është i njohur me studimet mbi gjuhën, janë mjaft të rëndësishme nga aspekti i temës që po shtjellojmë:

Fjala “Islam” apo forma e saj si folje “esleme”, në periudhën e xhahiljetit kur Kurani Fisnik akoma nuk ishte shpallur, përdorej në kuptimin: “Të dorëzosh dhe të japësh.” Gjithashtu do të thoshte që dikush t’i japë dikujt tjetër diçka që për të është shumë e vlefshme. Kjo gjë e vlefshme nganjëherë mund të ishte edhe vetë jeta e njeriut. Në këtë situatë, folja “esleme” do të thoshte: “E dorëzoi veten.”¹ Edhe në përdorimin e kësaj fjale në Kurani Fisnik është ruajtur ky kuptim. Ai që synohet këtu nuk është Islami në kuptimin historik, por është Islami në kuptimin që çdo individ t’ia dorëzojë veten Allahut të Madhëruar me dijeni, sinqeritet dhe vullnetin e tij të plotë. Shkurtimeisht, siç shprehet edhe në këtë ajet, bëhet fjalë për dorëzim të vetes ndaj vullnetit hyjnor pa asnjë kusht: **“O Zoti ynë! Na bëj të përlulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlulur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!”**² Pranimi i Islamit nga një njeri shpreh shumë gjëra, por sipas Izutsusë, para së gjithash shpreh se ai heq dorë nga egoizmi dhe nga të besuarit në fuqinë e vetes së tij dhe qëndrimin në audiencën e Allahut Teala si një rob modest, i butë dhe i përkushtuar ndaj Tij.³

Në ajetin fisnik që do të japim më poshtë, shprehet e vërteta se ata që e marrin parasysht flijimin e jetës së tyre në rrugë të Allahut Teala janë njerëz që e kanë vërtetuar besnikërinë e tyre ndaj Tij:

“Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre e kanë mbajtur

fjalën (kanë rënë dëshmorë), **kurse të tjerët presin** (për të rënë dëshmorë) **pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.”** (Ahzab, 23)

Siç kuptohet, vërtetimi i besnikërisë sonë është të shfaqurit që ne i përkasim Atij me të gjithë qenien tonë. Nëse e studiojmë të gjithë Kurani Fisnik dhe hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), mund të themi se është e pamundur që t’i bashkëngjitemi grupit të të devotshmëve dhe të të sinqertëve nëse virtyti për t’i ndarë mirësitë me të tjerët dhe për t’i shpenzuar ato në rrugë të Zotit (xh.xh.), nuk bëhet një pjesë e personalitetit tonë.

Në të vërtetë, këto fljime në pasuri dhe jetë janë sponsorizime shumë të begata dhe me fitime kolosale që do t’i kthehen cilësisë së personalitetit tonë, lumturisë sonë në këtë botë dhe në botën tjetër dhe më e rëndësishmja, do t’i kthehen kapitalit tonë kryesor me qendër Ahiretin. Zoti (xh.xh.), i Cili është i Mëshirshëm dhe Mëshirëplotë, dëshiron që robërit e Tij të fitojnë sa më shumë. Për këtë arsye, Allahu Teala premton se atë që bën një mirësi do ta shpërblejë të paktën me dhjetë herë më shumë. Asnjë flijim dhe mirësi nuk do të ngelë pa shpërblim. Kjo e vërtetë shprehet kështu nga gjuha e Lukmanit (a.s.):

“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njuh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.” (Lukman, 16)

Mevlana Xhelaleddin er-Rrumi thotë:

“Nëse do të japësh bukë në rrugën e Zotit (xh.xh.), edhe ty do të të japin bukë. Nëse do të japësh jetën në rrugën e Tij, edhe Ai do të të falë shumë jetë ty.”

Si përfundim mund të themi se ata që jetojnë vetëm për interesat e tyre në këtë botë të sprovës, jetojnë të vegjël dhe do të vdesin të vegjël. Ndërsa ata që u japin vend edhe të tjerëve në jetën e tyre, marrin frymë nga ajri i Xhenetit në zemrat e tyre dhe do të veshin kurorën e krenarisë në këtë botë dhe në botën tjetër. Liderët dhe prijësit që kanë lënë gjurmë përgjatë gjithë historisë gjithmonë kanë dalë nga njerëzit flijues dhe me shpirt bujar. Edhe sukseset e mëdha gjithmonë janë arritur në sajë të fljimeve. Fljimi është shkak edhe për një mirësi tjetër shumë të madhe: “Fatmirësia për të hyrë në grupin e besimtarëve të sinqertë.”

Ata

që jetojnë vetëm për interesat e tyre në këtë botë të sprovës, jetojnë të vegjël dhe do të vdesin të vegjël. Ndërsa ata që u japin vend edhe të tjerëve në jetën e tyre, marrin frymë nga ajri i Xhenetit në zemrat e tyre dhe do të veshin kurorën e krenarisë në këtë botë dhe në botën tjetër. Liderët dhe prijësit që kanë lënë gjurmë përgjatë gjithë historisë gjithmonë kanë dalë nga njerëzit flijues dhe me shpirt bujar.

1. Izutsu, Allahu dhe njeriu në Kuran (Përktheu në turqisht Sulejman Atesh), fq. 188.

2. Bekare, 128.

3. Izutsu, Allahu dhe njeriu në Kuran (Përktheu në turqisht Sulejman Atesh), fq. 187-190.



Të jesh pjesëtar i umetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili u dërgua si profet për të gjithë njerëzit me cilësitë: “Udhërrëfyes për në besim”, “Mëshirë për botët”, “Zotërues i një morali të lartë” dhe “Shembulli më i mirë”, padyshim se është mirësia dhe lumturia më e madhe.

Ku je, **o umeti i Muhamedit?**

.....
✦ *Ismail Lutfi Çakan* ✦
.....

Umeti është një strukturë sociale e mbështetur në lidhjen e besimit ndërmjet vëllezërve të fesë që ndërtohet me në qendër peygamberin. Umeti i Muhamedit është një koncept i gjerë me dy faza, që në veçanti shpreh shoqërinë njerëzore që i ka besuar të Dërguarit të Allahut (a.s.), pra, “Ummeti Ixhabet” dhe në përgjithësi shpreh shoqërinë njerëzore të cilës i drejtohet predikimi Islam, pra, “Ummeti Davet”. Ne, kur themi umet apo umeti i Muhamedit synojmë “umeti ixhabetin”, domethënë, myslimanët. Menjëherë le ta shpjegojmë se në këtë kuptim umeti i Muhamedit është një strukturë sociale dhe një realitet i formuar me traditën e Profetit Muhamed (a.s.).

Siç shprehet edhe në Kuranin Fisnik, edhe grupeve e shoqërive që kanë cilësi të caktuara dhe që zbatojnë urdhra e detyra të caktuara, u thuhet umet. Allahu Teala thotë: **“Le të dalë prej jush një umet (grup) që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”** (Al Imran, 104) Edhe për umetin e Muhamedit (duke përfshirë umeti ixhabetin) ndërmjet umeteve të lidhura ndaj të vërtetave të njëjta, përdoret i njëjti term: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica**

e tyre janë larg udhës së drejtë.” (Al Imran, 110)

Nisur nga këto që thamë më lart, Umeti i Muhamedit;

1. Mbart si medalje nderi ajetin fisnik: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin...”** (Al Imran, 110)

2. Është një umet që cilësia e tij themelore shprehet në ajetin fisnik: **“Ju ju kemi bërë një umet mesatar.”** (Bekare, 143)

3. Është një umet i ftuar nga ana e Hz. Ibrahimit dhe birit të tij, Ismailit (a.s.), nëpërmjet lutjes së tyre: **“O Zoti ynë! Na bëj të përulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përulur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!”** (Bekare, 128)

Të jesh pjesëtar i një umeti të tillë, domethënë, të jesh prej umetit të Muhamedit (a.s.), siç shprehet edhe i ndjeri Sulejman Çelebiu, sigurisht se është një “mirësi”. Kur Sulejman Çelebiu feston miraxhin e të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam, në Mevludin e tij, tregon se sahabët e nderuar kanë thënë:

“Neve na mjafton të qenët umeti yt.

Neve na mjafton shërbimi që të bëjmë ty.”

Të jesh pjesëtar i umetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili u dërgua si profet për të gjithë njerëzit me cilësitë: “Udhërrëfyes për në besim”, “Mëshirë për botët”, “Zotërues i një morali të lartë” dhe “Shembulli më i mirë”, padyshim se është mirësia dhe lumturia më e madhe.

UMETI MERHUME

Krahas cilësive të larta të umetit të Muhamedit që u shprehën në ajetin fisnik të mësipërm, gjendet edhe një cilësi e umetit që e mësojmë nga i Dërguari i Allahut (a.s.), e cila është: Umeti Merhume... Që do të thotë, umeti që ka fituar mirësinë, nderimin dhe begatinë hyjnore... I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, në një hadith fisnik që mbështetet te Ebu Musa el-Esh’ariu, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: “Me të vërtetë, ky umeti im është umeti merhume. Ai nuk do të ndëshkohet në Ahiret. Ndëshkimi

i tij është në këtë botë.” Pastaj tregon se ndëshkimi i këtij umeti në këtë botë do të jetë “me duart e tyre”, “ndërmjet tyre”, “përçarjet”, tërmetet” dhe “vrasjet”. (Shik. Ebu Davud, Fiten 7; Ibn Maxhe, Zuhd 34; Ahmed ibn Hanbel, Musned, IV, 408, 410, 418.)

Hadithi fisnik e vlerëson umetin e mirë si “një umet i tërë” brenda kornizës së umeteve. Prandaj ky hadith nuk duhet të kuptohet sikur asnjëherë nuk do të ndëshkohet ai që e ka merituar dhe që nuk është falur. Qëllimi i hadithit është ky: Në Ahiret umetet para nesh do të trajtohen sipas parimit të ndëshkimit në përputhje me mëkatin. Ndërsa umeti ynë do të trajtohet sipas parimit të mëshirës, faljes, mirësisë dhe dhembshurisë. Domethënë, Allahu Teala umetet e mëparshme do t’i trajtojë me drejtësinë e Tij, ndërsa këtë umet do ta trajtojë me mëshirën e Tij.

Pa dyshim se myslimanët duhet të jenë të ditur dhe të zgjuar për obligimet që lindin nga të qenët umet dhe duhet të jenë mjaft të kujdesshëm e të përpiqen pareshtur për t’i kryer përgjegjësitë e tyre kundrejt këtij sihariqi dhe veçanërisht kundrejt deklaramit e paralajmërimit se “ndëshkimi i atyre në këtë botë do të jenë përçarjet, tërmetet dhe vrasjet”. Përndryshe, gjendja e turpshme për të cilën flet i ndjeri Mehmet Akif Ersoji: “Ki turp o umeti merhume, ki turp nga ky emër që ke!” – do të jetë e pashmangshme.

Në të kaluarën, kur shfaqej ndonjë rrezik apo bëhej fjalë për ndonjë ngjarje negative, populli ynë kërkonte ndihmë duke thirrur me të madhe: “Ku je, o umeti i Muhamedit!” “A ka ndonjë nga umeti i Muhamedit që mund të na ndihmojë?” Populli ynë asnjëherë nuk thërriste në emër të familjes apo prejardhjes së tij dhe asnjëherë nuk nxirrte përpara ndonjë klasë sociale. Ky edukim kaq domethënës, kaq gjithpërfshirës dhe kaq reflektues më mirë kuptohet sot, ngaqë marrëdhëniet e pandjeshme dhe të dobëta me fqinjët dhe fanatizmi i papërballueshëm i grupacioneve kanë thurur mure ndërmjet njerëzve. Ekzistenca e të njëjtës gjendje edhe në marrëdhëniet ndërmjet popujve myslimanë dhe e vërteta se ata presin zgjidhje, mëshirë dhe ndihmë nga armiqtë e përbashkët të tyre, është burim i një dhimbjeje dhe vuajtjeje të thellë.



Qabja e zemrës do të ngelet e shkatërruar

Ahmed Saxhid Ekerim

Botë shpirtërore e njerëzve është tharë dhe pothuajse është shndërruar në një shkretëtirë. Rëra e kësaj shkretëtire po i gëlltit njerëzit, madje, të gjithë njerëzimin. Zjarret që s'po dinë të shuhen po vazhdojnë ta shkrumbojnë botën tonë shpirtërore. Tërmetet në besim po vazhdojnë ta shkatërrojnë qabën e zemrës sonë. Përse njerëzia, e cila po mbytet në epsh, nuk po gjen dot një rrugë tjetër për të shpëtuar? Përse? Vuajtjet dhe vajtimet po i bëjnë qiejt të rënkojnë në këtë kohë tonë, sepse, përderisa nënat tona të mos bëhen si Haxherja, qabeja e zemrës do të ngelet e shkatërruar. Përderisa nëna të mos jetë në pikën kulmore në dhembshuri, sakrificë, përgjegjësi dhe në mbajtjen e drejtësisë, në jetë nuk vijnë dot breza që do ta ndërtojnë qabën e zemrës.

Plaga shpirtërore e botës së njerëzisë është e madhe. Ajo është një plagë që e kanë hapur shpirtat tiranë e të pamëshirshëm, të cilët janë robër të epshit dhe skllëvër të pasurisë. Prandaj mos i harroni, o miq, lajmet që na e bëjnë zemrën copë... Foshnjat e braktisura, të vegjlit që harrohen në shtëpi dhe për të cilët prindërit kujtohen pas disa muajsh, zemrat e vogla që shpëputen nga prindërit dhe u trafikohen organet... Si ka mundësi që një nënë ta bëjë këtë? Çfarë babai është ky? Çfarë njeriu është ky? A nuk kanë zemër njeriu njerëzit e tillë? Rezultat i cilit botëkuptim është ky?

Përderisa nënat tona të mos bëhen modeste, të dorëzuara ndaj caktimit që u ka vendosur Allahu (xh. xh.) dhe guximtare si nëna jonë Haxherja, përderisa të mos jenë të ndershme si nëna jonë Merjemja, përderisa të mos jenë burrëresha dhe të mëshirshme si nëna jonë Asija, përderisa të mos jenë bujare dhe zemërgjera si nëna jonë Hatixhja, para së gjithash, përderisa të mos e duan dhe të mos i frikësohen Allahut të Lartësuar, kjo është një nyje/problem që nuk mund të zgjidhet.

Sa më shumë të mendoj, aq më shumë më vjen turp nga engjëjt dhe nga babai ynë Ademi (a.s.). Gjithashtu, turpërohem edhe nga bashkëshortja e tij e bekuar, nëna jona Havaja. A në këtë gjendje do të vinte njerëzimi? A në këtë gjendje duhej të gjendeshim? Më vjen turp aq sa thellësia e dhimbjes së zemrës së prindërve që nuk mund t'i harrojnë dot dhimbjet e fëmijëve të tyre që grabiten dhe pas shumë vitesh u gjenden kockat. Po atyre që nuk kanë turp, çfarë duhet t'u themi? A nuk është e mjaftueshme që të thuhet se turpi është nga besimi dhe turpi është nga të qenët njeri? Për këtë arsye, ndoshta duhet ta falënderojmë Zotin (xh.xh.), që e ka krijuar Xhehenemin.

Përderisa nënat tona të mos bëhen si Merjemja, qabeja e zemrës do të ngelet e shkatërruar. Përderisa të mos e gjejnë Krijuesin njerëzit e pashpirt e tiranë që janë zhytur dhe po mbyten në epsh, shumë breza do të jenë të humbur dhe do të shkatërrohen nën gërmadhat e zemrave dhe rrënojat e moralit. Virtytet do të zhduken nëpër shtigjet e errëta. Fitorja nuk do të jetë e njerëzimit, por e armikut më të madh të tij. Nefsi i njeriut do të ulet në fron, ndërsa njerëzimi do të përfshihet nga fatkeqësitë dhe skamja.

Sipas të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, nëna është pasqyra e mëshirës së Allahut Teala. A nuk ka thënë: *“Allahu ju do më shumë seç do kjo grua të voglin e saj që po e kërkonte si e çmendur dhe që e përqafoi me plot dhembshuri e dashuri kur e gjeti. Mëshira e Tij është më e madhe dhe e pakufishme nga mëshira e kësaj nëne.”*¹

A nuk pati pyetur i Dërguari i Allahut (a.s.): *“A e hedh në zjarr një nënë fëmijën e saj që e mbron në këtë mënyrë?”* Ku janë nënat e tilla? Pse sot nënat tona ua shkatërrojnë fëmijëve të tyre jetën shpirtërore? Po ato që ua shkatërrojnë atyre jetën e kësaj bote? Po ato që i hedhin fëmijët e tyre nën presionin e kësaj bote shekullariste?

Përderisa nënat të mos bëhen si nëna jonë, Asija që e përqafoi foshnjën Musa, pra, pejgamberin e nderuar të së ardhmes, shejtani gjithmonë do të ulet në fronin e zemrës. Fëmijët dhe myslimanët që rriten me përrallat e njerëzive që janë si historitë e shtrigave,

do ta mashtrojnë veten me imagjinatat që thurin për brezin e artë. Ah more miq! Nënë është ajo që e merr parasysh vdekjen edhe për një foshnjë që nuk është fëmija i saj. Ajo duhet të qëndrojë në këmbë për hir të moralit dhe edukatës, edhe nëse gjendet përballë Faraonit.

Kujtojeni, o miqtë e mi, gruan që e la Musain foshnjë me djepin prej dërrase si një varkë ndër-mjet krokodilëve dhe gjarpërinjve të lumit Nil!

Kujtojeni atë grua që me një frymëzim të lartë e shpëtoi foshnjën e saj nga dora e një tirani që vriste fëmijët! Kujtojeni atë grua që e shikonte me një brengosje dhe një mbështetje të pashoqe te Zoti (xh.xh.), foshnjën, zemrën dhe shpirtin e saj duke ia lënë amanet Allahut Teala, ndërkohë që



Të flasim për “nënë” që e ka zemrën det dashurie, që është e fortë si malet në trimëri dhe që e bën shiun të xhelozohet kur bëhet fjalë për bujarinë. Të flasim për nënën që e ka emrin Emine, Havva, Merjeme, Asije, Hatixhe, Fatime etj. dhe që ka cilësi të veçanta.

uji ishte i thellë dhe i mbushur plot me krokodilë e gjarpërinj! Atë foshnje nuk e dëmtuan as krokodilët, as gjarpërinjtë dhe as Nili i stërgjatë, sepse mbi të gjendej lutja e nënës dhe mbrojtja e Allahut të Lartësuar. Po ato që në këtë shekull i dorëzojnë pa asnjë lutje fëmijët e tyre te droga, epshi i pakufizuar, alkooli, të cilët janë më tiranë se Faraoni? O miq! Mos harroni se çdo njeri dikur ka qenë një foshnje.

Atëherë o miqtë e mi, ejani dhe të flasim sërish për sa i përket “Nënës”. Të flasim për “nënë” që e ka zemrën det dashurie, që është e fortë si malet në trimëri dhe që e bën shiun të xhelozohet kur bëhet fjalë për bujarinë. Të flasim për nënën që e ka emrin Emine, Havva, Merjeme, Asije, Hatixhe, Fatime etj. dhe që ka cilësi të veçanta. Një popull nuk mund të ngjallet nëse nënat nuk janë si Ummu’l-Kura / Meka dhe Medina, të cilat e kanë zemrën plot dashuri dhe krahët e hapura. Ja pra, jo fëmija, por nëna është ajo që e ka lindur të ardhmen, që i rrit civilizimet, që i ka ninullat dhikër dhe këshillat mendime.

Unë kam një fjalë për të gjitha nënat që na merr malli dhe për të gjitha nënat e vërteta: Xheneti është xheloz për bukurinë tuaj. Trëndafilat rriten me dritën tuaj... Udhërrëfyesi ynë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tregon për katër gratë më të larta dhe katër nënat e bekuara të Xhenetit: *“Gratë më të larta të Xhenetit janë Merjemja, Hatixhja, Fatimja dhe Asija.”*²

1. Muslim, Sahih, vëll. 4, h 2109.

2. Ahmed ibn Hanbel, vëll. 5, fq. 113.



Xhafer Durmush



Një flad nga surja KEHF

Në njëren prej tri historive në suren Kehf bëhet fjalë për takimin dhe udhëtimin e Musait (a.s.), me Hizrin (a.s.). Takimi për të cilin po flasim ndodhi pas udhëtimit plot urtësi të Musait (a.s.), me “një djalosh”, i cili ishte ndihmësi i tij. Takimi i Hizrit (a.s.), për të cilin thuhet në Kuranin Fisnik: **“Dhe gjetën një prej robërve Tanë, të cilit i patëm dhuruar mëshirë prej Nesh dhe i kishim mësuar nga ana Jonë dije.”** (Kehf, 65), me Musain (a.s.), tregohet kështu në ajetet fisnike: Në fillim Musai (a.s.), i tha: **“...A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?”** (Kehf, 66) Ndërsa Hizri (a.s.), i dha këtë përgjigje: **“...Ti nuk mund të durosh dot me mua! E si mund të durosh (pa pyetur) para diçkaje për të cilën nuk di asgjë?”** (Kehf, 67-68) Edhe pse Musai (a.s.), i tha Hizrit (a.s.): **“...Do të më gjesh të durueshëm, në dashtë Allahu e nuk do të të kundërshtoj për asgjë.”** (Kehf, 69), Hizri (a.s.), prapë se prapë ia ktheu: **“...Nëse vjen pas meje, mos më pyet për asgjë, derisa të ta shpjegoj unë!”** (Kehf, 70)

Përgjatë këtij udhëtimi, për të cilin flitet ndërmjet ajeteve 65 dhe 82 të sures Kehf, Hizri (a.s.), e shpoi anijen në të cilën hipën, e vrau një fëmijë që e takuan dhe e ngriti pa pagesë një mur që ishte në shkatërrim e sipër në një vend ku njerëzit nuk i pranuan si mysafirë. Sigurisht se pas secilës prej këtyre ngjarjeve Musai (a.s.), e pa të nevojshme për ta pyetur Hizrin (a.s.), rreth shkakut. Për të dy pyetjet e para mori përgjigjen: **“...A nuk të thashë se ti nuk mund të du-**

rosh me mua?” (Kehf, 72, 75) Ndërsa pas pyetjes së tretë, Hizri (a.s.), i dha disa informacione rreth urtësisë së atyre që bëri duke i thënë: **“...Kjo është ndarja ndërmjet meje dhe teje. Unë do t'i shpjegoj ty ato gjëra për të cilat nuk mund të durosh.”** (Kehf, 78) Shpjegimi i Hizrit (a.s.), transmetohet kështu në ajetet fisnike:

“Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e disa të varfërve, që punonin në det. Unë desha ta dëmtoj, sepse prapa tyre gjendej një mbret i cili merrte me dhunë çdo anije të mirë. Sa për djaloshin, prindërit e tij ishin besimtarë. Ne e dinim se (dashuria për të) do t'i çonte ata në të keqe dhe mohim dhe dëshiroam që Zoti i tyre, në vend të atij t'u jepte një më të mirë, më të pastër dhe më të mëshirshëm. E, sa i përket murit, ai u takonte dy djelmohave jetimë në qytet dhe, nën të gjendej një thesar i tyre. Babai i tyre kishte qenë njeri i mirë, prandaj Zoti yt dëshiroi që ata të arrinin moshën e pjekurisë e ta nxirrnin thesarin e tyre, si mëshirë nga Zoti yt. Unë këtë nuk e kam bërë sipas gjykimit tim. Ky është shpjegimi i asaj, për të cilën ti s'munde të duroje!” (Kehf, 79-82)

Në këto ajete te bekuara janë cekur disa urtësi për t'i dhënë përgjigje pyetjes së Musait (a.s.). Ai (a.s.), nuk e kundërshtoi shpjegimin që iu bë. Domethënë se gjërat që në pamjen e jashtme duken të këqija, në të vërtetë mund të mos jenë ashtu. Besimtari nuk duhet të kundërshtojë menjëherë në çështjet që të mëdhenjtë i shohin të përshtatshme apo e anashkalojnë me heshtje. Për këtë arsye, në lidhje me ligjet

dhe dispozitat e Allahut të Lartësuar duhet të jetë i nënshtruar duke menduar se në to ka urtësi, edhe pse ai nuk i ka kuptuar ende.

Përveç të tjerash, mund të themi edhe këtë: Shkaqet e padukshme nganjëherë mund të mos kuptohen siç duhet, por kjo nuk do të thotë se sheriati me hakikatin bien ndesh me njëri-tjetrin, sepse sheriati është ligji i Allahut Teala. Kështu që kur Hizri (a.s.), të cilit i ishte treguar e fshehta, bëri shpjegimin e të vërtetës së çështjes, Musai (a.s.), e kuptoi se nuk kishte vend për të kundërshtuar dhe e konceptoi urtësinë që gjendej pas ngjarjeve. Nisur nga këto që thamë kuptojmë se për të gjitha punët që nuk rezultojnë siç duam edhe pse i kemi marrë të gjitha masat, duhet të strehohemi në limanin e mbështetjes tek Zoti (xh.sh.), e nënshtrimit ndaj Tij dhe e pranimit të çdo gjëje që vjen nga Ai. Çështja e vrasjes së djaloshit, e cila dukej sikur nuk kishte shpjegim, është shembulli më i qartë për këtë. Gjithashtu është edhe shembulli më i spikatur që na mëson të themi: “Ai është që jep dhe që merr.” – në kohë të vështira.

Nisur nga këto, edhe një herë e kuptojmë se nganjëherë duhet të marrim frymë thellë ndërmjet baticave dhe zbaticave të jetës. Duhet të marrim frymë thellë dhe ta hetojmë atë frymë. Duhet ta forcojmë besimin se asnjë gjethë nuk bie pa lejen e Allahut të Madhëruar. Shpatat e kundërshtimit gjithmonë

duhet t'i mbajmë në këllëfin e tyre me frikën se mos i përdorim me vend e pa vend. Të mos harrojmë se Allahu Teala çdo gjë e bën me urtësi. Ajo që na takon të bëjmë është përpjekja siç na urdhëron feja jonë e shenjtë. Në ajetin fisnik thuhet:

“...Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.” (Bekare, 216) I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, na përgëzon duke thënë: *“Gjendja e besimtarit është e çuditshme, sepse çdo situatë e tij është një e mirë për të. Një cilësi e tillë gjendet vetëm te besimtari. Nëse gëzohet, e falënderon (Zotin) dhe kjo është e mirë për të. Nëse i ndodh ndonjë gjë e keqe, duron dhe kjo është e mirë për të.”* (Muslim, Zuhd, 64.) Siç shikohet, nganjëherë një e keqe e vogël bëhet shkak për ndalimin e një të keqeje më të madhe. Vdekja e një djali të ri mund t'i mbrojë të afërmit nga kufri dhe devijimi, të cilët në fund kanë humbjen e përhershme. Pozita e lartë që prindërit e devotshëm kanë te Allahu i Lartësuar mund ta shpëtojë të ardhmen e brezave pasardhës.

Kur të biem në gjunjë përpara fjalës së Allahut Teala me këto mendime dhe të tjera të ngjashme me to, besojmë se nga aty do të hapen fushat e frymëmarrjes që do na i bëjnë të lehta dhe të përballeshme vështirësitë e jetës.

Lexo Mendo

KURANI ËSHTË BASIRET

“Ky Kuran është tregues i qartë, udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që kanë besim të patundur.” (Xhathije, 20)

Basiret do të thotë ndjenjë, largpamësi dhe të ndjerit e të kuptuarit e të vërtetës me anë të zemrës. Sejjid Sherif Xhurxhani thotë: “Basireti është fuqia e një zemre të ndriçuar me nurin e shenjtë. Me anë të kësaj fuqie njeriu sheh brendësinë, kuptimin dhe të vërtetën e gjërave. Basireti është funksionimi i syrit të zemrës.”

Thuhet se njeriu, siç ka aftësinë për të parë gjërat me sytë e tij, edhe zemra ka ndjesinë për ta njohur Krijuesin e gjërave. Por siç kemi nevojë për dritë, në mënyrë që të shohim, edhe zemra bëhet largpamëse vetëm kur ndriçohet me dritën e besimit e të Kuranit. Në këtë mënyrë, e sheh të vërtetën dhe të fshehtë e gjërave. Ja, një zemër e tillë e gjen autorin nëpërmjet veprës.



Fjala “basair”, që përdoret në ajetin fisnik i është ngarkuar Kuranit duke u nisur nga të gjitha pjesët dhe ajetet e tij, sepse Kuran Fisnik është një dritë me të cilën mund të shikohen çështjet që kuptohen me mendje. Nisur nga kjo, në surren En’am thuhet: **“Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj basirete / prova të qarta.”** (En’am, 104) Edhe i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, ka thënë:

“Kurani ju diagnostikon sëmundjen tuaj dhe ju tregon rrugët e shërimit. Sipas Kuranit, sëmundja juaj janë mëkatet, ndërsa shërimi i saj është istigfari / kërkimi i faljes nga Zoti. Mëkati më i madh është shirku, ndërsa ilaçi i tij është tevhid.” (Dejlemi, Hadithi nr: 4676.)

Allahu i Madhëruar i bëftë sytë dhe gjuhën tonë të familjarizuar me ajetet të cilat do t'i ndriçojnë zemrat tona me dritat e basiretit! Amin!



“Koha kur nuk mendoj është koha kur nuk jetoj.”

(Rembrandt)

Apel për të menduar

— Idris Arpat —

Njeriu është i obliguar të bëjë një jetë të lartë dhe sublime, sepse ai është krijuar në ahseni takvim / në formën më të bukur. Domethënë, njeriu ka një potencial shumë të fuqishëm mendor, emocional dhe shpirtëror. Të bësh një jetë të pavlefshme dhe të kthehesh në kafshë brenda natyrshmërisë njerëzore, nuk është diçka që u shkon bijve të Ademit (njerëzve).

Ngjarje tragjike, por dhe të mira ndodhin vazhdimisht para syve të njerëzve. Nga sytë për te zemra, detyrimisht ka një rrugë. Domethënë, çdo gjë që ndodh ndikon te njeriu dhe njeriu nuk mund të rrijë i painteresuar kundrejt atyre që ndodhin. Pas çdo ngjarjeje njeriu merr një mesazh pozitiv apo negativ, sepse njeriu nuk është as gur dhe as bronz. Atëherë, natyra e ngjarjeve me të cilat përballlet njeriu dhe kimia e atmosferës sociale e kulturore, u intereson atyre që mendojnë për fatin e njerëzisë. Asnjëherë nuk mund të bëhen përpjekje duke i neglizhuar kushtet ekzistuese dhe duke nënvlerësuar se çfarë sheh, çfarë mendon dhe çfarë flet bota.

Dashi që nesër do të bëhet kurban mund të flejë

rehat sonte, por si kalojnë vallë minutat e një të dënuari me ekzekutim? Kjo është e vështirë për t'u kuptuar.

Njeriu ose do t'u gjejë përgjigje të drejta dhe bindëse pyetjeve: “Çfarë jam unë? Çfarë pune kam në këtë botë? Çfarë ka përtej jetës?” – ose do të bëhet i varur nga droga. Siç shprehet edhe i ndjeri Xhemil Meriçi: “Ose do të falë namaz, ose do të pijë alkool. Rrugë të tretë nuk ka. Njeriu nuk mund të gjejë një rrugë të tretë me natyrshmërinë që ka. Prandaj është e pamundur që të arrihet prehja dhe lumturia në jetë pa u takuar me Allahut (xh.xh.).”

Kjo është një e vërtetë që dihet nga të gjithë se “njeriu është një pikë gjaku dhe mijëra shqetësime”. Për këtë arsye, besimi është ai xhevahiri që i pakëson shqetësimet deri diku. Nëse njeriu nuk ua gjen një përgjigje të saktë pyetjeve që i parashtruan, vazhdimisht do të ketë kontradikta me natyrshmërinë e tij dhe do të hyjë në fazën e fillimit të fundit të tij.

Në këtë pikë duhet të flasim për mendjen, shpalljen hyjnore, ndërgjegjen dhe vullnetin:

Kur mendja bashkohet me shpalljen hyjnore, ato

na e ndriçojnë rrugën tonë. Mendja është sy, ndërsa shpallja është dritë. “Mendja është Pejgamberi brenda nesh, ndërsa Pejgamberi është mendja jashtë nesh.” Njeriu asnjëherë nuk mund të heqë dorë nga mendja dhe shpallja. Me mendje mund të shkojmë deri diku. Ndërsa shpallja hyjnore është ajo që mund të na lajmërojë nga bota e gajbit. Prandaj është e pamundur të shkohet deri në fund të rrugës vetëm me mendje.

Ndërgjegjja është “zëri i Allahut (xh.xh.), që jehon nga brendësia jonë”. Ndërgjegjen është e pamundur ta bësh të heshtë pa e vrarë.

Ndërsa vullneti është aftësia për të zgjedhur dhe fuqia që njeriu ta shtyjë veten drejt orientimeve të caktuara. Pra, është fuqia për t’ia imponuar vetes diçka. Është fuqia që bën të lind durimin dhe e mëson njeriun të shtrëngojë dhëmbët (ta përballojë situatën).

Ata që nuk mund të shohin përtej horizonteve të kësaj bote, e kanë punën shumë të vështirë. Njeriu nuk do të gjejë dot përgjigje pa Xhenetin për dëshirat e tij që shtrihen deri në pafundësi. Zemra nuk do t’i ndalojë dot rrahjet e saj dhe nuk do t’i mposhtë shqetësimet. Ngado që ky njeri të kthehet, do të përballlet me njerëz të shkretë si vetja. Kjo do ta shtyjë atë drejt paqëndrueshmërive dhe trazimeve të pafundme...

Nëse njeriu dëshiron t’i japë një horizont, thellësi dhe diversitet botës shpirtërore të tij, nëse dëshiron të arrijë një prehje qoftë edhe të pjesshme, duhet ta gjejë mikun dhe ndihmësin e tij të vërtetë dhe ta njohë atdheun e tij real. Përndryshe, do të digjet e përmllohet duke kënduar këngë popullore në vende të huaja. Pastaj do të thotë: “Shoh dëborën duke rënë nga dritarja. Aman o Zot! Kurbeti po më vjen shumë i vështirë. Njerëz ka shumë, por unë skam asnjë.”

Nëse gjendja është e tillë, njeriu patjetër është i detyruar ta mendojë mirë pozitën e tij.

Tani le të mendojmë dhe ta shtjellojmë temën tonë:

Për të dhënë një vendim të saktë, është kusht që të kesh dije dhe mendim të saktë. Vendimi i drejtë

sjell një jetë të vërtetë. Kurani Fisnik është një dije në të cilën nuk ka dyshim. Edhe lutja e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në formën: “O Zot! Ma trego të vërtetën e gjërave ashtu siç është!” – është kërkesë për rezultatet e punimeve shkencore që mbështeten në

eksperimente dhe vrojtime. Që të dyja dijet janë të nevojshme për ne. Për këtë arsye, dijet nuk mund t’i ndajmë në dije fetare dhe dije të kësaj bote. Çdo dije na tregon madhësinë e esmau’l-husnas. Çdo dije është fetare. Çdo dije është kuranore. Ne nuk mund të heqim dorë as nga ajetet e Kuranit Fisnik dhe as nga argumentet e universit.

Pa dije është e pamundur të lartësohesh dhe të arrish majat. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), është shprehur: “*Mësimi i dijes dhe të mësuarit e saj vëllezërve të tjerë është besnikëri ndaj besimit.*”

Ajnshtajni ka thënë: “Me kërkimet që bëj dua të kuptoj se çfarë mendon Zoti.” Ky është një kërkim që duhet të vlerësohet shumë dhe një përpjekje që të shpie te mendimet sublimë. Një hap më tutje, ndoshta mund të jetë “përpjekja për ta përsosur moralin siç e kërkon Allahu Teala”. Sa bukur do të ishte po ta kishte umeti i Muhamedit (a.s.), këtë vullnet për kërkime dhe studime të tilla! Ndoshta Allahu Teala dëshiron t’i japë njerëzimit mirësi të mëdha nëpërmjet zemrave dhe kokave të këtyre njerëzve të mëdhenj. Ndoshta dëshiron që njerëzve t’ua rrisë mirëqenien dhe t’i lartësojë. Allahu i Lartësuar nuk i ka krijuar rastësisht gjenitë.

Si kanë qenë mendimet e njerëzve të mëdhenj në lidhje me jetën e përditshme dhe të ardhmen e sho-

qërisë, si kanë qenë këndvështrimet e tyre ndaj mjediseve që i rrethonin dhe si kanë qenë sjelljet e tyre kundrejt ngjarjeve të mëdha që e kalojnë perceptimin e njeriut? Për çfarë mallëngjeheshin ata dhe për çfarë gëzoheshin? Në cilat vepra mendonin se kënaqësia e Allahut gjendej më së shumti? Cilat ishin gjendjet që i lumturonin shumë ata? Ah sikur t’i lexonim veprat kryesore të tyre dhe të merrnim njohuri për dhimbjet dhe gëzimet e tyre! Ah sikur të



Njeriu duhet të thotë gjithmonë të vërtetën për gjërat që i di. Ai nuk duhet t’ia vërë veshin se çfarë kanë thënë apo do të thonë të tjerët përveç Allahut të Lartësuar. As armiqësia dhe as lajkat nuk janë punë. Punë e vërtetë është që të jetosh me mendje, logjikë, vullnet dhe ndërgjegje. Gjithashtu të bëhesh mësuesi i asaj që e di dhe nxënësi i asaj që nuk e di përgjatë gjithë jetës.

shihnim se çfarë roli i kanë përcaktuar vetes!.. Kjo mendoj se do na jepte shumë për të fituar.

Si mund t'i bëjmë njerëzit që të arrijnë mendime më sublimë dhe ndjenja më të pastra? Mos vallë njerëzit janë të detyruar që patjetër të nxjerrin armiqësi dhe ta vrasin njëri-tjetrin duke shkaktuar luftëra? Si mund të bëhet kjo botë më e pastër dhe më njerëzore? Njerëzit vazhdimisht mallëngjehen për një botë më të moralshme dhe më të bukur. Mos vallë majaja e njeriut është mbrujtur me përmallimin e Xhenetit? Unë mendoj se do të ishte shumë mirë sikur të kishim informacione të thella për natyrshmërinë dhe psikologjinë e njeriut.

* * *

Cilat mendime dhe ndjenja aprovon Kurani Fisnik? Cilat janë kushtet e Kuranit? Cilat janë vijat e kuqe të tij?

* * *

Njeriu duhet të mendojë rreth vetes së tij. Ai duhet t'i rishikojë edhe një herë natyrshmërinë, të drejtat dhe detyrat e tij. Gjithashtu duhet ta shtjellojë edhe një herë se si dëshiron Allahu Teala të sillemi me njerëzit dhe mjedisin. Si do të ishte një botë që Allahu dëshiron të formojnë dhe që i përgjigjet pa asnjë mangësi natyrshmërisë së njeriut?

* * *

Siç shprehet edhe Dyxhane Xhyndiogllu, “ne si myslimanë kemi shumë nevojë për dy gjëra: Sinqeritetin dhe përpjekjen. Kur të mos kemi sinqeritet, e bëjmë shejtanin për të qeshur. Kur të mos kemi përpjekjen, e bëjmë armikun për të qeshur. Ndërsa kur t'i kemi të dyja, nuk do të ngelet asnjë pengesë që të na ndalojë për ta fituar këtë botë dhe botën tjetër inshallah.” (D. Xhyndiogllu, Rreth Historisë dhe Politikës, fq. 63, Botimi i 1-rë, 2005.)

Për të pasur sinqeritetin dhe përpjekjen, më shumë se sasisë duhet t'i japim rëndësi cilësisë. Sasia asnjëherë nuk mund ta zërë vendin e cilësisë. Njëqind burra gjysmakë nuk bëjnë pesëdhjetë burra të plotë, por njëqind burra gjysmakë. Qindra dhi nuk mund ta zënë vendin e bariut. Del një Pejgamber dhe me lejen e Allahut e ndryshon rrjedhën e jetës, ndërsa dy miliardë myslimanë nuk mund t'i japin asgjë kësaj jete. Ata vazhdimisht rrihen nga armiqtë. Përveç të tjerash, i pandehin si varëse zinxhirët e robërisë që kanë në qafë. Ka edhe më keq, ata bien në dashuri me xhelatin e tyre.

Përse ndodh diçka e tillë? Sepse nuk është konceptuar rëndësia e përdorimit të energjisë së trurit, krahut dhe zemrës. Durimi është keqkuptuar. Ata nuk janë bërë dot të zotët e vizionit dhe misionit.

Idealizmi ka vdekur. Ata pandehin se është e mjaftueshme që të lexosh, kështu që nuk është konceptuar rëndësia e prodhimit të dijes.

* * *

Le t'i lexojmë edhe këto pjesë të shkëputura nga disa libra:

“Çdo gjë të vendeve myslimane e kemi shkatërruar. Filozofinë e tyre, fenë e tyre... Në personalitetet e tyre kemi bërë zbrazëtira të mëdha. Tani janë të gatshëm për anarki dhe vetëvrasje.” (Luis Massignon)

Deri në kohën e Hrushovit rusët kanë vrarë dy milion kazakë. Pastaj Hrushovi ka thënë: “Përse sillemi si budallenj? Neve na duhen hamallë besnikë. Anglezët këtë po e bëjnë shumë mirë. Ata e ndryshojnë gjuhën e popullit nën petkun e civilizimit dhe ua bëjnë kokën operacion. Pastaj fitojnë hamallë që punojnë deri në pafundësi. Prandaj edhe ne le të veprojmë kështu.”

Tani dyzet për qind e kazakëve nuk e dinë gjuhën e tyre.

Një profesor izraelit u tha algjerianëve në një mbledhje ndërkombëtare: “Ju dikur keni qenë nën pushtimin e Francës. Ushtarët francezë ecnin nëpër rrugë, por nuk hynin në shtëpitë tuaja. Tani ushtarët francezë kanë dalë nga Algjeria, por televizori francez ka hyrë në shtëpitë tuaja.” (Sebahattin Zaim, Revista Alltënolluk, Tetor – 1996.)

* * *

“Atëherë çfarë duhet të bëjmë?”

Ne kemi nevojë për punëtorë të mendjes që vazhdimisht punojnë me thjeshtësi, madhështi dhe qetësi. Çfarë ta bëjmë famën dhe namin? Neve na mjafton të qenët të natyrshëm dhe të ndershëm.

Njeriu duhet t'i thotë vazhdimisht gjërat që i di saktë. Ai nuk duhet t'ia vërë veshin se çfarë kanë thënë apo do të thonë të tjerët përveç Allahut të Lartësuar. As armiqësia dhe as lajkat nuk janë punë. Punë e vërtetë është që të jetosh me mendje, logjikë, vullnet dhe ndërgjegje. Gjithashtu të bëhesh mësuesi i asaj që e di dhe nxënësi i asaj që nuk e di përgjatë gjithë jetës. Të mësuarin dhe të mësuarit e të tjerëve duhet ta bëjmë stil të jetës sonë. Ne duhet të jemi të kënaqur kur të shohim njerëz që punojnë në të njëjtin drejtim me ne. Asnjëherë nuk duhet të hezitojmë që të vërtetës t'i themi e vërtetë dhe të gabuarës e gabuar. Përveç të tjerash, nuk duhet të heshtim në çështjen e gabimeve dhe nuk duhet ta pranojmë djallëzinë e pa gjuhë. Për çdo mendim duhet të jemi të kujdesshëm që të zëmë vendin tonë te e drejta dhe e vërteta. Hatri i Zotit duhet të ketë përparësi ndaj hatrit të të tjerëve.”

T'i lehtësojmë *Zemrat tona*

Mehmet Dinç

E di miku im. Ti je shumë i ndjeshëm kundrejt njeriut dhe çdo gjëje që i përket atij. Ti dëshiron që njerëzit gjithmonë të jenë në mirëqenie dhe në lumturi. Gjithashtu shpreson që asnjë njeri të mos i bëjë dëm në asnjë mënyrë ndonjë njeriu tjetër. Kur ndodh e kundërta, gjë që është e pamundur të mos ndodhë, mërzitësh jashtëzakonisht. Ti qan për një fëmijë të vogël që e humbet krahun e tij në Irak, për një grua të shkretë që ngel vejushë në Palestinë dhe për një njeri të dëshpëruar që rrëkeja ia shkatërron shtëpinë në Amerikë. Ato që i shikon te njerëzit që i ke shumë pranë të mërztisë më shumë se ato që i ke larg. Biri i fqinjit që është i varur nga droga, familja e të afërmve që copëtohet si rezultat i divorcit të tyre dhe babai i kolegut të punës që ka pësuar aksident në trafik, gjithmonë ta plagosin zemrën. Ndryshimet e bukura që dëshiron t'i bësh në jetën dhe familjen tënde, por që s'arrin t'i bësh dot në asnjë mënyrë, sjelljet e bashkëshortes që nuk të pëlqejnë, dëshimet e birit tënd, dëshpërimet e vajzës tënde dhe së fundi, përpjekja për t'u bërë njeriu që dëshiron të bëhesh por që nuk bëhesh dot, të detyron që ta shohësh të kaluarën dhe të tashmen me lot në sy. Pastaj fillon të mendosh: "Çfarë kam bërë gabim? Ku kam gabuar?" Ti dëshiron të bësh diçka për t'i

rregulluar gjërat, mendon të bësh punë të dobishme për familjen dhe shoqërinë, por ja që sytë e këqij të shohin dhe të bëjnë t'i ndjesh në çdo punë që merr përsipër dhe në çdo iniciativë që ndërmerr. Si rezultat, fillon të të pakësohet besimi te fitorja absolute e mirësisë, bukurisë dhe ndershmërisë. Pastaj fillon t'i ndërpresësh lidhjet, t'i pakësosh aktivitetet dhe t'i humbasësh ndjenjat e tua. Pastaj dëshiron që të mos dëgjosh, të mos i shikosh, të mos i mendosh dhe të mos mërztësh për të gjitha gjërat. Në këtë mënyrë përpiqesh të mbyllesh në vetvete, madje fillon ta hetosh edhe veten tënde. Për këtë arsye, pikëllimi dhe brengosja sa vijnë dhe të shtohen.

Eja një herë këtu dhe le të mendojmë. Me të vërtetë, mos vallë janë gabim ato që bën apo këndvështrimi yt ndaj rezultateve të atyre që bën? Ato që bën mund të jenë të drejta, por rezultatet e tyre mund të mos dalin siç dëshiron ti. Çdo gjë bëhet siç duhet të jetë dhe ti e ke bërë atë që të takon. Nëse rezultatet e përpjekjeve, mundimeve dhe punëve të tua nuk dalin ashtu siç dëshiroje, ti nuk je fajtor për këtë. Jeta vazhdon të rrjedhë sipas skenarit të saj. Ndërsa ne jemi të obliguar të luajmë rolin tonë që na takon në këtë skenar dhe nuk kemi asnjë obligim për ta caktuar atë që do të ndodhë në skemën e ardhshme. Por sidoqoftë, asnjëherë nuk duhet ta lëmë apo ta harrojmë rolin e jetës sonë, ngaqë ajo nuk shkon siç dëshirojmë. Ne duhet të bëjmë atë që na takon dhe më në fund ta mbyllim historinë e jetës me djersën e ballit. Sigurisht se përgjatë kësaj kohe shpirtin tonë nuk do ta mbushim vetëm me optimizëm dhe shpresë. Për këtë arsye, duhet t'i lëmë pak vend edhe marrjes së masave, në mënyrë që të mos na shkatërrohet jeta kur të mos shkojë siç duam.

Ndërkohë që e vazhdojmë rrugën tonë, duhet të bëjmë kujdes që sjelljet tona të mos i shkaktojnë dhimbje, lëndim dhe dëshpërim asnjë njeriu, duhet t'i fshijmë sytë e përbotur, duhet ta qetësojmë zemrën e dëshpëruar, duhet ta përkëdhelim kokën e ulur dhe duhet të përpiqemi për ta rregulluar zemrën e thyer. Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë se një mirësi që bëhet në këtë botë, absolutisht do t'i kthehet të zotit, për një afat të shkurtër apo të gjatë. Për këtë arsye, ndërkohë që ua lehtësojmë barrën të tjerëve me çdo punë të mirë që bëjmë, lehtësojmë edhe barrën tonë.





MYSAFIRI VJEN ME RISKUN E TIJ

NDËRSA SEVAPI I NGELET MIKPRITËSIT

Dr. Durak Pasmaz

Abdullah ibn Amr ibn Asi ishte njëri prej njerëzve më asketë ndërmjet sahabëve të nderuar. Ai i ishte kushtuar ibadetit e adhurimit. Ai agjëronte gjatë ditës dhe lexonte Kuran gjatë natës. Madje, preokupohej aq shumë me adhurimin, sa që e pati nënvlerësuar bashkëshorten e tij me të cilën sapo ishte martuar. Nisur nga kjo, bashkëshortja e tij iu ankua të Dërguarit të Allahut (a.s.), për këtë gjendje. Në epokën e lumturisë gratë myslimane nuk hezitonin t'ia tregonin të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, problemet e tyre familjare. Pejgamberi (a.s.), e thirri Abdullahun dhe e qortoi, ia bëri të qartë se nuk duhej të vepronte në atë mënyrë dhe pastaj i tha: *“Sepse bashkëshortja jote ka të drejtat e saj mbi ty. Mysafirët kanë të drejtat e tyre mbi ty. Edhe trupi gjithashtu ka të drejtat e tij mbi ty.”*¹

Nga hadithi fisnik kuptohet mjaft qartë se mysafiri ka të drejta mbi të zotin e shtëpisë. Kjo e drejtë është që i zoti i shtëpisë ta presë dhe ta nderojë mysafirin që i vjen në shtëpinë e tij. Pritja dhe nderimi i mysafirit nuk është një mirësi, por është e drejta e mysafirit mbi të zotin e shtëpisë ku ai shkon për mik. Nisur nga kjo, ai që e nderon mysafirin nuk i ka bërë ndonjë mirësi atij, por thjeshtë i ka dhënë hakun/të drejtën e tij që e meriton.

Pritja e mysafirit dhe nderimi i tij, pas Ibrahimit (a.s.), është traditë e të Dërguarit të Allahut (a.s.). I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i jepte shumë rëndësi dhe shfaqte kujdes të veçantë ndaj pritjes dhe nderimit të mysafirit.

ZEKATI I SHTËPISË

Çdo gjë e ka zekatin nga lloji i saj. Edhe zekati i shtëpisë është nderimi i mysafirit. Në një transmetim që vjen nga Enes ibn Maliku (r.a.), thuhet: *“Zekati i shtëpisë është përgatitja e një dhome në shtëpi për nderimin e mysafirit.”*² Dihet se në Anadoll, veçanërisht ata që e kanë gjendjen ekonomike të mirë, ngjitur

1. Muslim, Sijam, 182.

2. Shik. El-Hindi, Kenzu'l-Ummal, XV, 390.

me shtëpitë e tyre kanë edhe dhoma të veçanta për pritjen dhe nderimin e mysafirëve. Me sa duket, kjo traditë buron nga transmetimi që vjen prej Enes ibn Malikut (r.a.), apo prej transmetimeve të tjera të ngjashme me të. Në muajin prill të vitit 2009 shkova në Maqedoni për të dhënë konferencë në Shkup, Gos-tivar dhe Ohër me rastin e javës së ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.). Miku ynë i vjetër, avokati Salih Murati, i cili akoma i vazhdon traditat osmane dhe i pëlqen shumë të presë e të nderojë mysafirë, na ftoi për një darkë në shtëpinë e re të tij që e kishte bërë në Vrapçishtë. Neve na priti në katin e sipërm të shtëpisë së tij. Kur na tha se këtë kat të shtëpisë e kishte bërë vetëm për të pritur dhe për të nderuar mysafirët, atij i thashë hadithin fisnik të mësipërm të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

MIRËSIA E ALLAHUT

Mysafiri është një mirësi dhe nderim i Allahut të Lartësuar për të zotin e shtëpisë. I zoti i shtëpisë duhet ta konsiderojë mysafirin si një mirësi të madhe dhe mëshirë për shtëpinë e tij, sepse, jo të gjithë mund ta kenë këtë mirësi dhe mëshirë. Allahu Teala ua dhuron këtë robërve të Tij që i do. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, një herë tha: *“Kur Allahu dëshiron mirësi për një popull, i jep atij një dhuratë.”* Kur sahabët e nderuar i thanë: “O i Dërguari i Allahut! Çfarë është ajo dhuratë?” – Hazreti Pejgamberi iu përgjigj: *“Është mysafiri, sepse mysafiri vjen me riskun e tij. Ndërsa kur shkon, Allahu Teala i fal pjesëtarët e familjes së shtëpisë.”*³ Edhe në një transmetim tjetër, i Dërguari i Allahut (a.s.), përsëri ka thënë: *“Kur mysafiri shkon te dikush, shkon me riskun e tij. Ndërsa kur largohet, largohet duke e lënë atë me mëkate të falura.”*⁴ Në hadithin fisnik ka dy pika që duhet t'i kemi parasysh:

Çështja e parë është që mysafiri të konsiderohet nga i zoti i shtëpisë si një dhuratë. Sipas traditës sonë fetare, mysafiri nuk është një barrë për të zotin e shtëpisë, por është një dhuratë dhe mirësi nga Allahu i Lartësuar.

Çështja e dytë është se mysafiri vjen me riskun e tij dhe shkon duke i lënë pjesëtarët e familjes së shtëpisë me mëkate të falura.

Poeti dhe mistiku i madh Feriduddin Attari, në librin e tij me titull “Xhevahirname” (fq. 19), i shtjellon këto çështje për të cilat bëhet fjalë në hadithin fisnik dhe thotë: “Vëlla, nderoje sa më mirë mysafirin! Mysafiri është një mirësi që e jep Allahu Tea-

la. Kur mysafiri vjen, sjell edhe riskun e tij. Ndërsa kur shkon, bëhet shkak që të falen mëkatet e zotit të shtëpisë. Bir! Nëse ke burrëri, mendje dhe aftësi perceptimi, dija vlerën mysafirrit! Ji bujar kundrejt mysafirrit. Edhe nëse është qafir/jobesimtar, menjëherë shko dhe hapja derën!”

Feriduddin Attari thotë kështu edhe në një vend tjetër të të njëjtit libër (fq. 45): “Vëlla! Nderoje mysafirin, në mënyrë që edhe ti të nderohesh te Allahu Teala. Besimtarëve që i presin mirë mysafirët Allahu i Lartësuar u hap dyert e mëshirës. Nga një njeri që nuk e ka në natyrën e tij pritjen e mysafirrit, zemërohet edhe Allahu, edhe i Dërguari i Allahut (a.s.). Atë rob që i shërben mysafirrit, Allahu i Madhëruar e lartëson në një gradë që e meriton. Ai që e pret mysafirin me fytyrë të qeshur, shpërblehet pa masë nga Allahu (xh.sh.). O i zoti i shtëpisë! Qëndro larg mërzisë, në mënyrë që mysafiri mos të të vijë si barrë.”

Në kulturën tonë, mysafiri konsiderohet si miku i Zotit. Prandaj thuhet: “Mysafiri vjen me riskun e tij.” “Mysafiri ka përparësi ndaj çdo gjëje.” “I zoti i shtëpisë është shërbëtori i mysafirrit.”

Në pamjen e jashtme mysafiri duket si barrë për të zotin e shtëpisë, por në të vërtetë aspak nuk është ashtu. Mysafiri është mëshirë dhe begati, sepse mysafiri shkon me riskun e tij për mysafir. Për këtë arsye, Allahu i jep begati riskut të të zotit të shtëpisë, e shton atë dhe ua fal mëkatet të gjithë pjesëtarëve të familjes.

Hazreti Shakik el-Belhi, i cili ishte prej mistikëve të parë, thoshte: “Për mua nuk ka gjë më të dashur se mysafiri, sepse riskun e tij e jep Allahu ndërsa shpërblimi më ngelet mua.”⁵ Përveç të tjerash, në kulturën tonë thuhet: “Lutja e mysafirrit është e pranueshme.” Kjo thënie është marrë nga ky hadith fisnik: I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“Ka tri lutje që patjetër pranohen. Ato janë lutja e babait, lutja e mysafirrit dhe lutja e të dhunuarit.”*⁶

NUK KA HAJËR

Sipas fesë sonë, nderimi, shërbimi dhe respekti ndaj mysafirrit konsiderohen si një mirësi. Për këtë arsye, ata që i nderojnë, shërbejnë dhe i respektojnë mysafirët janë njerëz të mirë. Ndërsa te ata që nuk i pranojnë mysafirët nuk ka hajër. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, thotë në një hadith fisnik: *“La hajre fimen la judifu / Nuk ka mirësi te ai që nuk e pret*

3. Axhhluni, Keshfu'l-Hafa, I, 80; Nebhani, el-Fet'hu'l-Kebir, I, 77.

4. Axhhluni, Keshfu'l-Hafa, I, 80; Nebhani, el-Fet'hu'l-Kebir, I, 106.

5. Sulemi, Tabakatu's-Sufijje, fq. 35.

6. Ebu Davud, Vitir, 29.

*mysafirin.*⁷ Nexhip Fazëll Kësakyreku shprehet me një poezi në lidhje me këtë:

“Mysafiri është tavan në çatinë e begatisë,
Ai që nuk do mysafir, është njeri larg mirësisë...”

NXITIMI PËR TË NDERUAR MYSAFIRIN

Në fenë tonë të nxituarit në çdo lloj çështjeje është i papëlqyeshëm. Për këtë arsye, në një fjalë të urtë thuhet: “Shejtani përzihet në punën që bëhet me nxitim.” Kur njeriut i kujtohet diçka që ia tërheq nefsi, shejtani i mallkuar i bën vesvese duke i thënë:

7. Ahmed, Musned, IV, 155.

“Mos e humb këtë shans! Bëje menjëherë!” Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “*et-Teenni minallah ve'l-axheletu mine'sh-shejtan / Të vepruarit me kujdes është nga Allahu, ndërsa të nxituarit është nga Shejtani.*”⁸

Megjithëse në përgjithësi kjo është dispozita në fenë tonë, në disa situata është sugjeruar të nxituarit. Njëra prej këtyre situatave është nderimi i mysafirit. Sapo të vijë mysafiri, këshillohet që të nderohet duke i dhënë për të ngrënë dhe për të pirë.

8. Tirmidhi, Birr, 66; Axhluni, Keshfu'l-Hafa, I, 295.

Mikpritja e gjyshërve tanë



Njëra prej cilësive të bukura të gjyshërve tanë, të cilët i kanë shërbyer Islamit dhe e kanë valëvitur flamurin e tij për shekuj me radhë, është mikpritja dhe shërbimi ndaj të gjithë mysafirëve pa dallim. Gjyshërit tanë i jepnin shumë rëndësi respektimit dhe nderimit të mysafirit. Atë kohë mundësitë ishin mjaft të kufizuara. Në shtëpi nuk kishte ujë që rridhte nga çezma. Nuk kishte energji elektrike. Nuk kishte gaz për të gatuar. Nuk kishte frigorifer. Nuk kishte lavatriçe. Nuk kishte sobë korrenti. Për këtë arsye, çdo gjë bëhej me mundin dhe përpjekjen e njeriut. Krahas të gjitha këtyre, ndjenin kënaqësi të madhe nga pritja dhe nderimi i mysafirit. Atë kohë udhëtimet bëheshin me kafshë si kuajt dhe gomarët, ngaqë nuk kishte apo ngaqë nuk ishin të përhapura mjetet motorike. Për këtë arsye, mysafiri kishte kalë ose gomar. Prandaj, edhe përkujdesja dhe të ushqyerit e

kafshëve ishte detyrë e të zotit të shtëpisë. Në qytetet e vogla nuk kishte as hotele apo gjëra të ngjashme me to për udhëtarët. Madje kjo pranohej si turp, sepse mysafiri pritej pothuajse me të katër sytë hapur dhe respektohej në mënyrën më mbresëlënëse.

Shembujt më të bukur të kësaj i shohim në “Sejehatname” të Ibn Batutës. Ibn Battuta, i cili ka jetuar ndërmjet viteve 1304-1369 dhe ka shëtitur në shumë vende. Ai e ka shëtitur edhe Anadollin pëllëmbë për pëllëmbë. Nisur nga kjo, ai nuk di t’u japë fund lavdërimeve për mikpritjen e myslimanëve. Në periudhën kur ai e ka shëtitur Anadollin, ishin vitet e fundit të sundimit të Selçukëve dhe vitet e lartësimit të Osmanëve. Ibn Batuta tregon me lavdërime se si

është pritur dhe nderuar për mysafir nga të gjithë myslimanët përgjatë udhëtimit të tij. Për shembull, pasi shprehet se kishte shkuar në një vend, vazhdon: “Mikpritësi na solli ushqime dhe fruta të ndryshme. Përveç disa njerëzve të këqij që rastiseshin rrallë, përsëri u gjendëm ballë për ballë me mikpritjen e myslimanëve. Allahu i Lartësuar gjithmonë i shpërbleftë me të mira këta njerëz që ishin shumë bujarë, që i mbronin udhëtarët, që shfaqnin butësi e mëshirë ndaj të huajve dhe dashuri kundrejt mysafirëve duke i trajtuar ata me mirësi. Të gjithë duhet ta dinë se kur një i huaj ta hedhë hapin në secilën nga zavijet, do ta ndjejë veten të lumtur, të qetë dhe të sigurt sikur të shkonte te një i afërm i tij.”

Po, të gjitha këto nuk janë legjenda, por të vërteta. Sa cilësi të bukura paskemi pasur ne si myslimanë!

Nëse do

Edison Çeraj

Nëse do të kuptosh kredinë/interesin (oh, këta emra të bukur), lexo *Tregtarin e Venedikut*. Nëse do të kuptosh revolucionin, lexo *Të mjerët ose Perënditë kanë etje*. Nëse je vënë në kërkim të rrënjëve të së keqes, lexo Dostojevskin. Nëse do të bindesh që njeriu është një mundim i kotë dhe një synim i pamundur brenda kohës dhe hapësirës (këtu dhe tani), atëherë lexo Beckett-in, pse jo edhe Camus. Nëse nuk ke kohë t'i lexosh parabolat, atëherë lexo komentarin e tyre: veprat e Kafka-s, të cilat janë parabola më vete, dhe ruajnë gjithë fuqinë figurative e semantike të parabolave të qëmotsme. Nëse do të kuptosh se pse të ardhurve u përket e ardhmja, se pse soji i tyre nuk ka asgjë për të humbur, atëherë zahmet e ke të lexosh Balzac-un. Nëse do të bindesh se të bësh plane nuk është njerëzore, apo se historia nuk varet nga njeriu, një mundësi është *Lufta dhe paqja*. Nëse do ta përjetosh sadopak misterin e dashurisë, zhytu hundë e buzë (aromë dhe prekje) në poezitë e Rumiut.¹ Nëse do që të dish përfundimin e përdorimit të dijes për pushtet, atëherë ndalo te *Fausti*. Nëse do të arratisesh nga realiteti për disa çaste, pra të nuhasësh aromën e pafundësisë, mjafton të dorëzohesh te *Njëmijë e një netët*. Nëse je dorëzuar duke e pyetur vdekjen se a fshihet gjë pas saj, provo t'i bashkëngjitesh Dantes dhe Virgjilit nëpërmjet poemës *Komedia hyjnore*. Nëse të intereson ana tjetër e një ishulli, lexo romanin *Vrasësja*. Nëse të shkrep ta djallosësh ca me kohën, atëherë lexo ndonjë *best seller*. *Parfumi* është një lexim i nevojshëm për të kuptuar se kiminë nga alkimia e ndan vetëm një qime floku.

Nëse do të dish për pasojat e disiplinës dhe shpërfytyrimin e religjiozes nga teologjia, atëherë një ndihmë të çmuar të jep edhe *Portreti i artistit në rini*, por edhe *At' Sergi*, natyrisht edhe *Katedralja e Parisit*. Për ushëtimin e mençurisë me pasionin lexo Wilde-in. Nëse të mungon fladi i bleshkëve, lexo poezitë e Camajt. Nektarin e shumë emrave të kulturës dhe kujtesës së botës do e gesh te esetë e Borges-it dhe Calvino-s. Për verbërinë si alegori, lexo romanin *Verbëri*.

Nëse rrethanat ku të ka rënë për hise të jetosh

1. "Detyra jote nuk është të kërkosh dashuri, por të gesh pengesat që ke ngritur brenda vetes kundër saj." (Rumi)

të duken sikur po konkurrojnë ferrin, atëherë mos ngurro të marrësh ca leksione nga *Shënime nga shtëpia e të vdekurve*. Te poezitë e Milosz-it dhe Montale-s do gesh shtigje për t'u arratisur nga vulgariteti prozaik i të përditshmes. Për një pamësi të pashoqe të botës së heronjve dhe të palaçove, ndërmer një lexim paralel mes rrëfimeve *Iliada* dhe *Shpirtra të vdekur*. Një tjetër lexim paralel që ia vlen është edhe ai mes Dostojevskit dhe Dickens-it. Sipas Dostojevskit, nuk janë rrethanat ato që e bëjnë njeriun, por bota e tij e brendshme. Ndërsa sipas Dickens-it janë pikërisht rrethanat ato që e bëjnë botën e brendshme të njeriut, dhe kështu edhe vetë njeriun. Nuk mund të themi se kjo është ndarë me thikë, por një ndarje e tillë pikaset lehtë te personazhet e secilit. Po ashtu, nuk mund të thuhet se Dickens-i e ka gabim. Ama Dostojevski është më pranë hirit njerëzor. E meqë ra fjala te thika, një personazh i Dostojevskit shkon drejt saj pas një analize të thellë që i bën vetes, kurse një nga të Dickens-it ndikohet nga thika për të bërë një analizë.

Për dashurinë dhe lumenj të tjerë, lexo *Stuhi në Gang*. Nëse je i dhënë pas leximeve melodi, lexo *Kënga e Hajavathës*, *Gitanjali* dhe diçka nga Andre Gide. Nëse je lodhur nga leximet, atëherë (ri)lexo *Don Kishoti*, dhe jo vetëm që do të të rikthehet kënaqësia e lëçitjes, por do i shlyesh të gjitha mëkatet që ke bërë nëpër leximet e mëparshme. Nëse do të kuptosh një vepër arti, mos lexo asgjë për të.

Nëse të ka marrë malli për Dashurinë, lexo brenda vetes. Mbi të gjitha, nëse do..., vazhdo të duash, se aty qëndron shpresa.



Përse fëmijët e parë JANË MË TË NDJESHËM?

M. Emin Karabaxhak



Nënat dhe baballarët në përgjithësi ankohen se fëmijët e tyre të parë janë më të mbyllur në vetvete në krahasim me fëmijët e tjerë dhe se ata nuk mund të shprehen aq shumë sa fëmijët pas tyre. Prindërit, të cilët nuk janë të kënaqur me gjendjen e fëmijëve të tyre, dëshirojnë të kenë një fëmijë që i kupton ata ende pa folur, një fëmijë që nuk është i mërzitshëm, që mund ta shpjegojë shqetësimin e tij dhe më kryesorja, një fëmijë që mund ta shprehë veten e tij. Fëmijët e parë janë më të ndjeshëm dhe më të turpshëm në krahasim me fëmijët e tjerë që mund të vijnë pas tyre. Edhe në lojë dhe karakter janë të ndryshëm nga vëllezërit dhe motrat e tyre. Fëmijët e tjerë në krahasim me fëmijët e parë janë më aktivë dhe përshtaten më shumë me mjedisin që i rrethon. Përveç të tjerash, më shumë se të ndjeshëm, ata janë më racionalistë, i besojnë vetes aq sa të përballen me rrezikun dhe përshtaten shpejt me mjedisin e shoqërisë.

Prindërit që shprehin shqetësimet në lidhje me fëmijët e parë i ftoj që të mendojnë rreth periudhave të shtatzënisë dhe metodës që i kanë rritur fëmijët. Sapo jeni martuar dhe akoma pa e kuptuar se çfarë është martesë vini re se njerëzit që ju rrethojnë presin një fëmijë prej jush. Pastaj filloni të shikoni se ata presin fëmijë prej jush në emër të lajmit të mirë dhe se kur vonohet ky lajm i mirë, bëhet shkak për komente të ndryshme. Këto shpresa apo pritje, dashje apo pa dashje ndikojnë negativisht te ju. Ju keni shkuar si nuse në një mjedis të ri. Ndërkohë që përpiqeni të përshtateni me njerëzit dhe mjedisin, papritur vini re se keni ngelur shtatzënë. Krahas përshtatjes me mjedisin social, për herë të parë po përjetoni edhe periudhën e shtatzënisë. Krahas vështirësisë së shtatzënisë, presioni psikologjik nën emrin e këshillës, sugjerimit, shqetësimit dhe ankesës që fillon me: “Kur ishim shtatzënë në kohën tonë...” – ndikon negativisht në gjendjen shpirtërore të kandidatës për nënë. Krahas këtyre, vetmia dhe ndjeshmëria psikologjike e kandidatës për nënë, pritjet në lidhje me gjininë e fëmijës, mendimet e tilla: “A do të bëhem dot një nënë e mirë për fëmijën tim dhe a do të përkujdesem dot mirë për të?” – e fusin atë në stres. Këto lloje shqetësimesh që janë rezultat i atyre që thamë më sipër, dashje apo pa dashje, ndikojnë te fëmija në bark aq sa ndikojnë edhe te nëna. Në lidhje me këtë, nënës i bëj veçanërisht

këtë pyetje: “A është e njëjtë periudha e shtatzënisë së fëmijës së parë me periudhat e shtatzënisë së fëmijëve të tjerë?” Përgjigja e nënës në përgjithësi është kjo: “Atë kohë kam qenë pa përvojë dhe nuk kam ditur shumë gjëra.”

Sidoqoftë vazhdojmë të mendojmë. Ndërkohë që fëmija lindi dhe ju përpiqeni për ta rritur atë, fillojnë ndërhyrjet edhe nga njerëzit rreth e rrotull. Krahas shqetësimeve dhe informacionit të paktë në çështjen e rritjes dhe edukimit të fëmijës që keni, vini re se nuk jeni vetëm në edukimin e fëmijës dhe se nuk mund ta rrisni atë sipas dëshirave tuaja pa ndërhyrë te fëmija edhe të mëdhenjtë e shtëpisë. Për shkak të këtyre, në emër të të qenit një nënë sa më e mirë, filloni të interesoheni më shumë seç duhet për fëmijën. Pra, ia jepni ushqimin para se ai të ketë uri, e vishni shumë trashë që të mos ftohet, nuk i jepni leje të vrapojë, duke u shqetësuar se mund të rrëzohet dhe e mbushni me lodra ngaqë nuk ka vëlla, motër apo shok për të luajtur. Shkurtimisht, gjërat që duhet t'i bëjë fëmija, fillon t'i bëjë nëna.

Prindërit i pyes: “A i keni rritur vallë edhe fëmijët e tjerë me këtë mjedis dhe psikologji?” Përgjigja që marr është kjo: “Jo, për fëmijët pasardhës nuk kanë ndërhyrë të tjerët. Mbi të gjitha, edhe unë kam pasur përvojë.”

Fëmijëve që rriten pa vëllezër, motra dhe shokë nuk u jepet mundësia ta përjetojnë sa më shumë fëmijërinë e tyre. Normalisht, ndërkohë që fëmijët mësojnë me anë të lojës, me anë të provës dhe të gabuarit dhe në një ambient me shokë e shoqe, shumica e prindërve i privojnë fëmijët e tyre të parë nga kjo mundësi.

Prindërit e këtyre fëmijëve, të cilët mësojnë me anë të lojës dhe duke u argëtuar bashkë me fëmijët e tjerë, nuk u japin leje fëmijëve që të bashkohen me grupin e fëmijëve të tjerë, ngaqë janë të dhënë më shumë se ç'duhet pas tyre. Po, edukimi i këtyre fëmijëve që nuk gjejnë dot moshatarë për të luajtur me ta, fiton një dimension shumë të ndryshëm kur në këtë punë ndërhyjnë edhe gjyshja me gjyshin. Për këtë arsye, këta fëmijë në shumicën e rasteve shfaqin sjellje kontradiktore.

Një fëmijë që nuk i jepet leje për të dalë jashtë dhe që nuk gjen ndonjë moshatar për të luajtur me të, më së shumti mbytet te lodrat që ia blen familja. Fëmijët që lozin vetëm me lodrat e tyre, në të ardhmen përjetojnë vështirësi në të shprehurit e vetes dhe në fitimin e besimit ndaj vetes së tyre. Këtyre fëmijëve, të cilët rriten pa iu dhënë leje për t'iu bashkangjitur shumë mjedisëve me fëmijë të tjerë dhe pa vëllezër e motra, u blihet çdo gjë që dëshirojnë, ngaqë janë fëmijët e parë dhe që të mos mërziten.

Në përpiqemi të jemi prindër të shkëlqyer, duke i bërë në emër të fëmijës aktivitetet që duhet t'i bëjë vetë fëmija, si të shprehurit e vetes, përdorimi i

aftësive dhe marrja e përgjegjësisë. Domethënë, e sjellim fëmijën në një gjendje saqë të gjitha punët e tij i bëjmë ne. Pastaj kur të rritet, themi: “Përse është bërë kështu ky fëmijë?” Në këtë situatë, prindërit nuk ia kanë idenë se po u bëjnë keq fëmijëve të tyre ndërkohë që mundohen t'u bëjnë mirë. Për këtë arsye, është e kotë që të presësh një sjellje si “të bëjnë detyrat apo të mësojnë mësimet” nga këta fëmijë që e presin çdo gjë nga prindërit e tyre. Ndërsa anët që duken pozitive te këta fëmijë janë këto: Ata janë më të pjekur, më seriozë dhe më të heshtur se moshatarët e tyre. Nëse kjo gjendje e fëmijës i kalon përgjegjësitë që ai duhet të marrë përsipër, është e dëmshme, sepse çdo fëmijë duhet të sillet dhe të veprojë në përputhshmëri me moshën dhe strukturën e personalitetit që ka.

ÇFARË DUHET TË BËHET PËR FËMIJËT E PARË?

1. Fëmijëve të parë duhet t'u krijohet mundësia për të luajtur me moshatarët e tyre dhe duhet të inkurajohen në këtë çështje.

2. Prindërit nuk duhet të presin prej fëmijëve gjëra që janë të pamundura për moshën dhe aftësitë e atyre. Përkundrazi, fëmijëve duhet t'u japin përgjegjësi në përputhje me moshën e tyre. Prandaj, prindërit nuk duhet të presin prej fëmijëve pjekuri më të madhe se moshja e tyre duke u thënë: “Ti je motra e madhe apo ti je vëllai i madh.”


3. Kur fëmijët të shfaqin sjellje pozitive në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre, duhet t'i ndihmojmë ata që t'i përforcojnë edhe më shumë ato sjellje.

4. Ne duhet t'ua mundësojmë që t'i mendojnë vetë punët dhe nuk duhet t'i bëjmë ato punë në emër të tyre.

5. Ne duhet t'ua mundësojmë fëmijëve që ta shprehin veten e tyre. Për këtë arsye, atyre nuk duhet t'u japim ndonjë gjë pa e kërkuar dhe duhet t'i presim derisa t'i plotësojnë fjalitë.

6. Gabimet e fëmijëve nuk duhet t'i ekzagjerojmë duke marrë parasysh se fëmijët mund të gabojnë.

Nisur nga këto që thamë më lart, fëmijëve duhet t'u jepen përgjegjësi, në mënyrë që ta zhvillojnë besimin ndaj vetes. Ndërsa për përgjegjësitë që i kryejnë me sukses, prindërit duhet të shfaqin reagime inkurajuese. Ata fëmijë, të cilëve u rrihet gati në çdo aspekt, do të përjetojnë probleme në çështjen e marrjes përsipër të përgjegjësive. Te fëmijët që lozin me prindërit apo me lodrat e tyre në shtëpi në vend të mjedisit me bashkëmoshatarët, do të ketë ndryshime nga aspekti i socializimit prej fëmijëve që lozin me bashkëmoshatarët. Fëmijët që i formojnë sjelljet e tyre në ambient normal jo me metodën e provës dhe gabimit, por me këshillat dhe sugjerimet e prindërve, do të mendojnë si fëmijët më të rritur në moshë, por kurrë nuk do të sillen si moshatarët e tyre.



M. Sami Ramazanollu



Rruga e Allahut ËSHTË SHUMË DELIKATE

Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: **“Vërtet shpresoni ju (besimtarë) se ata (hebrenjtë) do t’ju besonin juve, ndërkohë që disa prej tyre i dëgjonin fjalët e Allahut dhe, pasi i kuptonin, me vetëdije i shtrembëronin ato?! Kur takohen me besimtarët, ata thonë: “Ne besojmë”, e kur ngelin vetëm me njëri-tjetrin, ata thonë: “A u tregoni atyre, atë që ua ka shpallur Allahu (në Teurat), për ta përdorur si argument kundër jush te Zoti juaj? A nuk po mendoni?” A nuk e dinë ata se Allahu di çfarë fshehin dhe çfarë shpallin?! Disa prej atyre janë analfabetë, nuk e njohin Librin, përveç disa trillimeve dhe flasin vetëm me hamendje. Mjerë ata që me duart e tyre shkruajnë Librin, e pastaj thonë: “Kjo është prej Allahut” që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël (materiale). Mjerë ata për çfarë kanë shkruar me duart e tyre dhe mjerë ata për çfarë kanë fituar! Ata thonë: “Zjarri do të na prekë vetëm ca ditë të numëruara”. Thuaju (o Muhamed): “A keni marrë për këtë ndonjë zotim prej Allahut, kështu që Ai nuk do ta shkelë kurrë zotimin e vet (dhe do t’ju dënojë pak) apo po shpifni kundër Allahut gjëra që nuk i dini?” Nuk është kështu si thoni ju! Ata që bëjnë vepra të këqija dhe mbulojnë nga fajet e veta, do të jenë banorë të Zjarrit (të Xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Kurse ata që besojnë e bëjnë vepra të mira, do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.” (Bekare, 75-82)**

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e ka paralajmëruar fuqishëm umetin e tij: **“Ata që ishin para jush u ndanë në shtatëdhjetë e dy fraksione. Ndërsa ky umet do të ndahet në shtatëdhjetë e tre fraksione. Të gjitha do të jenë në zjarr, përveç**

njëres që do të shpëtojë.” Kur e pyetën se kush janë ata që do të shpëtojnë, i Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj: **“Ata që ndjekin rrugën time dhe të sahabëve të mi.”**

Ka shumë njerëz që konsiderohen prej evliave, prej të devotshmëve dhe prej mistikëve, por që asnjëherë nuk janë të sinqertë në drejtimin e tyre kundrejt Allahut Teala. Zemrat u anojnë nga njerëzit e shkujdesur dhe u parapëlqejnë veprat e shëmtuara të atyre. Kur u vjen ndonjë ftesë për t’i kënaqur dëshirat vetjake, shkojnë duke vrapsuar. Ndërsa ftesës së Allahut të Madhëruar i përgjigjen me shumë plogështi dhe që njerëzit e tjerë të mos i konsiderojnë si qafirë. Këta nuk janë të sinqertë dhe besnikë në rrugën e vërtetë. Ata shkruajnë pa reshtur duke mos e marrë parasysh injorancën e tyre dhe thonë se ato që kanë shkruar janë prej Zotit (xh.xh.). Ata janë shumë larg udhëzimit dhe kanë rënë në një humbje të madhe. Gjithashtu, i zvarrisin drejt humbjes edhe shumë njerëz të tjerë.

Udhëtari i rrugës së Allahut Teala duhet të kapet fort pas çdo gjëje që ka urdhëruar Zoti (xh.sh.), nuk duhet të mashtrohet nga pamja e jashtme e situatave, nuk duhet të gënjejë nga dredhitë e nefsit e nga fjalët e injorantëve dhe në çdo moment duhet të jetë i zgjuar e i kujdesshëm, në mënyrë që të arrijë te Allahu i Lartësuar. Rruga e Allahut Teala është mjaft delikate dhe me plot gjemba. Njeriu më injorant është ai që e çon kohën dëm dhe nuk përpiqet seriozisht për të arritur te Allahut i Madhëruar duke i rregulluar cilësitë e këqija të nefsit të tij edhe pse i di dhe i sheh qartazi ato.

PASURIA

që nuk mund të blihet me asgjë

Hatixhe Jegenler

Për njeriun ka shumë gjëra të çmueshme në jetën e kësaj bote. Pasuria, prona, fama, pozita, shëndeti, bukuria, dashuria, miqësia etj. etj. Të gjitha këto janë vetëm disa prej mirësive që na ka dhënë Allahu i Lartësuar. Ndërsa mirësia më e madhe dhe e cila është një thesar në vete është vetë jeta e njeriut. Ndërkohë që ditët dhe netët ndjekin njëra-tjetrën, pa e kuptuar aspak, vini re se flokët janë bërë komplet të bardhë. Nga trupi fillojnë të vijnë zëra thyerjesh e krisjesh. Tashmë gjunjët nuk e kanë më fuqinë e dikurshme dhe trupin ka filluar ta lërë takati.

Ja pra, koha është një pasuri që nuk e kuptojmë dot se si kalon dhe që nuk mund të blihet me asgjë. Koha është një kapital që nuk mund ta mbartim në ndonjë ditë tjetër, kështu që jemi të detyruar ta përdorim deri në fund. Ajo është një kapital aq i vlefshëm, sa që nuk mund të blihet me para, me florinj, me perla apo me gurë të çmuar. Këtë të vërtetë e dimë të gjithë. Përveç të tjerash, ne e dimë edhe faktin se jeta e kësaj bote është një pjesë kohe e kufizuar. Allahu i Madhëruar na e tërheq vëmendjen drejt

kohës duke u betuar për kohën në Kuranin Fisnik. Atëherë, si duhet ta vlerësojmë këtë kapital që nuk mund të matet me asgjë?

Vlerësimi apo harxhimi i çdo çasti që na bie ta jetojmë është në dorën tonë. Atë
k e m i

mundësi ta shndërrojmë në diçka të pavdekshme, t'i japim vlerë dhe ta stolisim. Ne duhet t'ua dimë vlerën sekondave dhe të qindtave që fluturojnë si zogjtë, që largohen nga ne si të ishin ujë që bëhen avull në diellin e nxehtë të verës dhe që është e pamundur të përjetohej përsëri. Ne nuk e kemi mundësinë që ta ndalojmë kohën, por e kemi në dorë që ta vlerësojmë atë dhe ta mbartim në të ardhmen.

Shumë njerëz e dinë historinë e kavanozit me gurët e çakllit, sepse është një histori e famshme:

Një burri i kishin dhënë në dorë disa gurë, pastaj disa copa çaklli, pastaj rënë dhe pastaj ujë. Më në fund i kishin dhënë edhe një kavanoz të madh. Atij i kishin thënë: "Në mundsh futi këto të gjitha në kavanoz!" Çfarë të bënte burri i shkretë në këtë situatë? Nëse do ta mbushte kavanozin me ujë, asgjë tjetër nuk mund të fuste brenda tij. Nëse do ta mbushte me rërë, nuk do të ngelte vend për copat e çakllit. Nëse së pari fuste copat e çakllit, atëherë nuk do të ngelte vend për gurët. Po si t'ia bënte? Sigurisht se ai duhet t'ia fillonte punës duke futur në kavanoz gurët. Për këtë arsye, së pari futi gurët në kavanoz. Në vendet që ngelën bosh, futi copat e çakllit. Ndërsa në vendet bosh që ngelën ndërmjet copave të çakllit, hodhi rërën. Pastaj, vendet bosh që ngelën ndërmjet kokrrizave të rërës i mbushi me ujë dhe e përfundoi këtë punë.

Edhe ne duhet ta shohim çdo ditë si një kavanoz të zbrazët që na jepet në dorë dhe që duhet ta mbushim sa më mirë. Ja pra, njeriu i mençur përpiqet ta përdorë kohën me vetëdije. Veprat e dobishme që janë bërë përgjatë gjithë historisë, gjithmonë janë bërë me këtë gjykim të shëndoshë. Njeriu i mençur nuk e humb

kohën duke u marrë me të kaluarën dhe nuk hyn në dallgën e të këqijave, por gjithmonë shikon me shpresë drejt të ardhmes. Qëllimi

i tij është që të lërë një emër të mirë nën këtë qiell. Ai gjithmonë është në garën për ta arritur prehjen dhe lumturinë si në jetën e kësaj bote ashtu edhe në jetën e botës tjetër.





Në gjirin e natyrës

— Nuredin Nazarko —

Vendi i përkohshëm për njeriun është ky që është, dhe nuk mund të jetë ndryshe, ashtu si nuk mund të jenë ndryshe shumë gjëra të tjera, edhe pse një pjesë ankohen vazhdimisht se pse bota është kështu e nuk është ashtu, sikur ligjet që drejtojnë gjithësinë të ishin të luhatshme sipas logjikës së kufizuar njerëzake. Pavarësisht se si e shohin botën dhe gjithë çfarë na rrethon, e dukshme apo e padukshme, e kapshme apo jo e kapshme nga shqisat, bota dhe më tej hapësira kozmike ku notojmë, mbeten këto që janë, të magjishme deri në pafundësi, sepse kështu siç është, pjesërisht e zbuluar e pjesërisht e fshehur, gjithmonë mban ndezur pishtarin e nxitjes drejt meditimit.

Zhvillimet bashkëkohore të orientuara drejt ekonomisë së konsumit dhe politikave të vazhdueshme për thithjen e masave drejt konsumit pa limit të mirave materiale, e kanë tërhequr në batak njeriun e sotëm, duke ia djegur tërësisht edhe atë pak dëshirë për meditim që mund të lindte nga kontakti me natyrën.

Predikimet e vazhdueshme se jeta e vërtetë bëhet në qendrat urbane, se aty jetohej më mirë, se jeta shijohet vetëm aty, i ka hutuar mjaft syresh, duke i shndërruar në krijesa që kthimin nga qielli e kanë gjënë më të vështirë të jetës së tyre. Kjo nuk do të thotë se ata që i kanë shpëtuar kësaj batice, kësaj katrahure dhe jetojnë ende në gjirin e natyrës, janë të imunizuar nga prekja e dëshira konsumeriste,

sepse ndërhyrja e teknologjisë edhe në skajet më të largëta ka bërë të vetën edhe në këtë sferë. Megjithatë aty mund të gjesh ende gjurmë më të shëndetshme për t'i vënë në lëvizje drejt meditimit mbi bukurinë që iu qëndron pranë gjithë kohës dhe ndërhyrja e predikimeve konsumeriste përmes teknologjisë ua ka zhvendosur vëmendjen ndaj kësaj bukurie që e shoqëron që nga hapja e syve herët në mëngjes e deri kur mbyll sytë për të bërë gjumin e natës.

Edhe në jetofshim në qendra urbane duhet rikthyer drejt natyrës, për ta prekur dhe për ta ndjerë bukurinë e asaj pjese që ende babëzia për fitim nuk e ka kthyer në një moçal prej të cilit duhet ikur.

Teksa hap sytë dhe ngrihesh për të nisur ditën e re, uji që do të të largojë gjumin e natës nga qepallat të kujton burimin lart në mal, prej nga vjen në duart e tua dhe tashmë mendja jote përmes imagjinatës i rikthehet përfytyrimit të burimit, sepse kthimi tek burimi përmes rrjedhës është gjithmonë i rëndësishëm.

Hap derën dhe del për një shëtitje në ajrin e freskët të mëngjesit, ajër me të cilin mushkëritë nuk kanë të ngopur dhe ku oksigjeni i freskët depërton lirshëm nën flegat e hundës. Teksa çapitesh ngadalë pikat e vesës bëhen shoqërueset e tua. Po ashtu në agimin e një dite të re të shoqërojnë si fillim kënga e gjelave, e më pas cicërimat e zogjve të ndryshëm që përzihen harmonishëm mes njëra - tjetrës. Tek - tuk mund të

dëgjohet edhe ndonjë lehje qeni. E ndërsa ecën, rrezet e para të diellit përshkojnë freskinë e mëngjesit, duke i dhënë çdo gjallesë energjinë e nevojshme për jetë. Ngrohtësia e rrezeve të diellit të kujton se pa ngrohtësi s'mund të ketë as jetë. Të gjitha gjallesat i gëzohen dritës së tij, e cila iu mundëson ecjen qartë në aktivitetin e tyre ditor.

Teksa ecën mes radhëve të barit të kositur nuk mund të mos ndalesh të thithësh oksigjenin e përzierë me aromën e barit në tharje e sipër. Këtu mund t'i bashkëngjitesh edhe ndonjë aromë tërëfilie, e cila nuk të lë mend për nga ëmbëlsia me të cilën përkëdhel hojet e mushkërive. Aty, mes këtyre aromave, nuk do të doje të largoheshe kurrsesi, por ashtu siç bari i vjetër përmes kositjes i lë vendin barit të ri, ashtu edhe breznitë duhet t'i lënë vendin njëra - tjetrës. E nën barin e kositur do të gjesh një botë insektesh aq të shumëllojshme saqë është vështirë t'i mbash mend imazhet e të gjithë anëtarëve të kësaj bote të gjallë, që jeton nën këmbët e tua dhe ti, fare i pavetëdijshëm për të.

Ndonjë ditë mund të ngjitesh në mal, të synosh arritjen në pikën më të lartë të tij, e prej aty të kundrosh e soditësh gjithë hapësirën që mund të rrokë shikimi yt i kufizuar. E ndërkohë që ti sodit panoramën që të ofron ngjitja drejt lartësive, fladi i erës së freskët të malit, do të jetë pëshpërma e soditjes tënde të heshtur. Prej aty do të soditësh qartësisht sesi dielli fillon e varet prej zenitit drejt perëndimit, duke na kujtuar se pas çdo zeniti ka një perëndim dhe pas çdo perëndimi ka sërish një lindje, për këdo që dritën e diellit kërkon. Rënia e diellit drejt perëndimit do të na çojë drejt muzgut të mbrëmjes, që mbushet me tringëllimën e zileve dhe kumbimin e këmborëve të bagëtive që ashtu sikur t'i ketë marrë njeri prej dore, drejtohen në rruginat që i çojnë drejt shtëpive të tyre, për t'i furnizuar njerëzit me qumështin dhe mishin e tyre.

Pa do të shohësh edhe ara të kultivuara e të stolisura nga dora e njeriut punëtor, ashtu siç do të shohësh edhe ara të lëna djerrë nga dora e njeriut dembel, ara të cilat me bimët që kanë mbirë aty sërish shërbejnë si kullotë për bletët punëtore. E si mund të të shpëtojnë nga vëmendja bletët punëtore, kur në çdo hap që hedh ato i gjen përpara teje, duke punuar pa përtim. Lule më lule, frut më frut, duke thithur nektarin na mësojnë se sikur të merrje nga nektari i diturisë së çdokujt dhe të ishte një përpunues

i mirë, do të sillje mjaltin, ilaç dhe shërim, ashtu si bletët sjellin mjaltin e tyre, të pastër e të pandotur me hilet njerëzore.

Mund të shkosh ndonjë ditë të shëtisësh nën hijen e pemëve të pyllit, ku bota e gjallë zhvillohet si në tokën e tij ashtu dhe në pemët e tij. E nëse do të ecje në thellësi të pyllit mund të të duket sikur je duke humbur, sikur je duke u izoluar nga bota që të rrethon. Por ja mes thellësisë së pyllit, hapet dhe shtrihet para teje një lirishtë, e cila të fton në pushim dhe qetësi. Kjo lirishtë të kujton kohën kur zemra jote ende ishte një pyll ku ti nuk gjeje qetësi, derisa u hap si një lirishtë dhe drita e diellit e shndërroi në një vend qetësie dhe prehje.

Edhe ditët me shi janë të këndshme, kur ti gjendesh nën pushtetin e ujit që vjen nga qielli, të atij që i jep jetë çdo gjëje në tokë, duke na kujtuar dhe njëherë se jeta vjen nga qielli e zbrit në tokë dhe në qiell kthehet sërish. E ndjen erën që paralajmëron ardhjen e shiut, e ndjejnë dhe gjallesat rreth teje. Pikat e para prekin tokën e zhuritur dhe më pas uji rrjedh rëke, duke i dhënë mushkërive mundësinë të thithin një nga aromat e këndshme që të ofron natyra. Të gjitha gjallesat të struktura pas çative të tyre, për të pritur çarjen e reve dhe rrezet e diellit që ti gëzohen sërish aktivitetit të jetës. E kur dalin rrezet e diellit, sheh që ajo që ishte e tharë dhe e zhuritur është ringjallur e ka fituar jetë të re.

E kur nata fillon e bie, pasi dielli ka hedhur hapin e fundit në horizont, me ëndje do të presësh të soditësh qiellin mbi krye, aty ku smogu njerëzor nuk mund të ndalë shikimin tënd drejt qiellit dhe yjeve të tij. Sa më shumë thellohet nata, aq më të shumtë dhe aq më të shndritshëm bëhen yjet në qiell. Tashmë kësaj bukurie i shtohet dhe qartësia e galaktikës, pjesë e së cilës jemi, si një lum yjor. Teksa sodit këtë bukuri mahnitëse që shpesh shoqërohet dhe me prezencën e hënës, soditja do të shoqërohet me këngën e cinxërave dhe bulkthëve, muzika e të cilëve rimon kaq bukur me qetësinë e natës dhe ndriçimin e yjeve.

Bukuritë e natyrës janë kaq të mrekullueshme, janë kaq mbresëlënëse saqë është fatkeqësi të gjendesh midis tyre dhe të mos meditosh aspak për mrekullinë e krijimit dhe funksionimit të tyre. Gjithmonë të jemi të kthyer kah natyra me soditje dhe meditim, sepse natyra dëshmon fuqinë e Krijuesit të saj çdo çast.

*Ngrohtësia
e rrezeve të diellit të
kujton se pa ngrohtësi
s'mund të ketë as jetë.
Të gjitha gjallesat i
gëzohen dritës së tij, e
cila iu mundëson ecjen
qartë në aktivitetin
e tyre ditor.*

MREKULLITË E Kuranit

ERËRAT FEKONDUESE

Në një ajet tjetër në Kuran, është përmendur karakteristika “fekonduese” e erës, si rezultat i së cilës formohet shiu. **“Ne i dërgojmë erërat “fekonduese”, pastaj lëshojmë shi nga qielli që t’ju japim për të pirë...”** (Hixhr, 22)

Në këtë ajet na bëhet e qartë se faza e parë e formimit të shiut është era. Deri në fillim të hekullit XX, e vetmja lidhje e njohur ndërmjet erës dhe shiut ishte se “era lëviz retë”. Por ishin kërkimet meteorologjike të kohës së sotme që zbuluan dhe vërtetuan rolin “fekondues” të erës në ormimin e shiut. Vetia fekonduese e erës funksionon në këtë mënyrë: Në sipërfaqen e oqeanëve dhe deteve formohen flluska ajri si pasojë e shkumëzimit të ujit. Në momentin që këto flluska pëlçasin, me mijëra grimca të vogla, me diametër një të qindtën e milimetrit, ngrihen lart në ajër. Këto grimca të njohura me emrin “aerosole”, përzihen me pluhurin e tokës të mbartur nga era dhe ngrihen në shtresat më të larta të atmosferës, ku bien në kontakt me avujt e ujit. Avujt e ujit kondensohen rreth këtyre grimcave, duke u kthyer në pika të vogla uji, të cilat bashkohen me njëra-tjetrën, duke formuar retë dhe pastaj bien në Tokë në formë shiu. Siç shihet, erërat “fekondojnë” avujt e ujit me grimcat që ato mbajnë nga deti dhe për rrjedhojë, formojnë retë e shiut. Nëse erërat nuk do ta kishin këtë veti, pikat e ujit në shtresat e larta të atmosferës nuk do të formoheshin kurrë dhe ne nuk do të kishim shi. Pra, roli vendimtar i erës në formimin e shiut është shpallur shekuj më parë në një ajet të Kuranit, në një kohë kur njerëzit dinin shumë pak rreth fenomeneve natyrore...

DETET NUK PËRZIHEN ME NJËRI-TJETRIN

Një nga veçoritë karakteristike të deteve është shpallur në një prej ajeteve të Kuranit, si më poshtë: **“Ai i bëri dy detet të bashkohen me njëri-tjetrin. Ndërmjet tyre ka një pengesë që nuk i lejon të përzihen.”** (Rahman, 19-20)

Kjo karakteristikë e deteve që rrinë ngjitur me njëri-tjetrin, pa u përzier mes tyre, është zbuluar jo shumë kohë më parë nga studiuesit e oqeanëve. Për shkak të forcës fizike të quajtur “tensioni sipërfaqësor”, ujërat e deteve fqinj nuk përzihen. I shkaktuar nga diferenca e dendësisë së ujërave, tensioni sipërfaqësor i ndalon detet të përzihen, sikur ndërmjet tyre të ekzistonte me të vërtetë një pengesë. Aspekti interesant i këtij fenomeni është se ai është shpallur në Kuran në kohën kur njerëzit nuk kishin njohuri mbi fizikën, tensionin sipërfaqësor, apo oqeanografinë.



Një Ajet

“O besimtarë! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.”

(Nisa, 136)

Në kohën e Pejgamberit (a.s.), jeta fetare u zhvillua si një lëvizje plot entuziazëm dhe dashuri. Përshpirtja hyjnore dhe begatia u derdhën mbi besimtarët si një shi i lehtë. Njerëzit u shndërruan në një shoqëri më-shire. Imani në zemra me kalimin e kohës u shndërrua në dituri, vepër, kulturë dhe qytetërim. Kjo gjendje vazhdoi për shekuj me radhë. Kjo lëvizje pati ndikim të madhe në gjithë historinë e njerëzimit. Por me kalimin e kohës ky entuziazëm filloi të zbehej.

Kurani u tërheq vëmendjen besimtarëve duke u përkujtuar gjendjen e popujve më të hershëm të cilët përjetuan gjendjen e ngurtësimit të zemrës. Kurani e tregon kështu devijimin e tyre nga rruga: **“Nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përlulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur.”** (Hadid,16)

Fatkeqësisht myslimanët në ditën tonë po përjetojnë një gjendje të ngjashme. Myslmanët kanë rënë në kurthin që patën ra ithtarët e librit. Ata e kanë humbur entuziazmin për të ecur në këtë rrugë. Jeta e myslimanëve është reduktuar thjesht në përmbushjen e nevojave dhe dëshirave tokësore. Përmbushja e nevojave tokësore konsiderohet si e mjaftueshme për jetën. Dashuria e zjarrtë për botën tjetër është zbehur. Një pjesë të mirë nuk i ka mbetur fuqi për të mbajtur amanetin hyjnor. Qëllimi i jetës është reduktuar vetëm në përmbushjen e synimeve të vogla.

Dukuria e rënies pas zhvillimit nuk është specifike vetëm në jetën fetare. Kjo

dukuri është e vërtetë në të gjitha fushat e jetës. Jeta në të gjitha aspektet e saj është dinamike.

Për të përjetuar ringjalljen e jetës fetare së pari duhet t'i vëmë vesh botës së brendshme. Duhet të dëgjojmë zemrën dhe shikojmë dritën e së vërtetës në shpirtin tonë. Kurani na fton të reflektojmë mbi krijimin tonë. **“Në veten tuaj ka argumente të shumtë. Akoma nuk mendoni?”** (Dhariat, 21) Ata që dëshirojnë të lartësohen duhet patjetër të thellohen në botën e brendshme, duhet të dëgjojnë zërin e zemrës, sepse burimi i dritës së vërtetë është pikërisht në zemër.

Një element i rëndësishëm në ringjalljen shpirtërore është përcaktimi saktë i prioriteteve. Përndryshe njeriu është i destinuar të bjerë në kurthin e pasurisë, pozitës, famës dhe mirësive materiale të kësaj bote. Lumturia përfundimtare është në botën tjetër. Kurani e thekson shpesh përkohshmërinë e kësaj botë dhe përjetësinë e botës tjetër.

Një tjetër kusht i ringjalljes shpirtërore është të dhënit kuptim jetës dhe ekzistencës. Në univers argumentet dhe simbolet të cilët shërbejnë për zgjimin e ndërgjegjes janë të pafund. Leximi dhe reflektimi mbi natyrën na bën të kuptojmë që çdo gjë është krijuar sipas një qëllimi të caktuar. Çdo gjë përreth na kujton Krijuesin. Është për t'u habitur se si i anashkalojnë njerëzit të gjitha këto argumente dhe shenja. Allahu këtyre u bën këtë pyetje: **“Me të vërtetë, Allahu është Ai që farën dhe bërthamën e bën të mugullojë. Ai e nxjerr të gjallën prej të vdekurës dhe të vdekurën prej të gjallës. Ky është Allahu. Atëherë, përse i largoheni Atij?”** (En'am)

“Besimtari përballë sprovave është si një bimë e njomë elastike e cila përballë erës lëkundet por nuk rrëzohet, sa pushon era ajo drejtohet përsëri. Kështu është edhe gjendja e besimtarit, ai lëkundet përballë fatkeqësive dhe sprovave, por kurrë nuk rrëzohet. Kurse jobesimtari është si druri i një selvie të thatë të cilën e Allahu e shkul dhe e rrëzon kur të dojë..”

(Buhari, Tevhid, 31)

Besimtari nuk përulet përballë erës dhe furtunave me të cilat përballlet në jetë. Ai gjatë gjithë jetës lufton kundër vështirësive dhe sprovave të ndryshme të jetës. Qëndrimi luftarak i tij përballë pengesave është tregues i dinjitetit dhe krenarisë së tij. Në fakt besimtari është ai njeri që me qëndrimin dinjitoz që mban i jep kuptim jetës. Besimtari është një njeri i tillë që sprovat dhe vështirësitë e ndryshme që i servir jeta, përmes fuqisë që merr përmes besimit, i përballon me durim, qetësi, pa u demoralizuar dhe revoltuar. Cilësia e besimit nuk është e fshehur vetëm në ditë të lumtura, por edhe në përkujtimin e Allahut në ditë të vështira dhe net të errëta. Mbështetja tek Allahu në raste vështirësie dhe qetësie është tregues i besimit të fortë. Përmes forcës që i jep imani besimtari i kapërcen me lehtësi vështirësitë. Njeriu gjatë jetës duhet të jetë në dy gjendje: ose në gjendje durimi përballë vështirësive ose në gjendje falënderimi ndaj mirësive. Si vështirësitë dhe mirësitë janë pjesë e sprovës së njeriut në këtë botë. Çështja nuk është të kënaqemi me mirësitë dhe të dorëzohemi përballë vështirësive, i gjithë sekreti është të durojmë përballë vështirësive dhe të falënderojmë Allahun për mirësitë.

Sprovat më të vështira në jetë i kanë kaluar pejgamberët. Ademi (a.s.), u sprovuar me ambicien për të fituar përjetësinë. Habili u sprovua me Kabilin, zilia ishte sprovë e Kabilit. Ibrahim i sprovua me Ismailin, dashuria prindërore ishte sprovë e Ibrahimit. Jakupi u sprovua me Jusufin, kurse

Jusufi u sprovua me Zylejhanë. Pejgabmeri (a.s.), krahas këshillave që u dha besimtarëve për të përballuar me sukses vështirësitë e jetës, njëkohësisht dha shembullin vetjak në përballimin e vështirësive nga më të vështirat me të cilat mund të përballlet njeriu gjatë jetës. Sprova e Tij ishte nga një jetim të merrte përsipër barrën e shpalljes hyjnore, sprova e Tij ishte të mos zbrapset prej qëllimit sikur t'i jepnin diellin në krahun e djathtë dhe hënën në krahun e majtë, sprova e Tij ishte populli i Taifit të cilët me gjithëse e gjuajtën me gurë ai u lut për mëshirë ndaj tyre. Pejgabmeri (a.s.), u përball me gjithfarë lloj vështirësie, por Ai ishte i vetëdijshëm se çdo mirësi është një sprovë dhe çdo sprovë është një mirësi dhe në këtë mënyrë qëndroi gjithmonë pranë Zotit.

Por çfarë raporti kemi ne me qëndrimin e mbajtur nga Profeti (a.s.), përballë vështirësive? Fatkeqësisht ne jemi shumë të dobët përballë vështirësive të jetës, e gjitha kjo dobësi vjen si pasojë e dhënies së tepruar pas kësaj botë. Sikur të mos harronin se në këtë botë jemi thjesht udhëtarë do të ishim të lumtur.

Sprovat tona janë namazet e pakryera, agjërimet e pambajtura, lëmoshat e padhëna, bamirësitë e porealizuara... sprovat tona janë egoizmi, ambicia e tepruar për pasuri, famë dhe pozitë. Rruga është e gjatë, udhëtimi i vështirë dhe qëndrimi ynë përballë erës është i papërcaktuar.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Besimtari nuk dorëzohet përballë sprovave dhe vështirësive.
2. Besimtari sprovat dhe vështirësitë i përballon me qetësi dhe durim.
3. Besimtari mund të përjetojë lëkundje gjatë sprovave, por ai kurrë nuk thyhet.
4. Jobesimtari është i dobët dhe i pafuqishëm përballë vështirësive.

Mje Hadith



TRASHËGIMTARËT E AMANETIT TË SHENJTË

EDUKIM DHE ARSIM HYJNOR

Allahu kërkon prej njeriut të kalojë përmes një procesi edukimi dhe arsimit në mënyrë që të meritojë Xhenetin. Pikërisht ky është qëllimi i dërgimit të peygamberëve dhe librave hyjnorë.

Veçanërisht Muhamedi (a.s.), i cili nuk është dërguar udhëzues vetëm për popullin e tij, por për gjithë njerëzimin deri në Ditën e Kiametit.

Ekukimin e Pejgamberit (a.s.), e ka kryer vetë Krijuesi i gjithësisë. Pastaj edukimin e gjithë njerëzimit ia besoi Pejgamberit (a.s.).

Ai, gjatë 23 vjetëve të jetës profetike përmes edukimit shembullor, ndërtoi një individ dhe shoqëri të re. Nxori sahabët nga injoranca dhe fanatizmi arab, duke i kthyer si yje në qiell për të orientuar njerëzit drejt destinacionit të duhur. Ai ndërtoi qytetërimin e virtyteve, dashurisë dhe sakrificës, duke lënë pas një shoqëri e cila mburrej me krimet që kryente.

Ai kur u largua nga kjo botë la pas personalitete të jashtëzakonshme, të cilët mbartën me përgjegjësi të plotë amanetin e shenjtë dhe flamurin e Tevhidit. Katër kalifët e drejtë, dhjetë të përgëzuarit me Xhenet dhe të gjithë sahabët e tjerë si pasqyra reflektuan tek brezat pasardhës amanetin e shpalljes në katër anët e botës. Përmes tyre gjithë bota u njoh me dritën islame.

Kjo detyrë sublime do të transmetohet deri në Ditën e Kiametit nga dijetarët dhe njerëzit e zemrës. Trashëgimitë e vetme që na lanë peygamberët janë dituria dhe urtësia.

TRASHËGIMTARËT E AMANETIT TË SHENJTË

Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve. (Ebu Davud, Ilim, 1)

Trashëgimtarët e Pejgamberit (a.s.), janë njerëzit e zemrës, të sinqertët, të diturit dhe të urtit. Ata janë trashëgimtarët e profetëve të shpërndarë në kohë.

Katër imamët e shkollave juridike, koleksionistët e traditës profetike, komentuesit e Kuranit dhe të gjithë dijetarët e sinqertë dhe të devotshëm të botës islame janë vazhduesit e edukimit dhe arsimit të Profetit (a.s.).

Prijësit dhe juristët e drejtë transmetuan brez pas brezi amanetin e drejtësisë së Profetit (a.s.).

Edukimin shpirtëror e përmbushën në mënyrë të përsosur dijetarët e zemrave.

Të gjithë janë pishtarë udhëzimi. Ata që të gjithë ruajtën vijimësinë e qytetërimit islam. Ata ishin pa-sojë e lutjes:

وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

“Na bëj shembull për të devotshmit.” (Furkan, 74)

Allahu në fillim të çdo shekulli dërgon një person për të ripërtërirë fenë. (Ebu Davut, Melahim, 1)

Sot shoqëria jonë ka nevojë për njerëzit e dashur të Allahut. Ka nevojë për udhëzimin e trashëgimtarëve të Profetit (a.s.), dijetarëve dhe të urtëve. Besimi i devijuar për shkak të paditurisë, ka nevojë për argumente.



Dijetarët e umetit tim janë si pejgamberët e Beni Israilëve. (Axhluni, II, 64/1744)

Siç shkruhet edhe në hadithet e lartpërmendura, ruajtja me kujdes dhe transmetimi brez pas brezi i amanetit është bërë e mundur përmes këtyre njerëzve.

Historia është dëshmitare e kësaj të vërtete.

SHEMBUJ NGA HISTORIA

Pas periudhës së katër kalifëve të drejtë dhe fillimit të trazirave, kalifati ra në duar të njerëzve të dhënë pas kënaqësive të kësaj bote.

Siç thuhet edhe në fjalën e urtë: “Njerëzit janë në fenë e udhëheqësve”. Ata në stilin e tyre të jetesës filluan të ndjekin politikën shtetërore.

Kalifi Umejad Velid ibn Abdulmelik ishte i dhënë pas ndërtimeve të mëdha. Populli në periudhën e tij u orientua drejt ndërtimeve madhështore. Tema kryesore e bisedave dhe diskutimeve ishte ndërtimi.

Ashtu si të uriturit kanë nevojë për ushqim edhe shpirti ka nevojë për mjedis ku gatuhet ushqimi shpirtëror.

Sulejman ibn Maliku ishte një prijës i dhënë pas kulinarisë, për pasojë i gjithë populli në kohën e tij ishte i dhënë pas artit të gatimit.

Pastaj erdhi një prijës i devotshëm dhe i drejtë si Omer ibn Abdulaziz. Në periudhën e tij njerëzit filluan të garojnë me njëri-tjetrin në mirësi, në adhurim dhe bamirësi.

Kurse tema e diskutimeve ishte: “Sa ajete ke mësuar përmendsh sot? Sa ditë agjëron në javë? Sa bamirësi ke bërë sot?”

Në këtë mënyrë zemrat inkurajonin njëra-tjetrën në punë të mira.

Periudha e Omer ibn Abdulazizit zgjati vetëm dy vjet e gjysmë, por gjatë kësaj periudhe të shkurtër bota islame arriti një mirëqenie dhe qetësi të jashtëzakonshme. Guvernatorët nuk gjenin dot njerëz të varfër për t’u dhënë zekatin. Ngaqë të gjithë jepnin zekatin nuk kishte mbetur asnjë i varfër.

Në periudhën e këtij prijësi të drejtë dhe të devotshëm ishte krijuar një atmosferë e tillë shpirtërore të cilën Muhamed Ibn Ujejne e përshkruan kështu:

“Në kohën e Omer ibn Abdulazizit dërgova bagëtitë në Kirman. Për shkak të drejtësisë së zbatuar prej tij, ishte krijuar një atmosferë e tillë, saqë delet dhe ujqërit jetonin në paqe me njëri-tjetrin. Një natë ujqërit sulmuan kopenë e deleve. U habita dhe më ngjau sikur e gjithë bota kishte humbur qetësinë dhe sigurinë e deriatëhershme.

Ashtu si i sëmuri ka nevojë për doktorin, edhe i sëmuri shpirtëror ka nevojë për doktorin e zemrës.

Thashë me vete se duhet të ketë vdekur kalifi i drejtë. Kur u interesova, mësova që kishte vdekur ata natë.”

Në kohën e Omer ibn Abdulazizit kufijtë e botës islame arritën deri në malet Pirene.

Por qëllimi kryesor i Islamit nuk është zaptimi i hapësirave dhe kalave, por çlirimi i zemrave. Këtë detyrë e kryenin dijetarët dhe njerëzit e zemrave.

Asketi i famshëm Bejazit Bistami, i cili ka jetuar në shekullin e katërt hixhri, një ditë kur po shkonte në xhami, i rrëshqiti këmba në rrugën me baltë dhe për të mos u rrëzuar u mbajt tek një mur. Muri u bë pis me baltë.

Me vete mendo: “Akoma ka kohë deri sa të thirret ezani, po shkoj tek i zoti i murit dhe t’i kërkoj ndjesë.” I zoti i murit ishte ndjekës i Zarathustrës. Bejazit Bistami, pasi i tregoi për ndodhinë, i kërkoi ndjesë.

Ndjekësi i Zarathustrës gjithë habi pyeti:



Me të vërtetë feja ju mëson të jeni kaq të kujdeshëm dhe të sjellshëm? – Po- iu përgjigj Bistami.

Atëherë ndjekësi i Zarathustrës tha:

“Edhe unë besoj në Zotin dhe Profetin tuaj.”

Kjo sjellje e mirë e Bistamit u bë shkak që të bëhej mysliman i gjithë fisi.

Ndërsa Islami përqafohej nga masa të madha njerëzish, në shekullin V Hixhri, pikërisht në periudhën që jetoi dijetari i madh Imam Gazaliu. Islami u përball me dy rreziqe të mëdha.

Nga njëra anë propaganda e sekteve të devijuara të cilat synonin shkatërrimin e Islamit, nga ana tjetër rryma të ndryshme filozofike rrezikonin besimin e pastër islam.

ARGUMENTI ISLAM

Imam Gazaliu, i cili ishte erudit në të gjitha shkenecat e kohës, me ndihmën e Allahut arriti një gradë të lartë shpirtërore. Kjo bëri që ai të njihej në botën islame si Argumenti Islam. Ai luftoi ashpër kundër filozofisë dhe sekteve të devijuara. Në këtë mënyrë i bëri një shërbim të madh fesë islame, duke e ruajtur nga ndikimet negative.

Mësuesi dhe udhëzuesi i Imam Gazaliut ishte Pejgamberi (a.s.). Imam Gazaliu në lidhje me këtë thotë:

“Pashë që përveç strehimit tek bota shpirtërore e Pejgamberit, çdo gjë tjetër ishte bosh dhe iluzion. Arsyeja nuk është gjë tjetër veç se kufi”

Në shekullin VIII hixhri, kur bota islame vuante dhe vajtonte nga pushtimet mongole dhe shteti i selxhukëve gjendej në vështirësi të madhe, Mevlana u bë burim ngushëllimi dhe frymëzimi për gjithë botën islame. Veprat e Mevlanës u bënë ngushëllim për zemrat e njerëzve, madje edhe sot e kësaj ditë vazhdojnë të tërheqin vëmendjen e shumë njerëzve.

Veprat e tij plot urtësi, të mbrujtura më dashurinë hyjnore ndihmuan në kapërcimin e krizës që kishte kapluar botën islame dhe u bënë frymëzim për krijimin e shtetit të fuqishëm Osman.

Në librin e Historisë Osmane, rrëfëhet një tregim interesant në lidhje me themelimin e shtetit Osman.

QOFTË I BEKUAR!

Sulltani i fundit i selxhukëve, Alaedini II kishte

emëruar në një post të rëndësishëm një njeri të paaftë. Në ceremoninë që organizoi për emërimin e tij, ishte i ftuar edhe Mevlana Xhelaledin Rumi. Rumi u mërzhitur nga ky emërim, në shenjë mosmiratimi u largua nga saraji mbretëror. Ndërsa po zbriste shkallët, u takua me Osman Gazin, i cili më vonë do të bëhej themeluesi i perandorisë Osmane. Rumi e ftoi për vizitë dhe e urdhëroi të lexonte Fatihanë, kurse vetë u zhyt në meditim.

Në mënyrë të papritur e pyeti Osman Gazin se sa herë e lexoi Fatihanë.

18 herë u përgjigj Osman Gazi

“Kaq nuk mjafton”, - ia ktheu Mevlana.

Pasi e lexoi edhe vetë Fatihanë 18 herë i dha këtë sihariq:

“Qoftë i bekuar sundimi yt dhe i pasardhësve të tu. Prej pasardhësve të tu do të rrjedhin plot 36 prijës.

Perandoria Osmane u themelua nga 400 kalorës. Nga një principatë e vogël dhe periferike arriti të sundonte një sipërfaqe prej 24 milion km². Arsyeja kryesore e këtij suksesi dhe e kësaj begatie ishte pikërisht bota shpirtërore e njerëzve të urtë.

Gejikliu, Emir Sultan, Akshemseddin, Jahja, Symbil Efendi, Merkez Efendi, Yftade, Aziz Mahmud Hydai, Shemseddin Sivasi, Halid Bagdadi e shumë e shumë të tjerë përmes mësimave dhe këshillave të urta, bënë të mundur rilindjen e qytetërimi islam përmes Dinastisë Osmane.

Ne sot e kësaj ditë përfitojmë nga ky qytetërim që krijuan ata mbi baza shpirtërore.

QYTETËRIMI MADHËSHTOR I INSTITUCIONEVE TË BAMIRËSISË

Institucionet e bamirësisë të ndërtuara mbi bazën e mëshirës dhe sinqeritetit si: xhami, spitale, shkolla, çezme, kuzhina dhe shumë institucione të tjera vazhdojnë shërbimin e tyre sot e kësaj dite.

Mirësitë e shpërndara nga Stambolli në 3 kontinente. Në secilën çezmë që ekziston dhe që pimë ujë patjetër që është ose dora e një sulltani ose e bashkëshortes së tij. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për xhamitë, spitalet dhe shumë institucione të tjera në shërbim të publikut.

Madje edhe silueta që kanë lënë në horizont shër-

*Trashëgimtarët
e Pejgamberit (a.s.),
janë njerëzit e zemrës,
të sinqertët, të diturit
dhe të urtit. Ata janë
trashëgimtarët e
profetëve të shpërndarë
në kohë.*

bimet e të parëve tanë, pasqyron mirësi në zemrat tona dhe na ngjall ndjenja të bukura.

Në periudhën osmane ka pasur më shumë se 26 mijë vakëfe të themeluara e të regjistruara. Në sajë të këtyre vakëfeve arrinin në duart e të varfërve me dhjetëra shërbime, të cilat sot jepen vetëm kundrejt një pagese. Në atë periudhë, shoqëria ishte thurur si një rretë mëshire dhe dhembshurie. Njerëzit jetonin të qetë në ndërgjegjet e tyre. Midis të pasurit dhe të varfrit, të sëmurit dhe të shëndetshmit ishte krijuar një lidhje përgjegjësie e veçantë. Në pragjet e shtëpive ku gjendej një i sëmurë, vendosej një lule e kuqe, me qëllim që shitësit ambulantë ta shihnin dhe të mos thërrisnin me zë të lartë, ndërsa fëmijët të luanin në ndonjë lagje tjetër. Këto janë shembuj mëshire dhe karakteri, të cilat ndriçojnë edhe sot e kësaj dite.

Në vakëfet ku shfaqeshin këta shembuj, nuk u shërbehej vetëm myslimanëve, por edhe jomyslimanëve. Edhe atyre u tregohej butësia e Islamit. Për rrjedhojë, shumë prej tyre përqafuan Islamin.

Zemrat e besimtarëve të devotshëm të cilët thellohen në vuajtjet e nevojtarëve dhe të dobëtëve, ziejnë si sheshi i mahsherit. Kjo djegie zemre, është e mbushur me dashurinë e shërbimit ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Zemrat e tyre bëhen fole mëshire.

Krahët e mëshirës nuk iu hapën vetëm njerëzve, por edhe të gjitha krijesave që ishin nevojtare.

Në atë periudhë madhështore, sulltaneshat nuk ranë pre e qejfeve dhe e tundimeve të kësaj bote, si mbretëreshat dhe princeshat e zhytura në luks dhe shpërdorime.

Bashkëshortja e Harun Rashidit, zonja Zubejde dhe bashkëshortja bamirëse e Sulltan Sulejman Kanunit, sulltanësja Mihrimah, me pasurinë e tyre, ndanë dëshirën për ta çuar ujin e pijshëm të Damaskut në Arafat, në ato kushte të vështira të kohës. Ato treguan dashurinë e tyre për Haramejnin dhe mëshirën për myslimanët.

Ndërsa sulltanësja Hatixhe Turhan, ka lënë si vakëf, shërbimin me sherbetin e mjaltit më të mirë të kohës për ditët e mira, që rridhte nga çezmat e Xhamisë së Re dhe i cili u shërbehej myslimanëve i përgatitur me dëborë të sjellë prej malit Uludag.

Madje, edhe sulltanësja Kosem, e cila në dukje ishte e ashpër, ka themeluar një vakëf që merrej me përgatitjen e pajës së shërbyeseve. Vetëm vakëfet e themeluar prej grave, ishin me mijëra.

TË MOS CENOHEN ZEMRAT!

Sulltanësja Bezmi Alem, e cila ka lënë vakëfe të mëdha si: Spitali i Guraba-i Muslim, Valide Xhami pranë Sarajit Dollmabahçe dhe ura e famshme e

Gallatës, ka themeluar një vakëf edhe në Damask. Kushtet e këtij vakëfi, janë shumë të mahnitshme. Një prej tyre është edhe ky:

“Të dëmshpërblehen gotat që thyhen apo sendet që dëmtohen (pa dashje) nga shërbyesit që punonin pranë pronarëve të ashpër e të paedukatë, me qëllim që pronarët të mos i qortonin duke ua thyer zemrat.”

Karafi, një nga personalitetet e njohur të metodologjisë së jurisprudencës islame, ka thënë: “Edhe sikur Profeti i Allahut (a.s.), të mos kishte asnjë mrekulli, sahabët që edukoi (me të cilët themeloi qytetërimin e virtyteve), do t'i mjaftonin si dëshmi se është një Profet i madh”.

Ndërsa në vakëfin e Sulltan Mehmet Fatihut, ishte menduar një shërbim për myslimanët, me qëllim që të ruheshin nga pamjet e këqija e të shëmtuara në rrugë:

“Me të ardhurat e fituara prej pronave të mia të patundshme, të vendosen nga dy persona në çdo rrugicë të Stambollit. Këta do të lëvizin nëpër rrugica në orë të caktuara të ditës me një enë të mbushur me pluhur gëlqereje dhe hi qymyri, me qëllim që të mbulojnë pështymat nëpër rrugica. Pagesa ditore e tyre, të jetë nga 20 akçe.”

Gjithashtu, Sulltani Mehmet Fatih, ka vendosur edhe një shërbim, ku synohej të ruheshin dinjiteti dhe ndjenjat e të varfërve dhe t'u shërbehej atyre me ëmbëlsi:

“Familjeve të dëshmorëve të çlirimit të Stambollit dhe jetimëve, t'u shërbehet me enë të mbyllura, pasi të bjerë muzgu, për të mos tërhequr vëmendjen e fqinjëve, me qëllim që të ruhet dinjiteti dhe respekti ndaj tyre!..”

Sa qytetërim njerëzor i madhërisëm është Islami, i cili i edukoi edhe shpirtrat më të pagdhendur, duke i kthyer ata në zemra dhe shpirtra të butë, që shohin, dëgjojnë dhe ndjejnë.

Në qytetërimin tonë, ai që jepte, ia dinte për nder atij që merrte. Në sajë të “gurëve të sadakasë” nëpër xhamia, ai që merrte nuk e njihje atë që jepte. Në këtë mënyrë, edhe ai që jepte ruhej nga ndjenja e hipokrizisë. Gjatë muajit të Ramazanit, bamirësit shkonin nëpër dyqane dhe kërkonin defterët e borxheve, me qëllim që të lanin borxhet e të varfërve, pa e bërë të ditur se kush janë.

Me vetëdijen se: “Lëmoshat i merr Allahu!” (Teube, 104) dhënësi tregohej i edukuar dhe i thjeshtë, sikur po ia jepte Allahut. Sa bukur e shpreh ky shembull ëmbëlsinë e dhurimit:

Sulltani Mustafai III, në muajin e Ramazanit shkoi një natë për iftar në konakun e Shejhu'l Islamit, Mehmet Emin Efendisë. Gjatë bisedës tha:

“Mehmed Emin Efendi, kisha dëshirë të vija herë

pas here tek ju, por konaku juaj është goxha larg!”

Ndërsa Mehmed Emin Efendiu, me mirësjellje dhe modesti, bëri një shpjegim tërthorazi:

“Sulltan im! Në sajën tënd, është e mundur të siguroj një shtëpi më afër, mirëpo, siç e shihni, në asnjërin prej shtëpive përfaqë nuk ka vend gatimi.”

Për shkak të këtij shpjegimi të tërthortë, sulltani u habit dhe pyeti:

“E çuditshme! A nuk gatujmë gjellë në këto shtëpi?”

Pas kësaj Mehmed Emin Efendiu i jep një përgjigje që pasqyron botën e tij të brendshme:

“Ushqimi i mëngjesit dhe i darkës shpërndahet nga kjo kuzhinë e thjeshtë, prandaj nuk dëshiroj të largohem prej këtu.”

Sa qytetërimi i madhërishtë dhe i kulturuar është Islami, i cili edukoi personalitete të përsosura që e shfaqën shpirtin e tyre njerëzor me mëshirë dhe thjeshtësi të jashtëzakonshme!

MËSHIRË GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ KRIJESAVE

Afërsisht një shekull pas Mevlanës, Shah Nakshibendi, mësuesi i madh i rrugës Haxhegan, filloi në Horasan çlirim të zemrave me metodën e edukimit shpirtëror me bazë bisedën dhe shërbimin. Me mëshirën e tij gjithëpërfshirëse ndaj të gjitha krijesave në vijën e devotshmërisë dhe rrugës së drejtë, ai është bërë shembulli praktik i ndjekësve të tij prej shumë shekujsh. Kjo rrugë e bekuar, është bërë shkak që e gjithë bota prej Maveraunnehirit e deri në Indi, në Irak, në Anadoll dhe në Ballkan, të shohin bukuritë e fshehta dhe të dukshme të Islamit.

I nderuari Ubejdullah Ahrari, një prej të dashurve të Allahut, i cili vjen prej zinxhirit të tij të ndritshëm, ka marrë pjesë edhe në çlirim të Stambollit. Ai kishte vakëfe, medrese, mensa ushqimi dhe spitale që u kanë shërbyer mijëra njerëzve përreth zonës së Semerkandit. Shumë vende pranuan Islamit në sajë të këtyre përpjekjeve fizike dhe kësaj ndihme shpirtërore.

Ndërkohë që po përfundonte mijëvjeçari i parë i hixhrit, në zonën e Indisë filluan ngatërresat. Një sundues me emrin Ekber Shah, bashkoi Islamit me Hinduizmin dhe u përpoq të nxirrte një fe të rreme,

të cilën e konsideronte si fe hyjnore, duke nxjerrë edhe ligje në kundërshtim me parimet islame.

EDUKIMI SHPIRTËROR

Imam Rabbani, në sajë të përpjekjeve të tij këmbëngulëse, duke pastruar zemrat arriti ta eliminonte këtë problem nga zonat e Indisë. Për këtë arsye, edhe Alemgiri, nipi i Ekber Shahut, u bë ndjekësi i rrugës së Imam Rabbanit.

Ndikimi i Imam Rabbanit, nuk mbeti vetëm në Indi. Ky mik i Allahut, i cili u bë edhe ripërtëritësi i mijëvjeçarit të dytë, e ngriti mistikën mbi themelet e Kuranit dhe Sunetit, duke u lënë ndjekësve të ardhshëm të kësaj rruge shpirtërore, një rrugë të drejtë.

Gjithashtu, edhe në qendra të tjera Islame, ku është punuar shumë për të shuar dritën e Islamit, kanë vepruar shumë të dashur të Allahut, të cilët i kanë eliminuar problemet duke e edukuar popullin me pastrimin shpirtëror.

Shoqëritë gjithmonë kanë gjetur paqe në sajë të miqve të Allahut. Shtëpitë e tyre kanë qenë gjithmonë qendra rehabilitimi për shpirtrat e lodhur, të hidhëruar, të vetmuar dhe të plagosur. Po ashtu, edhe çerdhet familjare që përjetonin probleme, kanë mundur të qëndrojnë në këmbë, në sajë të këshillave të tyre për durim dhe mëshirë. Kjo, sepse ata ishin vazhdimi i Daru'l-Erkamit dhe i As'hab-i Suffas. Ata ishin përpjekja për vazhdimin deri në

Kiamet të pastrimit shpirtëror të Rasulallahut (a.s.). Dhe energjia e këtyre përpjekjeve, ishte dashuria për Allahun.

DASHURIA HYJNORE

Çfarë është ajo që i bën kaq shumë njerëz, që prej sulltanëve e deri tek populli i thjeshtë, të vijnë rrotull këtyre miqve të Allahut si flutura?

Interesi, posti apo autoriteti?!

Absolutisht jo!

Përkundrazi, ata që vraponin drejt tyre, kishin dhuruar gjithçka që kishin. Nëse u është dashur, e kanë braktisur edhe postin dhe e kishin vënë nën këmbë autoritetin e përkohshëm që kishin. Për shembull, Aziz Muhamud Hudaji, i cili ishte gjykatës i Bursës, e kishte braktisur vendin që kishte në administratën shtetërore. Me përvujtni ai filloi të shiste mëlçi në



rrugicat e Bursës. Ai ka qëndruar me muaj të tërë nën edukimin e dijetarit dhe mësuesit të famshëm Halid-i Bagdadit dhe Abdullah Dehleviut, duke përgatitur ujin e abdestit dhe duke pastruar tualetet.

Pra, ajo që i tërhiqte ata drejt miqve të Allahut, ishte një dashuri e falur prej Allahut të Madhëruar. Në ajetin 96 të sures Merjem, urdhërohet:

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.” (Merjem, 96)

Nëse Allahu e do një rob të Tij, e bën atë të dashur edhe për banorët e tokës dhe të qiellit. Dhe ata njerëz të mirë, bëhen udhërrëfyes të besimtarëve që i ndjekin. Kjo dashuri që Zoti ka bërë të mundur, është aq ndikuese, saqë shërbimet e atyre njerëzve të lartë, vazhdojnë edhe pas jetës së tyre të përkohshme.

I nderuari Mevlana ka thënë:

“Pas vdekjes sonë, mos e kërkoni varrin tonë në tokë. Varri ynë është në zemrën e të diturve.”

Jetët e miqve të Allahut, vazhdojnë t’u shërbejnë zemrave besimtare që presin udhëzim edhe pas jetës së tyre të përkohshme. Kjo, arrihet në sajë të nxënësve që kanë edukuar dhe veprave që kanë lënë pas.

Gjatë jetës së tyre ata kanë formuar një umet me njerëzit që kanë takuar, ndërsa pas vdekjes, e kanë vazhduar udhëzimin e tyre ndaj umetit me anë të veprave, shkollave dhe njerëzve që kanë edukuar. Nisur nga kjo shoqëria e kohëve tona ka nevojë për një udhëzim të tillë. Kanë nevojë për udhëzimin e trashëgimtarëve të Profetit (a.s.) dhe njerëzve të devotshëm.

Gjithashtu, të rinjtë me potencial, por pa qëllim, kanë nevojë për mendje të pjekura që do t’u tregojnë horizontet e duhura.

Prirjet e egra të adoleshentëve kanë nevojë për edukimin me butësi, durim, pjekuri dhe mëshirë.

Egot e kapluara prej mendjemadhësisë, kanë nevojë për mësues që do t’u mësojnë thjeshtësinë, duke u treguar shërbimin.

Njerëzit e dijes që mburren me diturinë e tyre të thatë, kanë nevojë për gjetjen e rrugës së drejtë, që do t’i ruajë ata nga shkarjet.

Ashtu siç kanë nevojë të uriturit për mensat, ashtu kanë nevojë edhe të uriturit shpirtërorë për edukim.

Ashtu siç kanë nevojë të sëmuret për mjekët, ashtu ka nevojë edhe njerëzimi që po përpëlitet në probleme shpirtërore, për mjekët e zemrave.

Aliu (r.a.), ka thënë:

“Qëndroni me njerëzit e sinqertë dhe besnikë, me qëllim që t’ju kërkojnë njerëzit sa të jeni në jetë dhe të përmllohen për ju pasi të vdisni.”

NJERËZIT E EDUKUAR TË NJË QYTETËRIMI TREGOJNË VLERËN E TIJ

Çdo qytetërim, formon tipin e vet njerëzor. Është ai tip njerëzor që shfaq harmoni me veçoritë dhe karakterin e qytetërimit të cilit i përket.

Njerëzit e lartë me vargun e virtyteve dhe të edukatës (disa nga të cilët i përmendëm) janë shembujt më të zgjedhur të qytetërimit islam.

Ndërsa sot, për fat të keq, njerëzit tanë i edukon qytetërimi i egër perëndimor. Shoqërinë tonë e edukojnë kanalet e pista, botimet e degjeneruara, reklamat e padobishme, moda në formën më egoiste, më të paedukatë dhe më injorante.

Edhe silueta që kanë lënë në horizont shërbimet e të parëve tanë, reflekton mirësi në zemra, ngjall ndjenja të bukura dhe tregon madhështinë e këtij qytetërimi.

Ky është një qytetërim që përfshin të gjitha anët e jetës.

Qytetërimi islam është qytetërim në humanizëm, në moral dhe në personalitet.

Periodha e kalifëve të drejtë, periodha e Omer ibn Abdulazit dhe tre shekujt e parë të Perandorisë Osmane janë shembuj tipikë të madhështisë së qytetërimit dhe kulturës islame.

Ai është një qytetërim monumental me institucionet të ndërtuara drejt dhe njerëz të edukuar. Të gjithë personalitetet që përmendëm janë produkt i këtij qytetërimi.

Fatkeqësisht, sot njerëzit tanë edukohen vetëm sipas mënyrës së qytetërimit perëndimor.

Shoqëria jonë orientohet nga mendja e shturur, reklama të rreme dhe nga moda. Kjo sjell mbizotërimin e egoizmit, indiferentizmit dhe tjetërsimin e individit.

Detyra jonë përballë kësaj ere të ashpër, është:

Të jetojmë duke u kapur fort pas amanetit të Profetit tonë (a.s.). Të jetojmë me të dukshmen dhe me të fshehtën e Kuranit e të Sunetit, duke u përpjekur që me anë të urdhërimit për të mirë e ndalimit nga e keqja, të bëhemi përsëri umeti më i mirë. Duhet t’ua lëmë këtë synim si trashëgim edhe brezave të ardhshëm.

O Allah!

Mos na ndaj ne, brezat dhe shoqërinë tonë prej rrugës së ndritur dhe të bekuar të Profetit (a.s.), mos na privo prej dijes dhe kulturës që është trashëgimia e vërtetë e Profetit (a.s.). Mos na ndaj prej dijetarëve të sinqertë dhe të devotshëm që janë trashëgimtarët e tij!

Amin!..

Rrahman

EMRI QË PËRFSHIN GJITHË EKZISTENCËN

Ilir Hoxha

Nëse dëshirojmë që ekzistencën tonë në gjithësi ta vendosim në një vend të saktë, jemi të detyruar të kemi njohuri të sakta në lidhje me Allahun. Në fakt, është e pamundur që njeriu të arrijë ta kuptojë këtë me forcën e vet. Njohuritë në lidhje me Allahun na i ka njoftuar po Ai... Gjithashtu, edhe të gjithë librat hyjnorë, janë dërguar për këtë qëllim, pra, për të treguar Atë dhe marrëdhënien tonë me Të.

Sipas të dhënave të Kur'anit, në themel të kësaj marrëdhënieje qëndron fakti se Ai është Rrahman dhe Rrahim. Pra, aspekti primar i marrëdhënies së Tij me krijesat, është mëshira.¹ Po ashtu, këtë marrëdhënie shpreh edhe fakti që "bismilahi", që është edhe çelësi i të gjitha mirësive, i përmban të dyja këto aspekte të mëshirës.

Ideja se mëshira e Allahut e tejkalon zemërimin e Tij, është një prej parimeve më të rëndësishme të mendimit Islam. Tejkalimi i zemërimit prej mëshirës, është një prioritet ontologjik. E shprehur ndryshe, në krahasim me zemërimin, mëshira është esencialja, sepse mëshira, është rezultati i përbërjes thelbësore të Allahut, ndërsa zemërimi, është një cilësi dytësore, që është shfaqur për shkak të veprave të krijesave.² Për rrjedhojë, mëshira e Tij tek robërit, arrin para zemërimin.

Manifestimi i parë i mëshirës së Tij, është fakti që ne kemi dalë prej mos ekzistencës në ekzistencë. Ekzistenca, është një mirësi më vete dhe thelbi

i çdo mirësie. Ndërsa të gjitha dhuntitë natyrore që ka marrë çdo gjë në krijimin e parë, janë vepër e mëshirës. Për këtë arsye, nuk ka asnjë qenie tek e cila nuk mbërrin mëshira e Allahut dhe se të gjitha shpresat janë tek mëshira e Tij. E gjithë pagja dhe shpresat që mund të imagjinohen, janë në sajë të mëshirës së Tij.

Për shkak se humbja e shpresës është diçka që e zhubros njeriun përbrenda dhe e vret atë, në Kur'an, prerja e shpresave prej mëshirës së Allahut, është konsideruar si devijim dhe e barsvler-shme me mohimin.³

Në Kur'an, ashtu siç nuk është përdorur për as-kënd tjetër përveç Allahut, emri Rrahman, është përmendur gjithmonë si një cilësi dhati/esenciale dhe nuk ka funksionuar si akt por si emër. Cilësi të tilla, quhen "sifat-i galibe/cilësi mbizotëruese". Kjo, tregon se ajo cilësi është aq mbizotëruese, saqë për Allahun, mund të përdoret edhe në vend të emrit të Tij të përveçëm. Këtë e tregon edhe fakti se në Kur'an, vende-vende, emri "Rrahman", përdoret në vend të emrit "Allah".⁴ Për këtë arsye, të gjithë dijetarët janë në konsensus në lidhje me çështjen se emri "Rrahman" nuk mund t'i atribuohet asnjë krijese.

Mëshira, jo vetëm që është një nga cilësitë esenciale të Allahut, por Ai, edhe profetin e Tij të fundit e ka dërguar si mëshirë për të gjitha botët.⁵ Po

1. - shih. En'am, 12, 54; Gafir, 7.

2. - shih. A'raf, 156.

3. - shih. Jusuf, 87; Hixhr, 56; Ankebut, 23; Zumer, 53.

4. - shih. Isra, 110; Merjem, 69, 78, 90, 91, 96; Furkan, 60; Taha, 5, 108; Ra'd, 30.

5. - shih. Enbija, 107.



ashtu, edhe “Libri” që iu zbrit atij, është cilësuar si mëshirë për njerëzimin.⁶

Në qindra ajete, mirësitë materiale dhe shpirtërore që i janë falur njerëzimit, janë shprehur me nocionin “mëshirë”. Gjithashtu, edhe paqja e jetës familjare, është lidhur me ndjenjat e dashurisë dhe mëshirës.⁷

Mëshira hyjnore, nuk duhet të ngatërrohet me mëshirën e njerëzve. Mëshira e Tij, në aspektin sasior është e pafundme, ndërsa në aspektin cilësor, është shumë më superiore prej të gjitha llojeve të mëshirës që mund të mendohen. Sipas Isfahanit, kur “mëshira” i atribuohet Allahut, nënkupton “favor, mirësi ose ndihmë”, të cilat janë fryte të mëshirës. Në fakt, një mëshirë që nuk përmban mirësi, as që mund të mendohet, sepse mosrealizimi i asaj që kërkon dhembshuria, nga aspekti i dhembshurisë, jep të njëjtin rezultat me mos dhembshurinë.

Çështja, se si mund të përputhet mëshira e pafundme që i atribuohet Allahut, me sëmundjet, padrejtësitë, varfërinë dhe problemet e tjera që ndodhin në botë, është diskutuar shumë. Në lidhje me këtë çështje, është dhënë përgjigja se, në gjërat të cilat nuk pëlqehen nga njerëzit dhe cilësohen si të këqija, gjendet patjetër një mirësi⁸. Madje, nëse e keqja do të eliminohej plotësisht, do të eliminohej edhe e mira që përmban ajo, e cila do të ishte

në favor të njeriut në terma afatgjate. Allahu është më Mëshiruesi i mëshiruesve.⁹ Mirëpo, është e pamundur të njohësh të gjitha të fshehtat e akteve të Tij. Njerëzit në të cilët shfaqet ky emër i lartë i Zotit tonë, tregojnë mëshirë për të gjitha krijesat e Allahut pa asnjë dallim.

Sipas Gazaliut, frymëzimi shpirtëror që do të përfitohet prej emrit Rrahman, e bën njeriun që t’i këshillojë me mirësjellje dhe butësi robërit që kanë perde në sytë e zemrës, t’i shohë me syrin e mëshirës gjynahqarët, e jo me syrin e përçmimit dhe të përpiqet që të eliminojë çdo gjynahu që bëhet në këtë botë, duke i konsideruar ato si fatkeqësi. Kjo, sepse çdo gjynah, e largon nga Allahu atë që e vepron dhe njeriu që është larguar prej Allahut, ka më shumë nevojë për mëshirë. Ashtu siç vepron Drejtuesi i gjithësisë, edhe personat që drejtojnë njerëzit, duhet të ushqejnë ndjenja mëshire për vartësit e tyre, duhet të përpiqen t’i mbrojnë të drejtat e tyre dhe mëshira duhet ta tejkalojë zemërimin e tyre. Ashtu si Allahu i Madhëruar, i Cili ua ofron pa asnjë mangësi kushtet e jetës dhe ekzistencës të gjitha krijesave, edhe ata që drejtojnë punët e njerëzve, duhet t’u ofrojnë atyre ambientet dhe kushtet më të përshtatshme për punë. Ashtu si Allahu, i Cili nuk ia ndërpret mundësitë që i ka ofruar njerëzve për shkak të gjynaheve të tyre, edhe ata nuk duhet t’i përdorin si kërcënim mundësitë që u kanë ofruar njerëzve.

6. - shih. Junus, 57; Isra, 82; Neml, 76-77; Kasas, 86; Lukman, 3; Xh - thije, 20.

7. - shih. Rum, 21.

8. - shih. Bekare, 216.

9. - shih. Mu'minun, 109, 118.



GABIMET NË MENDIM

DËGJO ME ZË!

Një nga mirësitë që është e veçantë vetëm për njeriun, është aftësia e mendimit. Kur kjo aftësi përdoret me qëllim për të arritur njohuri, atëherë kthehet në meditim. Meditimi, është një proces mendimi që lind rezultate pozitive si, përvojën prej ndodhive, arsyetimin, kuptimin e urtësive pas çdo ngjarjeje dhe perceptimin e së vërtetës. Ndërsa funksionimi i gabuar i mekanizmit të mendimit, i hap rrugën rezultateve negative si, perceptimi i gabuar dhe negativ, mosvlerësimi i së vërtetës ashtu siç është, gjykimi në mënyrë të papërshtatshme me të vërtetat etj.

Pengesa më e rëndësishme në zhvillimin e mendimit në drejtimin pozitiv, është përgjithësimi dhe ekstremizmi. Si shembull i këtyre mund të jepet, dyshimi për keq, nxjerrja e gjykimeve të përgjithësuar, të padrejta dhe ekstreme duke u nisur nga një rast i veçantë, mbushja e zbrazëtirave të jetës duke prodhuar informacione të gabuara dhe të pavërteta në mendje, verbëria ndaj virtyteve të njerëzve pasi ke hasur në gabimin e tyre më të vogël dhe gjykimi negativ në lidhje me ta, vlerësimi i ndjenjave subjektive sikur janë të vërteta, damkosja e të gjithë individëve të një grupi të caktuar duke u nisur prej një cilësie negative të një individi të vetëm të atij grupi etj. Nëse këto gabime në të menduar, nuk kurohen në mënyrë të duhur, mund të bëhen shkak i shfaqjes së psikopatologjive të ndryshme.

LARGIMI PREJ EKSTREMIZMIT DHE GJETJA E RRUGËS SË MESME

Një prej parimeve themelore të fesë islame, është që çështjet të zgjidhen duke gjetur rrugën e mesme pa hyrë në "ifrat/teprim" dhe "tefrit/lëshim". Pra, në Islam theksohet qartë domosdoshmëria e largimit prej ekstremizmit dhe mbajtja e rrugës së mesme në çdo çështje, si në burimet e besimit, në çdo fushë

të jetës, në ngrënie e pirje, në fjetje, në punë, në ndjenja, në adhurime etj. Lidhur me këtë çështje, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

"Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit a.s.). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmanjur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe." (Fatir, 32)

"Ata vetëm thoshin: "O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!»" (Al-i Imran, 147)

TË BËHESH I DREJTË.

Mos teprimi në mendim, ruajtja e ekuilibrit dhe largimi nga ekstremizmi, janë domosdoshmëri për të qenë i drejtë. Ashtu siç është në kundërshtim me drejtësinë të dënosh me vdekje dikë që ka parkuar makinën gabim, ashtu edhe përgjithësimi i një fenomeni të kufizuar në një rreth të ngushtë, duke nxjerrë gjykime që e kapërcejnë atë fenomen dhe që përfshin gjithë shoqërinë, është një lloj padrejtësie. Këshillat që na jepen në këtë ajet fisnik, na tërheqin vëmendjen në zbatimin e drejtësisë në situata të ndryshme të jetës:

"Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t'ia vini veshin." (Nahl, 90.)

VLERËSIMI I NDODHIVE DHE PERSONAVE BRENDA VEÇORIVE TË TYRE

Në shembujt e jetës së Profetit (a.s.), shihet qartë parimi i mos vlerësimit në mënyrë të përgjithshme i grupit shoqëror me të cilin lidhen edhe ata që duken

se janë më të këqijtë. Ai na ka mësuar që gjithsecili duhet të vlerësohet në mënyrë të veçantë. Profeti ynë (a.s.), e ka konsideruar si mundësi udhëzimin në rrugën e drejtë edhe të atyre njerëzve që kanë jetuar gjithë jetën në gjynahe. Për shembull, ai e ftoi në Islam edhe Uahshin (r.a.), i cili i kishte vlarë xhaxhain, Hamzanin (r.a.), ku me këtë rast Uahshi e pranoi ftesën e tij. Po, edhe në situata shumë të rralla madje, kapja e realitetit, vërejtja e përjashtimeve brenda së përgjithshmes, mbajtja e ekuilibrit dhe pastrimi i mendimit nga kushtëzimet, janë urdhra të sistemit tonë të besimit.

Në Kuran, kur flitet për “ithtarët e librit”, shohim se:

“Ka nga ata ithtarë të Librit, që sikur t’u besosh një barrë të tërë ari, do t’jua kthejnë, por ka edhe të atillë që, nëse u jep në besim, qoftë edhe një dinar, nuk ta kthejnë, veçse nëse nuk u ndahesh!..” (Al-i Imran, 75)

Në ajetin fisnik: **“Një grup ithtarësh të Librit dëshirojnë që t’ju shpien në rrugë të gabuar...”** (Al-i Imran, 69), jepet përshtypja se nuk duhet të fusësh në një thes të gjithë individët e një grupi dhe, ashtu siç mund të ketë prej tyre që gabojmë, ka edhe prej atyre që veprojnë drejtë, ose jo të gjithë janë në të njëjtin veprim të gabuar. Këto ajete na kujtojnë se edhe njerëzit që i përkasin një grupi të caktuar mund të shfaqin modele të ndryshme të sjelljes. Për rrjedhojë, na këshillojnë të mbajmë ekuilibrin në të menduar dhe të folur, duke u sjellë në mënyrë të përshtatshme. Për shembull, të vjetrit tanë, këshillojnë që kur të vlerësojmë njerëzit e tjerë, të mos e bëjmë këtë duke përdorur cilësitë e tyre. “Ashtu sikur jo çdo cilësi e një besimtari është cilësi prej besimtari, ashtu mund të gjenden cilësi prej besimtari edhe tek ata që nuk janë besimtarë.” Shembull i kësaj të vërtete, është fakti se, megjithëse kryerja e një pune “mirë dhe saktë” është prej moralit të myslimanit, morali dhe disiplina e punës në disa vende Perëndimore, është shumë herë më e mirë në krahasim me vendet Islame.

Teprimi në fajësimin e një besimtari duke u nisur nga disa sjellje të tij të gabuara, po ashtu është një gabim i madh. Po, tek një besimtar, përveç disa gabimeve njerëzore, gjenden virtyte të mëdha sa malet, siç është mirësia e besimit. Për këtë arsye, nuk duhet të shfaqet padrejtësi dhe teprim duke i zmadhuar më tepër disa gabime dhe duke i zhvlerësuar virtytet e tjera. Nën dritën e këtyre të vërtetave, del në pah se sa e gabuar është qasja që fajëson të gjithë individët

e një shoqërie për shkak të mendimit apo veprimit të gabuar të njerit prej tyre.

LARGIMI PREJ PËRGJITHËSIMEVE TË TEPRUARA

Përgjithësimet, ndonjëherë duhen për të vendosur rregulla. Përveç kësaj, struktura e mendimit njerëzor është e prirë drejt përgjithësimeve. Kjo është një cilësi që i është dhënë njeriut si një mekanizëm mbrojtjeje. Mirëpo, fakti se çdo aftësi që i është dhënë njeriut që në lindje është një proces zhvillimi, është një e vërtetë e pamohueshme. Kjo mund të jetë e dobishme për t’u sjellë në mënyrë të barabartë me njerëzit dhe për të lehtësuar procesin e punës kur drejtoni një vend. Por duhet bërë kujdes që kjo të kufizohet dhe këtë qasje të mos e zbatosh për gjithçka. Duhet pasur shumë kujdes sidomos në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me njerëzit. Ndarja e të mirit nga i keqi, e të drejtit nga gënjeshtari, e besnikut prej jo besnikut dhe mos vendosja e të gjithëve në një thes, janë çështje ku drejtuesit duhet të bëjnë shumë kujdes.

Përgjithësimi i tepruar në lidhje me disa ndodhi që hasen në jetën e përditshme, vërehet tek sëmundjet psikiatrike që quhen “psikoza”. Për shembull, siç mendon dikush që dëgjon rastësisht në televizion një bisedë në lidhje me gjendjen e tij, se “në televizion flitet gjithmonë për të” dhe se “vazhdimisht i vijnë mesazhe prej televizionit”.

Efektin pozitiv të parimeve tona të besimit, e shohim edhe në përmbledhjen e mendimeve tona dhe orientimin e tyre në rrugën e drejtë. Ndalimi i paragjyqimit në fenë tonë, është një masë paraprake ndaj shpifjeve, gënjeshtreve dhe ekzagjerimit ndaj gabimeve të njerëzve.

Në emër të saktësisë në mendim dhe ruajtjes prej teprimeve, duhet t’i vlerësojmë ndodhitë sipas veçorisë së tyre në bazë të shembujve që marrim prej jetës së Profetit tonë (a.s.), pa bërë përgjithësime negative në jetën e përditshme. Gjithashtu, duhet të kemi kujdes të mos i ekzagjerojmë çështjet dhe të mos veprojmë në mënyrë të padrejtë.

Njeriu që përpiket të njohë veten dhe Krijuesin e tij prej pasqyrës së gjithësisë, duhet ta pajisë edhe botën e tij të mendimit në nivelin më të lartë, duhet të arrijë të kuptojë të vërtetën e gjithësisë dhe në sajë të kësaj të përpiket të mendojë me urtësi.

DHIKRI I PULSORËVE

— Muaz Erdem —

Kur hedhim vështrimin tonë në qiell në një natë të errët, shohim me qindra yje. Ne pandehim se këto yje qëndrojnë gjithmonë në të njëjtin vend dhe në të njëjtën formë. Mirëpo, yjet nuk janë aspak aq të qetë sa duken. Në këtë gjithësi pa anë e pafund çdo gjë është e përkohshme, përveç Allahut të Madhëruar, i Cili është i pafund. Nga kjo pikëpamje, edhe yjet nuk ndryshojnë shumë nga njerëzit, sepse edhe yjet lindin, rriten dhe vdesin brenda një cikli ashtu si njerëzit. Ja pra, në këtë shkrim do të flasim për një nga fazat e jetës së yjeve, që në të njëjtën kohë është edhe faza e fundit e tyre, pra, vdekjen.

Yjet përfitojnë energji duke e kthyer hidrogjenin brenda tyre në helium. Në këtë mënyrë ata vazhdojnë ekzistencën e tyre. Për shkak të djegies së vazhdueshme të hidrogjenit, pas njëfarë kohe, ai konsumohet i gjithi. Këtë herë, heliumin që e përftonte prej hidrogjenit, ylli fillon ta kthejë në karbon. Mirëpo, kësaj here ka një problem, sepse energjia që del në pah gjatë kthimit të heliumit në karbon, është shumë më e madhe se energjia që del në pah prej kthimit të hidrogjenit në helium. Shkurtimisht, kjo energji e jashtëzakonshme që del në pah, bëhet shkak që ylli të zgjerohet dhe të zmadhohet me shpejtësi të madhe. Arsyeja e këtij zmadhimi, është se forca tërheqëse e bërthamës së yllit, është më e vogël se energjia që del në pah.

Ashtu siç konsumohet hidrogjeni i kthyer në helium, konsumohet edhe heliumi që kthehet në karbon. Tashmë, nuk ka mbetur më asnjë burim që do të mund të prodhojë energji. Për rrjedhojë, ylli i mbetur pa energji, fillon të tkurret duke u shkatërruar

brenda vetes. Ndërsa faktori që përcakton se si do të jetë fundi i yllit, është masa e tij në atë moment. Nëse pas këtyre fazave masa e yllit është 1.4 herë më e madhe ose 3 herë më e vogël se masa e Diellit, atëherë ai kthehet në një yll neutron.

Kur ylli bie brenda vetes, duke u tkurrur mjaftueshëm, elektronet dhe protonet bashkohen dhe formojnë neutronet. Më pas, gazi i neutronit ekuilibron forcën tërheqëse të bërthamës, duke i dhënë fund fazës së tkurrjes. Tashmë, rezultati që del në pah është një yll neutron me diametër 15 Km. Një lugë çaji e mbushur me materialin e këtij ylli neutron, peshon 500 milion ton. Shifrat janë aq të mëdha, sa që njeriu ndonjëherë nuk arrin t'i konceptojë.

Yjet neutrone formohen si rezultat i supernovave. Për këtë arsye, yjet neutrone vëzhgohen brenda mbetjeve të supernovave. Shembulli më i bukur i kësaj, është mbetja e supernovës së Gaforres, e cila është vëzhguar me sy të zhveshur nga kinezët në vitin 1054. Për 23 net me radhë, ajo ka qenë objekti më i ndritshëm i qiellit pas Hënës. Vendi i mbetjeve të supernovës së Gaforres në hapësirë, përputhet saktë me vendin e treguar prej astronomëve kinezë në shënimet e tyre.

Në vitin 1967, Jocelyn Bell Burnell dhe Antony Hewish po kryenin kërkime shkencore astronomike me radioteleskop në Universitetin Cambridge. Gjatë kërkimeve të tyre në një zonë të caktuar të hapësirës zbuluan një sinjal të çuditshëm. Kur e fokusuan kërkimin e tyre në këtë pikë, gjetën një sinjal që vinte me intervale prej disa sekondave. Këto sinjale i bënë të dyshojnë se, “vallë mos janë

sinjale që vijnë nga genie inteligjente jashtëtokësore?”. Për këtë arsye, këto sinjale në fillim i quajtën “njeriu i vogël i gjelbër-1”. Por më vonë, kur u kuptua se këto sinjale mund të vinin vetëm nga një yll, e ndërruan emrin, duke e quajtur “pulsor”. Më vonë, dy shkencëtarë të quajtur Thomas Gold dhe Franco Pacini kapën valët e radios me intervale të shkurtra të mbetjeve të supernovës së Gaforres dhe kuptuan se burimi i këtyre sinjaleve duhej të ishte prej masës së dendur. Në këtë mënyrë, u kuptua se burimi ishte një yll neutron (pulsor) që rrotullohej me shpejtësi shumë të madhe rreth vetes.

Kur flasim për shpejtësi të mëdha, bëhet fjalë për shifra marramendëse. Për shembull, më i thjeshti, pulsori brenda Nebulës së Gaforres, rrotullohet 0.33 herë në sekondë rreth vetes (kjo shifër është shumë kuptimplote për ne). Ndërsa disa pulsorë të tjerë,

bëjnë njëmijë rrotullime në sekondë, që përafërsisht i bie të rrotullohet me shpejtësi 60.000 km. Nën dritën e këtyre të dhënave, kënaqësia e meditimit duhet të jetë diçka shumë e veçantë.

Përveç shpejtësive të jashtëzakonshme të rrotullimit të pulsorëve, të tërheq vëmendjen edhe zëri që del prej sinjaleve që merren prej tyre. Nëse kërkoni në internet “pulsar sounds”, do të kuptoni më mirë zërin që vjen prej këtyre yjeve. Duket sikur në rrotullimin e tyre ata thonë vazhdimisht “Allah, Allah, Allah”, duke përmendur emrin e Zotit të Botëve. Kjo, na sjell në mendje këtë ajet fisnik: **“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës.”** (Isra, 44)



HAREZMI

NJERIU QË MATI PERIMETRIN E TOKËS

— Muaz Erdem —

Nëse shohim historinë e shkencës, vërejmë se shumica e shkencëtarëve që kanë realizuar të parët diçka, kanë qenë prej vendeve islame. Madje edhe historianët Perëndimorë nuk kanë mundur t'i mohojnë dot sukseset e shkencëtarëve myslimanë në fushën e mjekësisë, fizikës, kimisë, matematikës, astronomisë e shumë fusha të tjera, duke u lënë atyre vend të gjerë edhe në veprat e tyre. Prandaj, këtu do të flasim shkurt për babanë e algjebër, mate-

matikanin dhe astronomin e famshëm, Ebu Xhafer Muhammed bin Musa el-Harizmi.

Megjithëse nuk dihet me saktësi se kur ka lindur Harizmi, disa të dhëna thonë se ka lindur në viteve 770-780 dhe ka jetuar në Bagdad në periudhën e halifit Me'mun. Gjatë kohës kur ka qenë në detyrën e përgjegjës të librisë së Bejtu'l-Hikme në Bagdad, ka shkruar shumë vepra në fushën e matematikës,

astronomisë dhe gjeografisë. Vepra e tij “Kitabu’l-Muhtasar fi hisabi’l-xhebr ue’l-mukabele”, gëzon titullin si libri i parë i matematikës në emrin e të cilit gjendet fjala “xhebr/algjebër”. Ndërsa një vepër tjetër e tij, që është “Zixhu’l-Harizmi”, është vepra e parë në fushën e astronomisë islame që ka ardhur deri në ditët tona.

Shemsedin Gynaltaj, në Kongresin e parë të Historisë Turke, ka folur kështu në lidhje me punimet e Harizmit në fushën e astronomisë: *“Veziri bir veziri i Shtetit Abbasi, Jahja Bermeki formoi një akademi të quajtur “Bejtu’l-Hikme/Shtëpia e filozofisë”. Kryetari i saj ka qenë Ebu Abdullah Muhamed ibn-i Musa prej Harezmit. El-Harizmi që njohin evropianët, ka qenë përgjegjësi i bibliotekave të Me’munit. Po ky person, ka qenë dijetar më i madh i kohës në fushën e astronomisë dhe matematikës. Ky dijetar i madh, ka ndërtuar për herë të parë dy observatorë të vërtetë në Bagdad dhe Siri. Pas një pune të gjatë shumëvjeçare, nxori në dritë veprën Zixhu’l-Harizmi. “Zixh”, është shkencë që llogarit lëvizjen e yjeve. Dhe, kjo vepër u bë udhëzuesi i botës së dijes për shumë shekuj. Kjo vepër është përkthyer në latinisht që prej shekullit të XII, prej Adelar Debat. Gjithashtu, kjo vepër ka qenë thelbësore për Rilindësit evropianë në shekullin e XVI.”*

Siç e tha edhe Shemsedin Gynaltaj, Harizmi është personi që ka ndërtuar për herë të parë në botë observatorët e vërtetë. Dhe kjo, është një nga argumentet më të rëndësishme që tregojnë se shkencëtarët myslimanë i mbështetnin studimet e tyre në vëzhgimet shkencore. Mirëpo, dijetarët perëndimorë, e veçanërisht grekët, e kanë studiuar astronominë më shumë në aspektin filozofik dhe, për këtë arsye, ata janë zhytur në devijimin e atribuimit të fenomeneve kozmike disa zotave të çuditshëm.

Max Vintanjoux, ka pohuar në veprën e tij “Le Miracle Arabe” kontributin e madh të Harizmit në fushën e matematikës në sajë të studimeve tij të shumta në këtë fushë, megjithëse emri i tij ka qenë më i famshëm në fushën e astronomisë: *“Libri i Harizmit në lidhje me algjebërën është shumë i famshëm. Fjala “xhebr/algjebër” që përdoret në këtë libër, është futur si “algoritmi” dhe më së fundi ka ardhur deri në ditët tona si “logaritmi”. Kjo vepër që është përkthyer*

nga Gerard de Ciremon, ka qenë një nga gurët e qoshes të strukturës së madhe të matematikës që është ndërtuar prej arabëve të vjetër dhe që pas një farë kohe i ka familjarizuar kolegët e tyre të parë perëndimorë me veçoritë e algjebërës dhe aritmetikës së numrave dhjetorë.”

Ndërsa në librin “Kitabu Sureti’l-Ard”, Harizmi jep të dhëna në lidhje me koordinatat e qyteteve dhe disa zonave. Me anë të kësaj vepre, ai është bërë shembull për gjeografët myslimanë dhe u ka ndriçuar rrugën atyre. Ndërkohë që në Evropë deri nga fundi i mesjetës pranohej ende se Toka është e sheshtë, Harizmi jo vetëm që kishte zbuluar rrrumbullakësinë e Tokës, por kishte arritur të maste perimetrin e tokës me rezultate të përafërta me matjet e bëra në ditët tona.

Përkundër famës së Harizmit në historinë e shkencës, të dhënat në lidhje me jetën e tij janë shumë të pakta. Ashtu siç nuk dihet saktë viti i lindjes, nuk dihet saktë as viti i vdekjes. Mirëpo, sipas të dhënave që jepen në disa libra historie, dihet me siguri se ka ndërruar jetë pas vitit 847.

Allahu qoftë i kënaqur prej këtij shkencëtarit mysliman, i cili është babai i algoritmit që përbën themelin e sistemit kompjuterik dhe, në të njëjtën kohë është edhe themeluesi i observatorëve të vërtetë. Zoti ynë na dhëntë edhe neve prej dashurisë për shkencën dhe diturinë që kishte el-Harizmi!

Shkrimin tonë po e mbyllim me një hadith fisnik në lidhje me dijetarët, që gjendet në Sahihun e Buhariut:

“Nëse dikush merr një rrugë me dëshirën për të mësuar dituri, Allahu ia lehtëson atij njeriu rrugën e xhennetit. Për shkak se melekët e pëlqejnë atë që bën ai, ata i hapin krahët mbi atë që dëshiron të marrë dituri. Banorët e qiejve e të tokës, madje edhe peshqit brenda në ujë kërkojnë falje (prej Allahut) për njeriun e ditur. Epërsia e dijetarit në krahasim me adhuresin, është si epërsia e Hënës në krahasim me yjet e tjerë. Padyshim, dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve. Profetët nuk lënë trashëgim as ar dhe as argjend, por vetëm dituri. Kush e merr atë trashëgimi, ka marrë mirësi dhe kismet të mjaftueshëm.” (Buhari, Ilm 10.)





Khubejr ibn Mut'imi

Mustafa Erish

Khubejr ibn Mut'imi, (r.a.), jetoi me pendimin e të qëndruarit larg dritës së Islamit për një kohë të gjatë. Ai ka transmetuar rreth gjashtëdhjetë hadithe nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Në këto transmetime mund të shihet qartë mallëngjimi dhe pendimi i tij. Disa prej këtyre haditheve fisnike janë këto:

Khubejr ibn Mut'imi (r.a.), tregon: "I Dërguari i Allahut, (a.s.), në një vend të quajtur Hajf në Mina, u ngriti në këmbë dhe tha:

"Allahu ia ndriçoftë fytyrën atij që e dëgjon fjalën time dhe e predikon ashtu siç e ka dëgjuar, sepse ka shumë njerëz që e dinë fikhun (të mbushur me hadithe), por që nuk janë fakihë. Ka shumë mbartës hadithesh që ua çojnë hadithet atyre që janë më fakihë se ata.

Ka tri cilësi që përderisa të jenë ato, zemra e besimtarit nuk mbart urrejtje dhe armiqësi: Ta bësh punën me sinqeritet për hir të Allahut Teala, të jesh dashamirës ndaj udhëheqësve myslimanë dhe të frekuentosh xhematin e myslimanëve... Sepse lutjet e myslimanëve i përfshijnë të gjithë ata që i bashkohen xhematit." (Ibn Maxhe, Menasik, 76.)

Ebu Muhamed Khubejr ibn Mut'imi, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Ai që i shkëput lidhjet me të afërmit e tij nuk mund të hyjë në Xhenet."* (Buhari, Edeb 11; Muslim, Birr 18-19.)

Khubejr ibn Mut'imi (r.a.), ka thënë: Ndërsa po ecja bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), kur po ktheheshim nga lufta e Hunejnit, arabët beduinë filluan ta kërkonin me këmbëngulje ndarjen e plaçkave të luftës. Më së fundi, të Dërguarin e Allahut (a.s.), e ndaluan nën pemën Semure. Pelerina e Pejgamberit tonë të dashur ngeci te pema. Pejgamberi, (a.s.), e ndaloi devenë dhe u tha:

"Ma jepni pelerinën! Po të kisha kafshë aq sa këto pemë që i shikoni, të gjitha do t'jua ndaja juve. Pastaj edhe ju do ta shihnit se unë nuk jam një koprrac, mashtrues dhe frikacak!" (Buhari, Xhihad 24, Humus 19.)

Khubejr ibn Mut'imi (r.a.), tregon: I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"O Beni Abdumenafl! Kushdo prej jush që merr ndonjë përgjegjësi në udhëheqjen e popullit, kurrë të mos e ndalojë dikë që e viziton Shtëpinë e Allahut në ndonjë orë të ditës apo të natës dhe që fal namaz."* (Tirmidhi, Haxh 42; Ebu Davud, Menasik 53.)

Khubejr ibn Mut'imi (r.a.), tregon: I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Unë kam pesë emra: Unë jam Muhamedi, unë jam Ahmedi, unë jam el-Mahi (ai me të cilin Allahu do ta shkatërrojë kufrin). Unë jam Hashiri (mbledhësi). Njerëzit do të mblidhen pas meje. Unë jam Akibi (pasardhësi). Pas meje nuk do të ketë Pejgamber tjetër."* (Buhari, Menakib 17; Muslim, Fedail 125; Tirmidhi, Edeb 67.)

Khubejr ibn Mut'imi, (r.a.), mori pjesë në grupin që shkoi për t'u takuar dhe për t'i kthyer mbrapsht mëkatarët që bënë kryengritje kundër Osmanit (r.a.) dhe që po shkonin drejt Medines për të sulmuar. Pasi Osmani ra dëshmor, mori pjesë në varrimin e tij duke marrë parasysh çdo lloj rreziku. Madje, sipas një transmetimi, namazin e xhenazes së Osmanit, (r.a.), e fali ai. Khubejr ibn Mut'imi (r.a.), ndërroi jetë në Medine në vitin 58 hixhri ose thënë ndryshe në vitin 678 të erës sonë.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Allahu Teala na bëftë të gjithëve largpamës dhe të sinqertë si Khubejr ibn Mut'imi (r.a.)! Amin!..

6 SEKONDA MË PARË



Nëse midis titujve që po shfleton tani hap dhe lexon këtë shkrim, në fakt vendimi yt ishte i tillë gjashtë sekonda para se të shfletote faqen. Nëse bie alarmi dhe të fton për namaz ende pa cicëruar zogjtë dhe ti e mbyll e vazhdon të flesh, ti kishe vendosur të veproje kështu ende pa hapur sytë... Shokët po të thërrasin... Në fillim ofrohen dy alternativa: Një ftesë që tymos në ambientin e gjnahut, ose vazhdimi me devotshmëri në rrugën e mirë... Nëse hapi yt shkon në të majtën, do të thotë se ti ke zgjedhur atë alternativë para se të vijë ftesa... Në fakt, çdo alternativë drejt së cilës na orienton nënvetëdija jonë, nuk është gjë tjetër përveçse dëshirat tona që ne i kemi koduar thellë- thellë në veten tonë.

Pikërisht, një eksperiment që është bërë për të studiuar burimin dhe kohën e vendimeve që i marrim më mënyrë të tillë, ka treguar se në fakt, shumë prej vendimeve që marrim, realizohen jo prej vetëdijes, por prej nënvetëdijes sonë.

Eksperimenti u bë shumë thjeshtë. Një person u fut në një skaner truri dhe iu dha në të dyja duart nga një buton, të cilët do t'i shtypte pa rend. Ndërsa skaneri tregonte ndryshimin midis momentit kur truri merrte vendimin dhe momentit kur personi shtypte butonin. Rezultatet ishin të habitshme. Nga sinjalet e trurit, u kuptua se personi e merr vendimin gjashtë sekonda para se të shtypë butonin. Pra, gjashtë sekonda pa marrë ende një vendim, në fakt nënvetëdija jonë e ka marrë vendimin. Kjo situatë i frikësoi studiuesit, sepse në vend që vendimet tona t'i japim në mënyrë të vetëdijshme, aktivitetet që vepronë në nënvetëdijen tonë, e kanë marrë atë vendim disa sekonda më parë.

Në fakt, ky studim që u publikua edhe në BBC, tregon se “mendja si vetëdije është koduar në aktivitetet e trurit dhe realizohet prej aktiviteteve të trurit. Mirëpo, nënvetëdija jonë i njej mirë anët tona të caktuara, dëshirat dhe prirjet që gjenden në aktivitetin e trurit. Ndërsa vendimet që marrim realizohen në përputhje me besimin dhe dëshirat tona. Pra, çdo vendim që merr nënvetëdija jonë, nuk mund të na detyrojë të bëjmë diçka që nuk e dëshirojmë. Domethënë se, ne vetë e kemi dëshiruar dhe vetë e kemi bërë...”

Jetojmë në një botë sprovas. Zgjedhjet tona midis të mirave dhe të këqijave, do të dënohen ose do të shpërblehen para Gjyqit më të madh. Për këtë arsye,

betimi dhe dëshmia që kemi deklaruar, duhen përsëritur pesë herë në ditë, sepse përgjigjet e vërteta që do të pranohen atë ditë, nuk do të jenë gjë tjetër përveçse përgjigjet që dalin prej nënvetëdijes dhe zemrës sonë.

Fay Weldon, ndikimin që kanë zakonet që kemi fituar gjatë jetës në zgjedhjet që bëjmë, e shpjegon me këto fjalë: *“Vetëm një gjë mund të ndikojë në nënvetëdijen tonë: Aktivitetet që përsëriten... me manifestimin e asaj çfarë do të veprosh vazhdimisht në jetë do të përballesh pashmangshmërisht.”*

Ajetet që i përsëritim vazhdimisht kur lexojmë Kuran, deklarimin që bëjmë çdo ditë në mënyrë të shpeshtë të Njëshmërisë së Allahut dhe të profesisë së Muhamedit (a.s.), përsëritja 33 herë me radhë në çdo dhikër i përsosmërisë së Allahut, madhështisë dhe falënderimit për mirësitë e Tij dhe përsëritjet që i bëjmë në mënyrë të sinqertë, në fakt janë përpjekjet që bëjmë për të vendosur besimin tonë prej vetëdijes në nënvetëdijen tonë.

Aftësia për të kontrolluar egon tonë është diçka që mund të arrihet vetëm nëse fjala jonë jehon në muret e nënvetëdijes. Jane Fonda, në lidhje me eliminimin e mendimeve që na vijnë në mendje, shprehet: *“Asnjëherë nuk mund t'i kontrollojmë mendimet tona, ndërsa fjalët po. Dhe, duke bërë sa më shumë përsëritje, ne mund të rregullojmë nënvetëdijen, duke marrë nën kontroll gjendjen në të cilën ndodhemi.”*

Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që Kurandin ta lexojmë vazhdimisht, ta analizojmë dhe me anë të meditimit ta kodojmë në nënvetëdijen tonë. Prof. Dr. Idris Shahin, në shkrimin e tij me titull “Edukimi në Kuran me anë të pyetjeve”, shprehet: *“Fëmijët i pyesim për t'i provuar. Ndërsa pyetjet e Kuranit janë dashamirëse. Nuk pyeten për të matur dituritë, sepse, pyetjet në Kuran, në fakt janë pyetje që ua dini përgjigjen, por bëhen për të marrë aprovimin tuaj me qëllim që të kodohen në nënvetëdije.”*

“A nuk po falënderoni?”, **“A nuk ju kemi krijuar Ne?”**, **“A nuk po mendoni?”** dhe pyetje të tjera si këto, në fakt shërbejnë për të ritheksuar përgjigjet që ne i kemi regjistruar në nënvetëdijen. Për rrjedhojë, për të kontrolluar vendimet që merren gjashtë sekonda përpara, duhet të bëjmë kujdes ndaj zakoneve, ambienteve të cilat i frekuentojmë vazhdimisht dhe në zgjedhjeve që bëjmë.



Ah sikur TË MOS NA KAPTE MË GRIPI

Sikur të ishte vetëm një vaksinë, e të na dhembte vetëm njëherë gjilpëra, por të mjaftonte si mburojë nga gripi për gjithë jetën... Sikur ta groposnim në histori me një vaksinë sëmundjen e gripit që shkakton vdekjen e pothuajse gjysmë milioni njerëz në vit. Sigurisht që po ta arrinim këtë, do të gjenim edhe kurën e virusit të AIDS-it, i cili shkakton vdekjen e dy milion e gjysmë njerëzve në një vit.

Ndërkohë që Nobelisti David Baltimore po fliste për këto çështje, unë po përiqesha të hyja në sallë. Fjalitë që kishin ardhur t'i dëgjonin në këmbë duke shtyrë njëri-tjetrin me qindra shkencëtarë, ishin shumë emocionuese. Kur po shpjegonte studimin e fundit gjenetik që kishin realizuar, po jepte lajmin e mirë se në të ardhmen shumë sëmundje do të kuroheshin vetëm me një vaksinë. Një vaksinë të ngjashme me atë të AIDS-it, që ata kishin arritur të zhvillonin, e kishin bërë edhe për sëmundjen e gripit. Me sa duket nuk do të kemi më nevojë t'u bëjmë njerëzve vakcina që ndryshojnë për çdo vit. Në eksperimentet e fundit të zhvilluara, është treguar se një vaksinë mund të ndikojë për dhjetë vite me radhë. (Alex Balozs. AAV Mediated Delivery)

Kur këto fjalë i thotë David Baltimore, ato nuk mund të mendoheshin si «iluzion». Mirëpo, në këtë çështje ka edhe prapaska. Në fjalimin e një shkencëtari që ia ka dedikuar jetën studimit të virusëve vdekjeprurës dhe mikrobeve, gjendej një fjalë, të cilën e morëm shënim: «Kjo vaksinë, në të ardhmen mund të përdoret edhe për bioterrorizëm». Kjo, sepse ai e dinte shumë mirë se viruset vdekjeprurës dhe

mikrobet të cilat i studionte, kishin potencialin e një bombe të vogël atomike. Por, nëse do të prodhohej një vaksinë kundër këtyre virusëve dhe mikrobeve, e të përdorej në të gjithë vendin, mund ta eliminonte këtë rrezik.

Popujt Je>xhuxh dhe Ma>xhuxh, në kohën tonë mund të mos shkaktojnë probleme vetëm me anë të armatimit dhe televizionit. Ashtu siç veproi Dhulkarnejni kundër këtyre popujve problematikë, duke ndërtuar një mur mbrojtës prej çeliku të përzier me hekur dhe bakër, ashtu duhen kombinuar edhe metoda të ndryshme për të prodhuar vakcina kundër virusëve dhe mikrobeve vdekjeprurës.

Sot për sot, nuk kemi ende një strukturë mbrojtëse me qëllim që të mbrohemi prej sulmeve dhe armëve kimike. Për rrjedhojë, nuk duhet të çuditemi nëse nuk e kemi këtë mbrojtje as kundër armëve biologjike. Kjo nuk duhet të mendohet thjesht në aspektin e dëmeve të shpërthimit të bombave, por duhet menduar si një masë mbrojtëse kundër sëmundjeve ngjitëse.

Studimet që bëri para disa kohësh Baltimore në lidhje me antraksin, na tmerruan të gjithëve. Ndërsa sot, SHBA-të kanë prodhuar një stok vaksinash kundër antraksit sa për tre qytete. Shpresojmë që në sajë të kësaj metode vaksinimi, një ditë askush nuk do të ketë frikë prej sulmeve dhe armëve biologjike. Në të njëjtën mënyrë, do të prodhohen edhe vakcinat kundër gripit, AIDS-ist, kancerit dhe shumë virusëve vdekjeprurës, duke e mbrojtur njeriun për gjatë gjithë jetës.



Pendimi

Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.
(Huxhurat,11)

Hereviu shprehet se pendimi i plotë mund të arrihet vetëm pasi të njihet mëkati i kryer, kurse njohja e mëkatisë pari realizohet duke u bërë i vetëdijshëm se kryerja e mëkatisë nga mbrojtja e Allahut, së dyti duke kuptuar që nefsi kënaqet nga kryerja e mëkatisë dhe në vend që të përpiqet për të përmirësuar gabimin këmbëngul në mëkat. Në këtë mënyrë udhëtari duke e ditur se kundërshtimi i Allahut do ta devijojë nga rruga e drejtë, fillon të pranojë urdhëresat dhe ndalesat e Allahut, në vend që të marrë kënaqësi nga mëkati fillon të ndjejë trishtim shoqëruar me pendim dhe menjëherë përpiqet me të gjitha forcat për të hequr dorë nga mëkati. Nga ky këndvështrim pendimi përmban tre kushte:

1. Ndjenjë keqardhjeje,
2. Kërkim faljeje prej Allahut,
3. Heqja dorë nga mëkati.

Pra teubja realizohet vetëm përmes pendimit me zemër, kërkimit falje me gojë dhe distancimit fizik prej mëkatisë.

Imam Hereviu e trajton pendimin në tre nivele,

realiteti i pendimit, sekretet e realitetit të pendimit dhe hollësitë e sekreteve. Sipas tij, realiteti i pendimit bazohet në tre parime:

1. Konsiderimi i çdo mëkatisë të madh.
2. Mendimi se pendimi nuk është kryer i plotë dhe angazhimi në përmirësimin e mëtejshëm të tij.
3. Kërkimi ndjesë prej të gjithë atyre që u është bërë padrejtësi.

Edhe sekretet e realitetit të pendimit ose thënë ndryshe realiteti i brendshëm i pendimit është tri pjesë.

1. Dallimi i plotë midis devotshmërisë që është vetëm për Allahun dhe asaj që është për të fituar pozitë, famë dhe post. Sepse shumica e njerëzve sillen si të devotshëm për të fituar pozicione të rëndësishme. Prandaj personi që me të vërtetë dëshiron të pendohet duhet të qëndrojë larg këtyre qëllimeve.

2. Personi që dëshiron të pendohet, në vend që të merret me mëkatin duke e rikujtuar herë pas here, duhet ta kalojë kohën duke përmendur Allahun. Rikujtimi i mëkatisë është konsideruar si një mëkat tjetër nga dijetarët. Ndërsa mëkati është cilësi e njeriut, falja dhe mëshira janë cilësi të Allahut,

prandaj në vend që të mendojë mbi mëshirën e Allahut, ai angazhohet me mëkatën.

3. Pendimi për teuben, kur personi i penduar tashmë vlerëson pendimin shikon mangësitë në të dhe menjëherë pendohet për mangësitë e pendimit. Ajeti: **“Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar.”** (Nur, 31) aludon pikërisht këtë çështje. Udhëtari në çdo moment duhet të jetë në gjendje pendimi.

Po ashtu edhe hollësitë e sekreteve ndahen në tri pjesë:

a. Reflektimi mbi mëkatën dhe gjykimin hyjnor në lidhje me të. Në këtë mënyrë kupton që atij i është dhënë vullneti i lirë nga Allahu për të zgjedhur, për ta kryer apo jo mëkatën. Sipas Hereviut, Allahu për dy arsye nuk ka vendosur pengesë midis robit dhe mëkatit. E para, në mënyrë që njeriu të njohë madhësinë e Allahut dhe të kuptojë që askush nuk mund ta kundërshtojë caktimin e Tij, e dyta Allahu duke mbuluar mëkatet e robit në mënyrë që të mos turpërohet midis njerëzve, duke mos i dënuar menjëherë, por duke u lënë kohë për pendim shfaq bujarinë, mirësinë dhe urtësinë e Tij. E treta është për të treguar drejtësinë e Tij ndaj njerëzve, thënë ndryshe, për të treguar se dënimi i njerëzve për mëkatet e bëra është domosdoshmëri e drejtësisë. Udhëtari duke u bërë i vetëdijshtëm për këto, largohet nga mëkatet, drejtohet nga Krijuesi i gjithësisë, e falënderon Atë për mirësitë, përpiket të rregullojë sjelljen e vet karshi Allahut dhe njerëzve dhe në çdo moment mundohet të jetë në audiencën hyjnore.

b. Saliku, duke e perceptuar realitetin e gjërave siç janë realisht, kupton që të gjitha veprat e

mira, përfshirë edhe pendimin, janë dhuratë dhe mirësi e Allahut.

Ai është i vetëdijshtëm se për të gjitha veprat e mira, të kryera për hir të Allahut, do të shpërblehet dhe nëse nuk i ka kryer për hir të Tij, por për interesa të ndryshme materiale atëherë veprat nuk do t'i japin asnjë dobi. Në këtë mënyrë ai mbetet midis shikimit të mirësive dhe mangësive në vepra dhe zemër. c. Ai kupton se vetëm Allahu është krijuesi dhe shkaktari i shkaqeve.

Sipas Hereviut, njerëzit në raport me pendimin janë tri kategori. Grupi i parë janë ata që veprat dhe adhurimet i duken shumë, ata hyrjen në Xhennet e konsiderojnë si meritë e veprave të tyre. Ky grup, ngaqë beson tek veprat e tij nuk mendon se ka nevojë për falje dhe pendim, sepse ata e konsiderojnë veten të bindur ndaj Allahut dhe jo mëkatarë. Por kjo është një lloj mendjemadhësie dhe mungesë edukate karshi Krijuesit. Ata në fakt nuk meritojnë asnjë shpërblim. Nëse Allahu i shpërblen, kjo rrjedh jo prej veprave të tyre, por prej mëshirës së madhe të Allahut.

Grupi i dytë ose i mesëm janë ata që i nënvlerësojnë mëkatet, kjo vjen nga besimi që kanë në mëshirën e madhe të Allahut. Sipas Hereviut, nënvlerësimi i mëkateve duke menduar se janë caktim i Allahut nuk është gjë tjetër veçse një përpjekje e dështuar për të justifikuar veten.

Kurse pendimi i grupit të tretë vjen nga fakti se nuk kanë mundur ta kalojnë gjithë kohën në bindje dhe vetëkritikë. Sipas tyre, ky fakt është shkak për privimin nga drita hyjnore.

Përgatiti: Albert Halili



MALIK IBN NEBIJ

FILOZOFI I CIVILIZIMIT ISLAM

JETA E TIJ

Mendimtari islam, Malik ibn Nebij është lindur në qytetin Kasantina të Algjerisë, në vitin 1905 në një familje të thjeshtë. Babai i tij, Umeri ishte nëpunës i thjeshtë në sektorin e qytetit Tebessa, ndërsa nëna e tij, Zahira ishte shtëpiake, që punonte në tezgjah. Por familja ishte e thelluar në fe dhe fisnike.

Malik ibn Nebij, në kujtimet e tij, “Shahidul-karn» (Dëshmitar i shekullit), ka shkruar për emigrimin e gjyshërve të tij nga nëna për në Tunizi dhe Algjeri, në fillimet e pushtimit francez, nga frika e dhunimeve të vazhdate të tyre nga dora e ushtarëve arrogantë francezë.

Bisedat e gjyshes së tij kanë qenë për Malik ibn Nebijin dritarja e kuptimit të krimeve të kolonizatorit francez dhe rëndësisë së krenarisë për akiden (besimin) islame e gjuhën arabe. Pastaj, ajo ishte edhe lidhja e familjes së tij me lëvizjet reformiste dhe tarikatat sufiste, veçanërisht “Ez-Zavije El-Ajseviye» (Tarikati Ajsevi), duke e shtyrë për interesim të çështjeve reformatore, rregulluese dhe rinovuese.

Më pas, ishte kujdesi i nënës së tij për mësimin e Kuranit Famëlartë, derisa sa ajo një herë la peng edhe gjërat e shtëpisë, për t’i paguar shkollën, duke dhënë edhe nefesin e fundit që të nxiste tek ai dashurinë për Kuranin. Ai mbarti flamurin e mbrojtjes (së Kuranit) kundër orientalistëve në librin e tij “Edh-Dhahiretu El-Kuranije» (Dukuria kuranore).

Malik ibn Nebij bashkoi mes studimeve të librave dhe shkollave franceze në Algjeri, pastaj u diplomua në Institutin Islam të Algjerisë, shkolla “Sejjidi El-Xhelis». Pastaj ndoqi studimet e larta në Francë dhe doli inxhinier në vitin 1935.

E vërteta është se Maliku ishte mësues i vetes së tij, sepse dashuria e zjarrtë për leximin ishte e fortë dhe këmbëngulja e tij në autodidaktizëm nuk i mungonte, e të gjitha këto ishin burim prej burimeve të njohurive tek ai.

MES LINDJES DHE PERËNDIMIT

Pas tridhjetë vjet jetë në Francë, filozofi ynë u shpërngul për në Egjipt në vitin 1956. Në Kajro, Malik ibn Nebij u thellua në njohuritë e gjuhës arabe, ndërkohë që më përpara frëngjishtja ishte mbizotëruese në gjuhën dhe shkrimet e tij. Në atë kohë, dr. Abdusabur Shahin

përktheu mjeshtërisht disa libra kryesorë të tij, ku më pas u bë i njohur emri i Malik ibn Nebij tek njerëzit e mëdhenj të Egjiptit dhe Shamit.

Malik ibn Nebij ndërtoi lidhje të forta me presidentin Abdunasir dhe udhëheqja e Egjiptit i lidhin një pagë mujore, e cila i dha mundësinë t’i përkushtohej shkrimit dhe ligjërimit përgjatë shtatë viteve.

Gjatë periudhës së qëndrimit në Kajro, u ndez revolucioni algjerian dhe Malik ibn Nebij prehu lapsin dhe shkroi shumë për të.

Ai i kthye në Algjeri në vitin 1963, ku zuri disa poste akademike, prej tyre postin e Këshilltarit të Lartë për Arsimin, drejtor i Universitetit të Algjerisë, pastaj drejtor i Arsimit të Lartë. Por ai e priti vitin 1967, duke i dhënë përparësi përkushtimit të punës intelektuale, derisa vdiq, më 31 tetor 1973. Malik ibn Nebij la pas një trashëgimi të pasur intelektuale me rreth 30 libra, deri tani prej tyre janë botuar rreth 20 dhe akoma disa punime të tij kanë mbetur dorëshkrime. Mund të konsiderohen prej punime më të rëndësishme të tij: “Edh-Dhahiretu El-Kuranije», “Vuxhhetul-alemil-islamij», “Shurutun-nahdati» dhe “Mushkiletul-efkar fil-alemil-islamij».

MIK I NGUSHTË DHE I DASHUR

Dijetari i madh i Fe’sit dhe historiani i saj, dr. Abdusalam El-Heras, i cili ka jetuar me Malik ibn Nebij në të njëjtën banesë në Egjipt, thotë për të: “Maliku ishte modest dhe i thjeshtë në jetën e tij dhe marrëdhëniet e tij personale. Maliku jetonte një jetë shumë të thjeshtë, plotësisht të thjeshtë. Ndërkohë që filloi të merrte ndonjë pare për librat e tij, paguante pjesën që i takonte nga qiraja e shtëpisë dhe e llogarisnim, siç llogarisnim veten tonë e ai na bindej pa asnjë mëdyshje. Thoshte: “A doni t’ju ndihmoj?” I thoshim: “Jo.” Pastaj, besonte te ne, me një besim të plotë... Maliku ishte njeri me prestigj dhe njihte shumë mirë vlerën e mendimit dhe të diturisë, të cilën e mbartte. Ndonjëherë ishte edhe i ashpër dhe zemërohej shpejt, saqë shokët e tij nuk e trazonin, derisa zemërimi i tij të qetësohej. Por ai nëse nuk ishte i zemëruar, ishte mik i ngushtë dhe i dashur, zemërbutë dhe i besës me shokët e tij.

El-Heras thotë: “Ajo me të cilën krenohem me të, është se Malik ibn Nebij refuzoi që të më përshëndeste në banesë, në Kajro kur mbarova studimet dhe desha të kthehem në Marok, por këmbënguli, përveçse të më përshëndeste në Bur Seid, në hyrje të tragetit.”

MBARTËS I SHQETËSIMIT TË RIMËKËMBJES

Aktiviteti i tij në fushën e rimëkëmbjes mund të përmbledhet në dy fusha: Në fushën e studimeve kuranore dhe në fushën e mendimit të rimëkëmbjes.

Në studimet kuranore, Maliku ibn Nebij parapriu, në krahasim me dr. Muhamed Abdullah Deraz, i cili i dhuroi librin e tij "Edh-Dhahiretu El-Kuranije», një metodë të re në argumentimin e origjinalitetit të mesazhit kuranor. Ai u mbështet në analizën logjike dhe historike, më shumë sesa në analizën sqaruese gjuhësore. Ndërsa në fushën e rimëkëmbjes, ai shkroi pjesën më të madhe të librave të tij dhe mbi të cilët do të përqendrohemi këtu.

Malik ibn Nebij dha një kontribut të vyer në reformimin e mendimit bashkëkohor islam dhe filtrimit të burimit mendor, mbi të cilin u mbështet lëvizja e rimëkëmbjes, që nga fundi i shekullit XIX. Disa terminologji të skalitura nga Malik ibn Nebij qarkulluan në gjuhët e secilit. Kush nuk dëgjoi për thëniet e tij rreth marrëdhënieve mes "kolonizatorit» dhe "prirjes për kolonizim»? Lidhjes mes "ideve të vdekura» dhe "ideve vdekjeprurëse»? fazat e përparimit të civilizimit islam, nga "faza e shpirtit/lartësisimit» në "fazën e mendjes/përhapjes» dhe në "fazën e instinktit/ rënies»?

Malik i bn Nebi kishte arritur në përfundim se kriza e shoqërisë myslimane ishte krizë metode (programi) pune në themel dhe se sfida kryesore, me të cilën përballen myslimanët është sfida e rimëkëmbjes.

Ai solli tezën e tij të ndryshimit shoqëror mbi bazën e parimit të veprimit. Malik ibn Nebij kritikoi disa lëvizje reformuese islame, të cilat u shfaqën në botën islame në fillimet e shekullit XX-të, për shkak të zhytjes së tyre në ligjërimi thjesht (vetëm) në akide, sipas metodës filozofike të vjetër dhe neglizhencën e tyre, në atë që ai e thërriste si "mendimi artistik, i cili shpejton lëvizjet historike». Kështu që këto lëvizje humbën mesazhin dhe rolin e tyre historik, siç thotë Maliku, sepse myslimani nuk heq dorë asnjëherë nga akideja (besimi) i tij, ai mbetet besimtar, por akideja (besimi) i tij është zhveshur prej veprimit, sepse ai ka humbur rrezatimin e tij shoqëror. Problemi nuk qëndron në mësimin e myslimanit akiden, që ai zotëron, por kryesore është t'i kthejmë kësaj akideje (besimi) veprimin, fuqinë dhe ndikimin e saj shoqëror. Me një fjalë: Problemi ynë nuk qëndron, në atë që t'i argumentojmë myslimanit ekzistencën e Allahut, me aq sa ta bëjmë të ndjejë për ekzistencën e Tij.

NDRYSHIMI I THELBIT TË NJERIUT

Ndërkohë që Malik ibn Nebij krahasoi metodën e Muhamed Abdos dhe metodën e Muhamed Ikbalit, ai zbuloi ndryshimin mes dy shkollave: Shkolla filozofike (teologjike) e trajton problemin islam në konturet e mendjes, ndërsa shkolla praktike ka për qëllim ndryshimin e thelbit të njeriut dhe mjedisin e tij shoqëror. Ai shkroi përrreth kësaj: "Shkolla reformuese (nën drejtimin e

shejkh Muhamed Abdos) e formoi me gjuhën e shkencës teologjike, ndërkohë që Ikbali e formoi në terminologji tjetër, kur tërhoqi vëmendjen se ajo që kërkohet nuk është dituria e Allahut, por - në kuptimet më të gjera dhe më të thella - lidhja me Allahun. Ajo që kërkohet nuk është kuptimi teologjik, por zbulimi i së vërtetës së përjetshme dhe, sipas përshkrimit të tij, ajo është: "Zbulimi i kësaj ekzistence të lartmadhërishtme». Për këtë, nuk është për t'u çuditur se shkolla reformuese, nën drejtimin e Muhamed Abdos kishte për qëllim nxjerrjen e specialistëve të shquar, më shumë se sa të orientohet në formimin e thirrësve të sinqertë, sipas botëkuptimit të tij. Specialist i shquar, i cili nuk mbart shqetësim dhe as mesazh, ai furnizon lëndë debati në dëm të llogarisë së punës.

Malik ibn Nebij nxori përfundimin se, shkolla reformuese kishte mundësi të ndikonte në rrjedhjen (trajktoren) e shoqërisë islame, me një ndikim të madh pozitiv, "nëse ajo të mundte të arrinte t'i ndërtonte idetë dhe t'i bashkonte elementët e saj, për të unifikuar mes ideve fundamentale, të cilat i prodhoi Muhamed Abdo dhe mes ideve politike dhe shoqërore, për të cilat bënte thirrje Xhemaludin Afgani, çështje e cila detyrimisht do të çonte drejt rrugës më të mirë, ndaj thjesht një reformimi parimesh akaidike (besimore)».

Muhamed Ikbali i parapriu Malik ibn Nebiut në ashpërsinë e tij se, shpirtat besimtarë, nëse nuk i shëron meditimi (të kuptuarit) e Kuranit dhe fuqizimi përmes tij me metodën vepruese (përmes punës), atëherë as shija sufiste (zbuluesi) nuk është e nevojshme dhe as debati teologjik (zbuluesi) nuk bën dobi. Muhamed Ikbali thotë në "Divanin e tij»:

Një shpirt, që prej Kuranit nuk përfiton - as zbuluesi nuk i bën dobi e as zbuluesi.

Sekreti i kësaj diagnoze, në të cilën përputheshin Ikbali dhe Maliku dhe të tjerë mendje të ndritura myslimane, është se shkenca teologjike, të cilën Ikbali e simbolizoi me librin "Zbuluesi» (El-Keshshaf) të Zemaksheriut, falsifikon problemin islam që në themel, ashtu siç tregon edhe eksperiencia historike e myslimanëve, "ku debatuesit nuk kërkonin për të vërtetat, por për argumentet», siç thotë Maliku. Kjo, sepse "shkenca teologjike nuk përballet me problemin e funksionit shoqëror të fesë», ku ajo tani është thelbi i krizës shoqërore myslimane dhe për hatër të rikthimit të saj janë shfaqur lëvizjet reformuese bashkëkohore, madje i zënë njerëzit me debate rreth çështjeve metafizike (të fshehta - gajb), pa pasur asnjë mundësi të thyhen nga ana shkencore dhe pa pritur prej tyre asnjë fryt praktik.

Allahu e mëshiroftë Malik ibn Nebiun, vizionisti i reformimit islam.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



Përjetimi i **NAMAZIT**

Zoti ynë thotë në Kuranin famëllartë: **“Ti fale namazin, se namazi të ndalon nga fjalët e liga dhe punët e pahijshme.”** (Ankebut: 45)

Kemi folur për dy gjëra kryesore në jetën e besimtarit. Ato janë shumë të thjeshta, por ne nuk po i ndejmë dot. E kam fjalën për leximin e Kuranit famëllartë dhe për përmendjen e Zotit. Kush lexon fjalën e Zotit, ka lexuar fjalën më të lartë. Kush përmend Zotin, ka përmendur emrin më të mirë. Në qoftë se me të vërtetë e bën diçka të tillë, do e ndjesh prezencën e Zotit, do e ndjesh afërsinë me Allahun (xh.sh.).

Në këtë trajtim dua të flas për diçka më madhështore se këto të dyja. Dua të flas për namazin, për lidhjen më të madhe me Allahun (xh.sh.). Namazi është obligimi më i parë dhe porosia më e fundit e profetit Muhamed (a.s.). Namazi është obligimi i vetëm, që nuk u caktua në tokë por në qiell, pikërisht kur profeti Muhamed (a.s.), ishte në gjendjen më të lartë shpirtërore, i vetëm me Zotin e gjithësisë, tamam Kur presidenti i shtetit dëshiron t’i dërgojë një mesazh të rëndësishëm ambasadorit, nuk ia çon vetë, por e thërret atë në zyrën e tij. Ashtu e thërriti Zoti i gjithësisë ambasadorin e tij, pejgamberin Muhamed (a.s.), për t’i dhënë amanetin më të madh, që nuk e mbajtën asnjë prej umeteve dhe kombeve më përpara, por e mbajtën vetëm myslimanët e ky ishte **NAMAZI**.

Këtu nuk do flas për ata njerëz, që nuk e falin namazin, duke iu lutur Allahut (xh.xh.), t’ua hapë

zemrat dhe t’i drejtojnë në rrugën e drejtë. Nuk do të flas as për ata myslimanë, që janë dembelë në namazin e tyre, që nxjerrin një mijë e një argumenta për të mos e falur namazin: “Nuk kam kohë, nuk kam mundësi, nuk di etj., etj”. Por do flas për mua dhe për ty, për vëllezërit dhe motrat që vënë kokën në sexhde, që falen për Zotin e gjithësisë, por s’e ndejnë namazin e tyre. Shumë myslimanë praktikantë hyjnë dhe dalin prej namazit e nuk e mbajnë mend çfarë lexuan, për çfarë u lutën, çfarë bënë në namazin e tyre.

Vallë ç’duhet të bëjmë? Pse s’e ndejmë namazin tonë, kulmin e adhurimit tonë, punën më të mirë që mund të bëjmë? Namazi fillon me ezanin, me përmendjen e emrit të Allahut (xh.sh.), prandaj kur besimtari dëgjon ezanin, frenon. Çfarë thuhet vallë në ezan? Zoti është më i madhi, Zoti është më i madhi. Kjo është gjuha e të gjithë besimtarëve. Në çfarëdo lloj vendi që të jesh, po dëgjove ezanin, do të thuash: “Këtu ka besimtarë”. SubhanAllah, futesh në një lokal për herë të parë, të gjithë të shohin me habi dhe ti i shikon me habi, sepse je i huaj në atë vend. Futesh në një shtëpi për herë të parë, i shikon me rezerva dhe të shikojnë me rezerva.

Ndërsa kur futesh në një xhami ku thirret ezani, të gjithë i shikon si vëllezërit e tu dhe ata të shikojnë si vëllain e tyre. Askush nuk të shikon si të huaj. Në çdo vend ku përmendet emri i Zotit, besimtari e ndjen veten banor i atij vendi, e ndjen veten se po thirret për të falur namazin për Allahun (xh.

xh.). Prandaj ai njeri që përjeton ezanin, që është gjuhë dhe deklaratë e të gjithë besimtarëve, ai patjetër ka për ta përjetuar namazin e tij. Profeti Muhamed (a.s.), thotë: *“Kush e dëgjon ezanin, e lë punën që ka në dorë”. Ai që e përsërit ezanin dhe në fund thotë: “O Allah, o Zot i kësaj thirrjeje të plotë, i këtij namazi që do të falet tani, jepi peygamberit tënd ndërmjetësimin për mua”, ai njeri e meriton ndërmjetësimin e Muhamedit (a.s.)”.* (Buhariu)

Përjetimi i parë është përjetimi i ezanit, deklarates më të madhe. Këtë rit e kanë myslimanët dhe nuk e ka askush tjetër. Zoti është më i madhi, Zoti është më i madhi.

Për të përjetuar namazin duhet të përjetosh abdesin tënd. Ti pastron duart, sytë, këmbët vetëm për Zotin. Nuk do të dalësh në një takim me ndonjë ministër apo president, por do të dalësh përpara Allahut (xh.sh.). A e ke vënë re, se kur ke lënë diçka pa larë, të bëhet fiks, del prej namazi dhe aty të rri mendja. Pasi merr abdes, a mendon nëse e pastrove zemrën tënde. A e ke pyetur ndonjëherë veten: *“A e pastrova zemrën nga mëkatet, ashtu siç i pastrova gjymtyrët e mia me ujë?”* Muhamedi (a.s.), thotë: *“Ai që merr abdes rregullisht dhe për çdo gjymtyrë që pastron, i lutet Zotit t’ia pastrojë duart, gojën, sytë, veshët, kokën, këmbët, atij njeriu do t’i bien mëkatet e tij një nga një edhe sikur të ishin poshtë thonjve të duarve të tij”.* (Muslimi) A e përjeton vallë këtë abdes, këtë pastrim kaq të habitshëm, që e kanë myslimanët dhe s’e ka askush tjetër?

Për të përjetuar namazin, përjeto drejtimin drejt Kiblës. Ti drejtohesh drejt Kiblës dhe nuk guxon të lëvizësh as djathtas e as majtas, por a e ke pyetur veten tënde, nëse përveç trupit ke drejtuar edhe zemrën drejt Kiblës, drejt Allahut (xh.sh.)? A e di se sikur të ishte e qetë zemra jote, s’do të shkonte mendja të kruaje mjekrën tënde e as të lëvizte dorën tënde. Prandaj, kur një dijetar pa dikë, që po lëvizte shumë në namaz, tha: *“Vallahi sikur zemra e këtij personi të ishte e qetë, do ishin të qeta edhe duart e tij”.* Kujto drejtimin nga shtëpia e Zotit, nga magneti që tërheq të gjithë besimtarët, kujto se tani në të katër anët e botës, çdo besimtar mysliman i drejtohet këtij vendi. A e shikon çfarë madhështie është? I je drejtuar Allahut (xh.sh.).

Besimtar i nderuar! Kujto tekbinin fillestar *“Allahu Ekber”* (Zoti është më i madh). A e di se ti e thua më shumë se 110 herë në ditë tekbinin fillestar? A je i sinqertë? A me të vërtetë Zoti është më i madh, më i madh se qejfet e tua, se epshet e tua, se hallet e tua? A me të vërtetë tani je drejtuar tek Zoti? Kur thua *“Allahu Ekber”*, i ke shkëputur lidhjet me dynjanë, me njerëzit që ke përreth, me hallet e tua. Ji i sinqertë besimtar, se në qoftë se je i sinqertë në fjalën *“Allahu Ekber”*, Zoti ka për të të afruar, por në qoftë se (Zoti na ruajtë) në namazin tënd, ti mundohesh të mashtrosh Zotin tënd, duke thënë

***“O Allah, o Zot
i kësaj thirrjeje të plotë,
i këtij namazi që do të falet tani,
jepi peygamberit tënd
ndërmjetësimin për mua.”***

“Allahu Ekber”, ndërkohë që mendja dhe zemra jote fillon të kujtojë gjëra, që s’të janë kujtuar në asnjë moment, ti mashtron veten tënde.

Pas tekbitit fillestar (Allahu Ekber - Zoti është më i madh) kujtohu të lexosh Fatihanë, suren më madhështore. Vallahi, po ta dinim kuptimin e saj, do ta përjetonim atë, do na rridhnin sytë lot. Allahu thotë në Kuran: Në emër të Allahut Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. **“Falenderimet janë për Allahun, Zotin e gjithësisë, Mëshiruesi, Mëshirëbërësi, Mbreti i ditës së gjykimit. O Zot vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë. Udhëzoni Zot në rrugën e drejtë, në rrugën e njerëzve mbi të cilët zbritë begatitë dhe mirësitë e Tua. O Zot mos na drejto në rrugën e atyre, që ndaj vetes së tyre, tërhoqën hidhërimin tënd dhe as në rrugën e atyre që kanë gabuar.”** (Fatiha:1-7) Amin o Zot! Fatihaja është programi i jetës, metodologji e çdo besimtar. Përjetoje suren Fatiha! Është nëna e Kuranit, është çelësi i Kuranit, është Kurani vetë.

Pastaj përkujto çastin kur bie në ruku. A e di se ç’është rukuja? Është përkulje. Askujt mos iu përkul përveç Allahut (xh.xh.). O Zot, vetëm për ty përkulem dhe askujt përveç Teje nuk i përkulem. I përkulesh Allahut (xh.sh.) me respekt, i përkulesh me adhurim, i përkulesh me gjithë dashurinë që ke për Zotin e gjithësisë, duke thënë: “Subhane rabij el adhim” (I madhëruar je ti o Zoti im, më i madhi)”. A e sheh çfarë respekti ke për Zotin? A e përjeton rukunë vetëm për Allahun (xh.xh.).

Pastaj përkujto çastin kur bie në sexhde. Ky është kulmi i adhurimit O Zot, duart e mia kanë rënë në sexhde për ty, këmbët e mia, balli im, hunda ime o Zot. Vallahi nuk e ul hundën për asnjëri përveçse për madhësinë Tënde. Të jam nënshtruar me gjithë zemër o Zot. E ku të shkoj poshtë sexhdes o Zot? Unë jam bir i kësaj toke, unë jam robi yt, prandaj të lutem më mëshiro. Profeti Muhamed (a.s.), ka thënë: “Shfrytëzoheni sexhden tuaj, se Zoti nuk e kthen kurrë mbrapsht duanë e atij që është në sexhde”.¹ Kur je në sexhde, je në kulmin e adhurimit, je në kulmin e ibadetit, je në kulmin e dorëzimit për Allahun (xh.sh). Aman o Zot, çfarë po shikoj në sexhden time? Një pëllëmbë tokë, asgjë tjetër, por jam robi yt. Subhane rabij el eala (I madhëruar është Zoti im më i larti). O Zot, unë jam poshtë e Ti je lart, unë jam i ulur e

Ti je i lartësuar o Zot i gjithësisë. Shejtani qan kur shikon robin, i cili bën sexhde. Shejtani thotë: “Unë u urdhërova për sexhde dhe kundërshtova, kurse ky njeri u urdhërua për sexhde dhe iu dorëzua Allahut (xh.sh.)”. Ai qan në çdo sexhde, zvogëlohet në çdo sexhde të besimtarit.

Ne falim namaz pesë herë në ditë, madje edhe më shumë se pesë herë në ditë, por nuk e përjetojmë. Ky është gabimi më i madh. Ne duhet ta përjetojmë namazin tonë, sexhden tonë, rukunë tonë, qëndrimin tonë përpara Allahut (xh.xh.), prandaj le të kemi mëshirë për lodhjen tonë.

Namazi ka shumë vlera shëndetësore dhe shpirtërore, por kulmi i kësaj vlere është dorëzimi tek Zoti i gjithësisë. Le të thotë çdo besimtar: “O Zot, unë jam robi yt, unë përkulem për Ty, unë vetëm për Ty bie në sexhde, pranoi lutjet e mia, fali gabimet e mia, lartësomë mua në këtë jetë dhe në jetën tjetër”. Prandaj besimtari asnjëherë nuk duhet ta lërë namazin, i pasur apo i varfër qoftë, mirë apo keq qoftë. Në pragun e vdekjes ai falet me shenja, sepse po këputi lidhjen me namazin, ka këputur lidhjen me Allahun (xh.xh.). E lus Zotin e gjithësisë të na bëjë nga namazlinjtë, të cilëve ua pranon Zoti namazin, rukunë dhe sexhden e tyre. E lus Allahun (xh.xh.), ta falë neglizhencën tonë, t’i falë rrëshqitjet tona, gabimet tona, të na i pranojë të gjithë ato namaze, në të cilët nuk kemi qenë të vëmendshëm ndaj Allahut (xh.xh.).

Ne të gjithë kemi probleme me veten tonë, me namazin tonë. Shumë prej namazeve tona nuk i përjetojmë. Por si i bëhet? Kujto vëlla, munde veten dhe bindu që je para Zotit. Ti po qëndron para Krijuesit tënd, ti po qëndron me gjithë çfarë ke, je transparent përpara Allahut (xh.sh.). Mos e mashtroni veten tënde, largoje shejtanin prej vetes tënde. Po qe se ia kujton vetes një herë, dy herë, tri herë dhe kujton se përpara ke Zotin, nga e djathta ke xhenetin, nga e majta xhehenimin dhe pas shpine ke dynjanë, vallahi ke për ta përjetuar namazin tënd. Të gjithë e kemi provuar se kur përjeton namazin, ndjen një rehati, ndjen një kënaqësi, ndjehesh krenar, ke bërë diçka për veten, ke bërë diçka për Zotin

Tregohet që një nxënës i imamit të dëgjuar, imam Ahmed ibn Hambel, e lexonte Kuranin për një natë dhe kur imami e dëgjoji këtë, nuk i erdhi mirë.

Ai e pyeti nxënësin e tij: ” Biri im, më kanë thënë

1. Buhariu (773) dhe Muslimi (2968).

që e lexon Kuranin për një natë”. Nxënësi u pergjigj gjithë gëzim: “Po, imam i nderuar, për një natë e lexoj Kuranin”.

Imami i tha: “Biri im! Shko sonte dhe lexoje Kuranin, duke imagjinuar se përpara vetes më ke mua. Nesër eja më tako dhe më thuaj sa ke lexuar prej Kuranit”.

Gjatë gjithë natës nxënësi mendonte se para vetes kishte imam Ahmed ibn Hanbel, një dijetar jashtëzakonisht i lartë. Të nesërmen ai shkoi tek mësuesi i tij dhe i tha: “Imam i nderuar, vallahi vetëm dhjetë xhuze munda të lexoj. Kisha turp të lexoja shpejt, kisha turp të bëja gabime”.

Atëherë imami i tha: “Biri im, shko sonte dhe mendoje se po e lexon Kuranin para profetit Muhamed (a.s.), dhe eja nesër e tregomë se sa lexove”.

Nxënësi kthehet të nesërmen i lodhur, i kërrusur me sytë e përlotur dhe i thotë: “Vallahi imam, vetëm një xhuz lexova. Kisha turp nga profeti (a.s.). E si mund t’i kaloja ajetet, e si mund t’i neglizhoja ato, kur kisha përpara profetin e Zotit?”

Pastaj imami i thotë: “Biri im! Shko sonte, lexoje Kuranin dhe imagjinoje se ke përpara Allahun (xh.sh.). Pastaj eja nesër dhe më trego se sa ke lexuar”.

Nxënësi shkon të nesërmen tek mësuesi i tij dhe thotë: “Vallahi imam im, as suren Fatiha nuk arrita ta mbaroj. Isha para Zotit. Po lexoja fjalët e Zotit. E ku mund ta hiqja mendjen?”

Atëherë Imam Hanbeli i thotë: “Biri im, ti kur lexon Kuran dhe kur falesh, dije se po qëndron përpara Zotit. A e mendon pak? A e mendon namazin tënd? A e mendon Kuranin tënd. A e mendon duanë tënde?”

Por si përjetohet namazi, kur njeriu nuk fal namazin. Si mund të kërkohet nga njeriu që s’fal namazin, që ta përjetojë atë. Minimumi është ta falim namazin tonë, pastaj me lejen e Zotit të gjithësisë, dalëngadalë do e përjetojmë namazin tonë. A shijohet ushqimi duke e parë? A shëron ilaçi duke e parë? Duhet ta përdorësh, duhet ta shijosh, duhet të hysh në namazin tënd, që ta përjetosh atë.

Njëherë profeti Muhamed (a.s.), u tha shokëve të tij: “*Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im*”, pastaj heshti dhe qau e bashkë me të qanë

të gjithë. Pastaj ngriti sytë dhe tha duke qeshur: “*Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, ai njeri që fal pesë namazet e ditës, që agjëron Ramazanin, jep Zekatin, bën Haxhin dhe u largohet shtatë gjynaheve më të mëdha, ka për t’i thënë Zoti në ditën e Gjykimit: “Robi im, futu në xhenet, i qetë dhe pa asnjë siklet”.*”²

Ky është namazi! Është deklaratë për këtë botë dhe për botën tjetër. Është çelësi i xhenetit, është miraxhi i besimtarit, është lidhja që po e këputë, vallahi, ke këputur lidhjen me Zotin. Në lidhje me këtë, dijetarët thonë: “Je ose qafir, ose i prishur”. A e pranon diçka të tillë për veten tënde? Të të thuhet qafir (Zoti na ruajtë)? A e pranon të të thuhet njeri i prishur, njeri që ka lënë rrugën e Zotit?

Prandaj vëlla besimtar, munde veten tënde, gjej pak kohë për Zotin, për veten tënde dhe përjetoje namazin tënd e ke për ta parë se ke për të hyrë në xhenet akoma pa ndërruar jetë, sepse do të jetosh në kopshtet e besimit, në lulishtet e kësaj toke. Kush përjeton namazin e tij, vallahi, ka për të hyrë në xhenet qysh në këtë dynja.

E lus Zotin e gjithësisë t’i falë gabimet tona, t’i falë gjynahet tona, të na bëjë nga namazlinjtë, nga ata që e përjetojnë namzin e tyre, nga ata që i fal Zoti nga gabimet që kanë bërë në namazin e tyre.

E lus Allahun (xh.xh.), ta bëjë këtë namaz dritë në zemrat tona, dritë në sytë tanë, dritë në jetën tonë, dritë në varrin tonë, dritë në Siratin tonë, dritë në fytyrat tona kur të dalim përpara Allahut (xh.xh.).

E lus Zotin e gjithësisë të na ndihmojë ne, bashkëshortet tona, fëmijët tanë, vëllezërit dhe motrat tona. E lusim Allahun (xh.xh.), që t’u japë ndihmë dhe përkrahje të gjithë myslimanëve, që vuajnë në këto momente.

E lus Allahun (xh.xh.) të marrë hak mbi zullumqarët dhe mbi të padrejtët. E lus Zotin e gjithësisë t’i shërojë të sëmuret tanë. E lus Allahun (xh.xh.) t’i mëshirojë të vdekurit tanë, t’i udhëzojë të humburit tanë, t’i falë gabimet tona, t’i falë të gjithë myslimanëve kudo që janë.

Amin!

2. Nesaiu (5/8) dhe Hakimi (2/240). Hakimi e vlerëson hadithin të vërtetë sipas kritereve të Buhariut dhe Myslimit, ndërsa Dhehebiu e vlerëson hadithin të vërtetë.



DJATHË PËR NJË SHËNDET TË MIRË

Djathi mund të jetë çelësi i një jete të shëndetshme.

Në një studim që është mirëpritur botërisht, studiuesit nga Universiteti i Kopenhagenit zbuluan se djathi na bën mirë për zemrën.

Ata i kërkuan 139 të rriturve të merrnin pjesë në studimin 12 javor të konsumimit të djathit – një e treta e grupit të hante 80 g djathë të zakonshëm çdo ditë, dhe një e tretë tjetër 80 g djathë me nivel të ulët yndyre.

Grupi tjetër nuk duhet të hante djathë fare, por 90 g bukë me reçel.

Shkencëtarët zbuluan se grupi i cili konsumoi

djathë me yndyrë të lartë nuk kishte ndryshime në nivelin e kolesterolit, masën e belit apo presionin e gjakut. Në fakt, shëndeti i tyre u përmirësua.

Studimi, i publikuar në American Journal of Clinical Nutrition, raportoi se ngrënia e djathit përmes një diete të shëndetshme mund të na mbrojë ndaj sëmundjeve kardiovaskulare dhe atyre të metabolizmit, falë rritjes së kolesterolit “të mirë”.

Por ka edhe një arsye më shumë për të ngrënë djathë – sipas një studimi të fundit japonez konsumimi i tij parandalon akumulimin e yndyrave në mëlçi, ndërkohë që të tjerë kanë sugjeruar se na ndihmon të flemë gjumë më mirë, na bën më të lumtur dhe madje të humbasim në peshë.

SHTRYDHNI 1 LIMON DHE PËRZIEJENI ME 1 LUGË VAJ ULLIRI

Disa trajtime natyrore mund të japin efekt pozitiv në shumë pjesë të organizmit duke kuruar dhe parandaluar problem serioze.

Kjo recetë është një trajtim detoks fantastik i cili shërben për të pastruar trupin dhe zgjidhur problemet me lodhjen dhe mungesën e energjisë.

TRAJTIM PËR SHUMË PROBLEME SHËNDETËSORE

Ekspertët pretendojnë se ky trajtim është përdorur për shekuj me radhë për të parandaluar probleme të shumta shëndetësore.

Për shkak të vetive të pafund dhe lëndëve ushqyese që përmbajnë limoni dhe vaji i ullirit, kombinimi i këtyre dy përbërësve e bën një përzierje të fuqishme e cila trajton dhe parandalon shumë sëmundje.

Ekspertët pretendojnë se mund të trajtojë dhe të parandalojë problemet e mëposhtme:

PROBLEMET KARDIOVASKULARE

Për shkak të përmbajtjes së lartë të acideve yndyrore në vajin e ullirit, i cili është vital për trajtimin e kolesterolit të keq dhe ndihmon në qarkullimin e gjakut, kjo përzierje parandalon problemet kardiovaskulare dhe ndihmon në trajtimin e shqetësimeve të zemrës.

PROBLEMET REUMATIKE

Ky kombinim ka aftësi të fuqishme antinflatore, ndaj përdorimi i rregullt në një stomak bosh



trajton dhimbjet e kyçeve dhe të gjitha shqetësimet reumatike.

KASPLLËKU

Kjo përzierje është një lubrifikues i fortë dhe efektiv për mykozën digjестive ndaj aktivizon funksionin e mëlçisë dhe tëmthit. Për më shumë ndihmon tretjen dhe heqjen e mbetjeve nga trupi. Për shkak të vetive të fuqishme antioksidante, gjithashtu kjo

përzierje pastron të tërë sistemin dhe toksinat e akumuluar.

PASTRON MËLÇINË, VESHKAT DHE TËMTHIN

Konsumimi i lëngut të një limoni me një lugë gjelle vaj ulliri në një stomak bosh parandalon dhe rritjen e gurëve të tëmthit. Thjesht duhet pirë me një gotë ujë, një orë para se të hani mëngjes dhe do të detoksifikoni veshkat, mëlçinë dhe tëmthin.

GËSHTENJA

Nutricionistët e konsiderojnë një frut vërtet magjik. Ka shije të shkëlqyeshme, me plot vitamina, minerale, është ushqyese, tretet lehtë, e përshtatshme për ushqim tek të moshuarit dhe fëmijët. Me 6 deri 10 miligramë të fibrave të patretshme në 100 gramë, frutat aromatike me mbështjellës me ngjyrë kafe të errët klasifikohen në mesin e artikujve ushqimore me përmbajtje më të madhe të këtyre substancave. Kombinimi i kaliumit dhe fosforit i forcon dhëmbët dhe kockat, kurse gështenja e butë është e mirë për sistemin nervor.

PËRBËRËSIT

Gështenja, bën pjesë në grupin e arrorëve, por në ndryshim nga arrat dhe bajamet, përmban nivel më të ulët të yndyrave dhe është i vetmi i këtij grupi që përmban vitaminën C. Gështenja përmban edhe shumë minerale, si kalium, fosfor, kalcium, magnez dhe hekur. Gjithashtu, përmban vitamina të grupit B, si edhe vitaminat e A, C. Meqenëse gështenja është e pasur me kalium, ndihmon gjatë mjekimit të sëmundjeve të veshkave dhe të gjakut. Kurse gështenja e zierë ka shumë përbërje minerale, ndërsa gështenja e pjekur ka vlerë më të madhe energjike, proteina, si dhe dyfish karbohidrate.

Ai përdoret për mjekim të reumatizmës, përdoret si diuretik, për uljen e ënjtjeve dhe infektive të ndryshme. Sidomos përdoret edhe në përbërjen e shumë preparateve

kozmetike për lëkurën e flokëve dhe fytyrës, për shkak të efekteve të saj qetësuese mbi organizmin.

Gështenja duke qenë se është e pasur me vitamina, minerale dhe tretet lehtë është e përshtatshme për ushqimin e të moshuarve dhe të fëmijëve. Meqenëse gështenja është e pasur me kalium, por nuk përmban shumë natrium, rekomandohet në dietën e të sëmurëve me çrregullime të veshkave dhe të gjakut. Gështenja përdoret edhe në ushqim nga prodhimet e saj prodhohet edhe mielli, i cili i përzier me miellin e drithërave jep bukë. Mielli gështenjës është i pasur me sasi të mjaftueshme të sheqerit.

MIKROELEMENTËT

Gështenja gjithashtu është e pasur me burim mikroelementesh, i cili është shumë i dobishëm për shëndetin, pasi mund të parandalojnë shumë sëmundje. Kërkime të shumta kanë vërtetuar se ajo zvogëlon kolesterolin e përgjithshëm dhe të 'keq' duke mbrojtur organizmin nga sëmundjet kardiake dhe nga infarkti. Fruti magjik i gështenjës është një burim i shkëlqyer yndyre dhe i vetmi fryt i thatë që përmban përqindje të madhe të acideve yndyrore omega -3 (40 g gështenja janë të mjaftueshme që të mbulojnë nevojat e përditshme). Por, përveçse është burim yndyrash të dobishme, ajo është edhe burim proteinash dhe indesh bimore.

Gështenja ka pak kalori dhe nuk përmban kolesterol. Edhe pse është një frut i thatë, ajo ka shumë pak yndyrë dhe pjesa e brendshme e saj është e butë dhe niseshtore, me përqindjen më të lartë të kalorive që vijnë nga sheqernat. Gjithashtu, është e pasur me vitaminë E, vitaminë B3, kalium dhe inde bimore. Sheqernat dhe indet bimore thithen ngadalë duke i dhënë kështu energji organizmit. Në një dallim midis gështenjës së butë dhe asaj të egër është se gështenja e egër nuk hahet për shkak të shijes jashtëzakonisht të hidhur, por duke pasur shumë efektin shërues përdoret në prodhimet e preparateve farmaceutike, kryesisht për shërimin e sëmundjeve të venave. Gështenjat konsumohen kryesisht të pjekura dhe kanë një shije të lehtë dhe të ëmbël.





FITOPLANKTONET DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Robotët po ndihmojnë shkencëtarët në Afrikën e Jugut të bëjnë zbulime të rëndësishme në lidhje me ndryshimin e klimës.

Robotët e zgjuar që zhyten nën ujë janë duke ofruar një dritare më parë të paarrtshme në oqean, dhe për mënyrën se si e trajton dioksidin e tepërt të karbonit.

Zhytësat robotikë po u ofrojnë shkencëtarëve të dhëna të sofistikuara për ndryshimin e klimës.

Para se të përdorësh këta robotë në oqeanin e jugut gati pesë vjet më parë, sezoni i rritjes fitoplanktonike nuk kuptohej si duhej.

Fitoplanktoni është për oqeanin si janë pemët për tokën – ata kryejnë detyrën e rëndësishme të magazinimit të karbonit.

Dr. Sebastiaan Swart në Këshillin e Hulumtimeve Industriale dhe Shkencore në qeverinë e Afrikës së Jugut, thotë se zhytësit robotikë kanë treguar se fitoplanktonet mikroskopike thithin më shumë dioksid karboni të dëmshëm nga atmosfera në oqean nga sa mendohej.

“Ajo që vërejtën zhytësit robotikë nga pranvera deri në fund të verës është se lulëzimi i pranverës, rritja e fitoplanktoneve që ndodh në pranverë, tani ndodh në shtator/tetor. Më pas ne teorikisht menduam se ato nuk do të rronin gjatë. Por robotët në fakt treguan se këto fitoplanktone do të vazhdonin për një periudhë shumë më të gjatë nga sa e mendonim. Kjo është shumë e rëndësishme për klimën globale pasi do të thotë se potencialisht ato do të absorbojnë më shumë dioksid karboni gjatë fotosintezës.”

Dislokimi i zhytësive robotikë është shumë më i lirë sesa përdorimi i anijeve kërkimore.

Zhytësat robotikë dërgojnë të dhëna të grumbulluara gjatë një dislokimi afatgjatë në vend të atyre të grumbulluara gjatë udhëtimeve të shkurtra shkencore të kryera me anije apo përdorimi i të dhënave satelitore që kufizohen vetëm në sipërfaqen e oqeanit.

Andre Hoek shpjegon:

“Avantazhi i madh këtu është se kemi së pari një prani të vazhdueshme. Pra ne shkojmë me një anije të madhe kërkimore, dislokojmë robotin dhe kthehemi duke e lënë robotin aty për gjashtë muaj apo një vit. Avantazhi tjetër i madh është se nuk ke faturë energjie. Robotët funksionojnë me fuqinë e valëve.”

Ndërsa ka patur ndryshime klimatike përgjatë gjithë historisë së tokës, është ritmi i rritjes së dioksidit të karbonit të shkaktuar nga njeriu ai që i shqetëson shkencëtarët.

Zbulimi se periudha e lulëzimit të fitoplanktoneve në oqeanin jugor zgjat më shumë nga sa mendohej dhe se ato kryejnë një funksion më të madh në magazinimin e dioksidit të karbonit, është i rëndësishëm.

Por ky fitoplankton që mendohet se thith më shumë dioksid karboni sesa pyjet tropikale në tokë, varet nga stuhitë verore që sjellim ushqim nga thellësitë e oqeanit.

Ndërsa zbulojmë sesa të rëndësishme janë fitoplanktonet e oqeanit të jugut për klimën, duke magazinuar karbonin, efektet e ndryshimeve klimatike tek prodhimitaria e fitoplanktoneve ka filluar të ndjehet me ndryshimin e stuhive verore. Të dhënat e grumbulluara nga oqeani jugor do të kontribuojnë në raportin e gjashtë të vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike 2018 – 2019.



TEKNOLOGJIA E MAKINAVE PA SHOFER

Shumë ekspertë thonë se fillimi i përdorimit të makinave pa shofer në shkallë të gjërë është i afërt, por askush nuk e di saktësisht se kur mund të ndodhë kjo. Pothuajse të gjithë prodhuesit e mëdhenj të makinave dhe disa nga gjigandët e tjerë të teknologjisë kanë nxjerrë në rrugë makina eksperimentale pa shoferë. Ajo që duket se mungon është aftësia kompjuterike e makinave që mundëson reagimin e tyre në situata të komplikuar gjatë lëvizjes së përditshme.

Edhe pse ideja për prodhimin e tyre ka ekzistuar që nga vitet 1930, vetëm përparimi i shpejtë i teknologjisë dhe rënia e çmimit të pajisjeve të sofistikuara u kanë mundësuar studiuesve të fillojnë prodhimin e makinave eksperimentale.

Ekspertët thonë se tani pyetja kryesore është se kur do të prodhohen makina pa shofer me kosto të përballueshme, e jo thjesht prodhimi i tyre. Megjithatë, ka ende disa pengesa.

Studiuesit në Universitetin Carnegie Mellon në Pitsburg kanë bërë prova me një furgon pa shofer të tipit Cadillac, që përshkoi pa probleme rrugën nga një shtëpi në periferi deri te aeroporti i qytetit.

Por drejtuesi i këtij studimi, Profesor Raj Rajkumar, thotë se lëvizja e këtyre makinave brenda qytetit është çështje tjetër:

Trafiku rreth universitetit mund të jetë shumë i rënduar, me lloje të ndryshme makinash, këmbësorë, ciklistë dhe njerëz që kalojnë rrugën jashtë kryqëzimeve e kështu me radhë.

Çdo vit më shumë se 1 milion njerëz vdesin dhe 15 milionë të tjerë plagosen nga aksidentet me makina, 90 për qind e të cilave shkaktohen nga njerëzit. Ekspertët thonë se makinat pa shoferë do të pakësonin në mënyrë dramatike këto shifra pasi ato do të respektonin kufizimet e shpejtësisë, shenjat rrugore dhe semaforët.

Audi, Tesla, Mercedes dhe kompani të tjera ofrojnë modele të makinave që mund të operojnë pa shofer, që mund të shmangin përplasjet dhe që reduktojnë stresin e ngarjes së makinës në autostradë.

Një pengesë e madhe mund të jetë përpjekja për të bindur njerëzit që të heqin duart nga timoni. Por Rajkumar thotë se kjo në fakt nuk kërkon aq shumë kohë:

“Ata fillojnë ta shohin se automjeti është shumë racional dhe drejtohet në mënyrë të sigurtë, dhe kështu, mësohen.»

Pra, pjesa më e madhe e teknologjisë tashmë ekziston. Ajo që kërkohet është ulja e çmimit të këtyre makinave dhe programe kompjuterike më të sofistikuara për kontrollin e tyre.

“Unë mendoj se do të duhen rreth 10 vjet, ndoshta më shumë, për prodhimin e një makine pa shofer e cila mund të shkojë kudo» thotë profesori Rajkumar.

Por Google, Uber dhe disa kompani të tjera thonë se ata tashmë janë duke u përgatitur për të ardhmen më të largët, duke eksperimentuar me makina pa timon, gjë që mund të ndryshojë rrënjësisht mënyrën se si i përdorim makinat sot.

O ju që keni besuar!
Nëse ju vjen ndonjë lajm,
verefikojeni atë,
përndryshe
nga padituria
i bëni padrejtësi dikujt
dhe pastaj detyroheni
të pendoheni
për atë që bëtë.

(Huxhurat, 6)

